Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 1 (81). JANAR 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

Redaksionale

"Rruga e Arbërit", një zë origjinal në median e shkruar

Gazeta "Rruga e Arbërit" është futur në vitin e 8-të të botimit dhe gjatë gjithë kësaj periudhe ka dëshmuar korrektesë me lexuesit dhe bashkëpunëtorët, duke u kthyer në një medium që u ka dhënë zë opinioneve dhe analizave të autorëve të ndryshëm. Lexues jo vetëm nga Dibra, por edhe nga rrethe të tjera të vendit, si Lezha, Shkodra, Miloti, Durrësi, Tirana etj., shprehin vazhdimisht falënderimet që kanë gjetur një hapësirë të re mediatike. Mbi 2000 lexues shkarkojnë gazetën në versionin PDF nga interneti dhe qindra të tjerë e marrin atë çdo muaj falas nëpërmjet emaile-ve të miqve e shokëve të tyre.

Çështje dhe problematika që janë aktuale në rajonin e Dibrës, brenda dhe jashtë kufijve shtetërorë, kanë zënë hapësirë ta konsiderueshme, duke informuar opinionin publik në mënyrë korrekte dhe të hapur.

Informacionet dhe opinionet lidhur me rrugën e Arbërit, hidrocentralin e Skavicës, ujërave të Radikës, zhvillimit të turizmit rajonal dhe bujqësisë, pyjeve, etj., janë bërë kauza për grupe të caktuara lexuesish, duke ngjallur interes dhe duke lëvizur vendimmarrjen lokale dhe qendrore t'i shohin këto çështje më me prioritet dhe në dobi të vendit.

Kritikat dhe recensat për botimet e autorëve dibranë, të shkruara me profesionalizëm dhe të botuara në faqet e gazetës, janë bërë pika referimi për studiuesit e kësaj fushe, duke e krahasuar gazetën Rruga e Arbërit me mediume të rëndësishme kombëtare.

Figura historike të harruara ose pak të shkruara për to, janë rikujtuar për lexuesin nga studiues të historisë dhe dashamirës të saj.

Në këtë kuadër, duke pasur kërkesa për të rritur në një stad më të lartë mënyrën e shkrimit dhe paraqitjes, si dhe duke marrë në konsideratë edhe mediat e reja, kryesisht online, që kohët e fundit janë shtuar në hapësirat dibrane, gazeta "Rruga e Arbërit" ka si qëllim ruajtjen e zërit origjinal të saj, duke e vendosur veten kështu jo në konkurrencë me to, por një zë të pazëvendësueshëm në hapësirat mediatike rajonale.

Gazeta prej disa kohësh ka nisur të botojë shkrime dhe foto, që ruajnë origjinalitetin dhe autorësinë, duke dëshmuar kështu se është e përkushtuar të ruajë të drejtën e autorit për çdo rast dhe, kur ka qenë e nevojshme, të shënojë edhe falënderimet përkatëse.

(Vijon në faqen 2)

RAJONI

Nacionalizmi, si forcë e fuqishme politike ...

Nga **Prof. Dr. BASHKIM RAMA** - FAQE 10

REPORTAZH

Shumbati ose Myzeqeja e Dibrës

Nga **SHAQIR SKARRA** - FAQE 4-5

HIPOTEZË

Rreth origjinës së fisit Gropaj nga Zogjet

Nga **Prof. Dr. BASHKIM LLESHI** - FAQE 2

Shfaqet dokumentari për rrugën e Arbërit në "Dibra TV". Si po vazhdojnë punimet dhe prespektiva

ËNDRRA PO AFRON



Punimet në rrugën e Arbërit. Foto © Bujar Karoshi. Tetor 2012

Më datë 26 janar, në Pallati e Kulturës në Dibër të madhe, në prani të qindra qytetarëve u prezantua dokumentari mbi rrugën e Arbërit, prodhim i Dibra TV. Dokumentari pasqyron një historik të idesë së rrugës si dhe gjendjen e tanishme të punimeve në këtë aks rrugor me rëndësi kombëtare. Dokumentari rizgjon edhe njëherë dëshirën për të mbaruar sa më shpejt punimet e rrugës, duke na kujtuar se kjo fushatë elektorale do ta ketë si çështje kryesore në programet e partive politike.

STAFI REALIZUES:

Idea dhe sponsor kryesor i dokumentarit është Afrim Lela. Regjia & montazhi: Iron Lela. Skenari & vizualizimi: Rexhep Qormemeti. Redaktor: Naim Lleshi. Lexoi tekstin: Arian Oboku. Zërimi: Evzi Kaja. Kamera & Fotografia: Ilir Lela, Iron Lela. Ndihmës teknik: Bleron Seferi. Intervistat në terren: Arian Oboku, Rexhep Qormemeti. Intervistat në studio: Valmir Lleshi Ndihmës në terren: Ulvi Hysa, Dehar Muça, Bashkim Lleshi, Bujar Karoshi. Prodhimi: Dibra TV janar / 2013.

Teksti artistik i dokumentarit është hartuar nga Nuri Koleci, të cilin ne po e botojmë më poshtë:

Nga **NURI KOLECI**

Rrugët i afrojnë njerëzit. Rrugët i vrasin largësitë ndërmjet njerëzve. Të gjithë udhëtojnë diku. Që nga lashtësia e deri me sot rrugët që të shpien diku nuk kanë pushuar së ndërtuari. Ashtu ka qenë dikur, ashtu është sot, dhe pse mos të jetë edhe nesër.

Shteti ynë, që përjetoi një izolim të paparë, mbeti në guaskën e sistemit monist afër gjysmë shekulli. Muri i çeliktë ndërmjet shqiptarëve ndau një popull që ka të njëjtin gjak, të njëjtën gjuhë, të njëjtat ëndrra.

Sot është tjetër kohë. Kohë, ku bota shlyen kufij, kohë që zhvillimi i teknologjisë, shkencës dhe kulturës në tërësi nuk durojnë më ndarje. Konferencës së Londrës i themi le të heshtë në shtratin e turpit të historisë. Asaj i themi që të kthejë kokën kah shqiptarët dhe të shikojë mëkatet e bëra duke operuar me sy të mbyllur së copëtuari pamëshirshëm trojet shqiptare.

Sot është koha jonë. Shqiptarët nuk frenojnë rrugë e ura. Ata lidhin dejet e tyre dhe rrjeti i rrugëve drejt botës së qytetëruar sa vjen e shtohet. Dhe po shtohen, do të shtohen deri në amshueshmëri ...

Shqipëria, shteti ynë mëmë, po plotëson çdo gjë nga e kaluara aq e hidhur dhe aq e kobshme. Rrugëtojnë shqiptarët drejt njëri-tjetrit. Kombi ynë ndërton rrugë e pse të mos quhet "Rruga e kombit", që lidh Kosovën legjendare me shtetin mëmë? Na duhen këto rrugë që të paktën shpirtërisht të jemi njëri pranë tjetrit. Sot edhe distancat janë shkurtuar. Vizitat janë shtuar dhe shtohen. Bashkëjetojmë dhe bashkëfestojmë se është e drejta jonë natyrore. Askush nuk mund të na ndalojë. Ne lidhemi me zinxhirin e gjakut tonë, shpirtit tonë. E ndërtojmë të nesërmen tonë të përbashkët.

Po "Rruga e Arbërit" flen apo vlon? Hesht apo na zgjon? Ku ishte? Ku është? Ku do të jetë? Sa afër, aq larg. Dibra - Tirana në largësi ajrore shumë afër. Në atë tokësore, shumë larg. E dibrani nuk e harron historinë, sepse në të kaluarën ka qenë kalitës i të njëjtës. Nëpër të gjitha shtigjet e historisë e gjen dibranin bashkë me trimërinë, bujarinë, mikpritjen dhe mençurinë.

"Rruga e Arbërit" ka lindur që në kohën e ilireve. Penestët që kanë jetuar në trojet e krahinës së Dibrës kanë ditur që të shkurtojnë largësinë me Durrësin bregdetar. Ajo ka gjallëruar nëpër histori. Nëpër këto male kane ecur të parët tanë për të bërë tregti. Edhe ata kanë blerë në Durrës kripë, vajguri dhe artikuj të tjerë. Historianët thonë se kjo rrugë ka kaluar nëpër territorin e shtetit të Arbërit, ndaj edhe e mban këtë emër. Nuk ka mbetur kot thënia jonë popullore, që dibranët e përdorin shpesh: "E lirë është kripa në Durrës, po se mban barra qiranë".

(Vijon në faqen 3)

cyan magenta yellow black 1

Rruga e Arbërit nr. 81

debat



Lugina e fshatit Gropa e Zogje fotografuar nga Xhiteca e Sute (Qytezë e herëshme) në Livadhe të Epra. Në horizont Sharra e Zogje dhe mali i Shehrit të Dibrës.
© Foto: Bashkim Lleshi, Tetor 2011

Fisi i Gropajve të Dibrës së Epërme mund ta ketë origjinën nga "Gropa" e Zogje në Grykë të Vogël

Nga **BASHKIM LLESHI**

Gjatë leximit me vemendje të veprës monumentale për historinë e Dibrës të Akademik Profesor Kristo Frashërit "Historia e Dibrës" botuar në kuadrin e 100 vjetorit të pavarësisë në tetor 2012, më tërhoqi vemendjen emërtimi i fshatit Zogje në dy lagje : Gropa dhe Kodra, në regjistrimin Austro-Hungarez të vitit 1916.

Në këtë regjistrim të popullsisë së qarkut të Dibrës nga administrata e Perandorisë së Austro-Hungarisë kryer në vitin 1916 për fshatin Zogje jepet për herë të parë në dokumenta emërtimi i vjetër i fshatit i quajtur "Gropa". Botuar në Vjenë Laipzig më 1922 (Kristo Frashëri 2012, faqe 593). Ky emërtim përdoret edhe sot nga vendasit si : jam nga "Gropa e Zogje ", po shkoj në "Gropë të Zogje", kam bërë mik një nga "Gropa e Zogje" etj.

Mora shkas nga ky emërtim për të hedhur idenë se ndoshta edhe fshati "Gropa" i Dibrës së Epërme nga e ka origjinën fisi i Gropajve, që thuhet se ka qenë në Grykën e Madhe, por sot është zhdukur, mund të jetë "Gropa " e Zogje që më vonë ka marrë emrin "Zogaj", sot "Zogje" nga i pari i fisit "Zogu". Pra ka mundësi që edhe Pal Gropa, pinjolli i parë i familjes së Gropajve, bashkëkohës i Pal Kastriotit të jetë nga "Gropa" e Zogje.

Akademik Profesor Kristo Frashëri në veprën "Historia e Dibrës" shkruan : "Si dëshmi për strukturën shoqërore në Dibrën e Epërme ne kemi një akt te kancelarisë anzhuine – një diplomë të Karlit I Anzhuin, mbretit të "Mbretërisë së Arbërisë", lëshuar më 18 maj 1273, në favor të Sevastit Pal Gropa. Mbiemrin e tij ky sevast duket se e kishte marrë nga emri i fshatit Gropa, një vendbanim me kohë i zhdukur, i cili ka ekzistuar në rrethinat e Zerqanit... Pra ka shumë mundësi që Pal Gropa ndoshta dhe paraardhësit e tij të kenë qenë edhe më parë, krerë të feudalizuar të Dibrës së Epërme dhe se mbreti anzhuin, në diplomën që ka nënshkruar me 18 maj 1273, nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka ripohuar një pozitë të tij të mëparshme. Në diplomë thuhet tekstualisht:

"Peskara 18 maj 1273, Karli I mbret i Siqelisë, burrit fisnik sevastit Pal Gropës për shërbimet e tija, i fal fshatin Radikë e Madhe (Radicis maioris) dhe Radikë e Vogël (Radicis minoris), si dhe Kovashicën (Cobashetes), Vau i Gjoricës (Zuadigorica), Zerqanin (Sirclani) dhe Krajkën (Craye), Zeshicën (Zessizan) të vendosur në luginën e Ebu-s (ndoshta në luginën e Bulqizës), mjaft të mos jenë pjesë e mbretërisë sonë të Arbërisë, as të mbretërisë së Serbisë..." *(Kristo Frashëri 2012, faqe 78)* dhe më tej vazhdon :

"...Ndërsa në Dibrën e Epërme e rivendosi autoritetin e saj familja e mëparshme e Gropajve, në Dibrën e Poshtëme hyn në skenën e historisë një familje e panjohur më parë, ajo e Kastriotëve. Pinjolli i parë i familjes së Gropajve që përmendet në burimet e shkruara historike, është Pal Gropa. Ai përmendet në diplomën e cituar më lart të Karlit të I Anzhuin të Mbretërisë së Shqipërisë lëshuar më 18 maj 1273, me të cilën i dhuron burrit fisnik, Sevastit Pal Gropa për shërbimet e kryera, disa fshatra të Grykës së Madhe dhe të Grykës së Vogël(Acta Diplomata, etj.Vëll.I. Dok.nr.300). Viset e dhuruara duket se pajtohen me faktin se Gropajt, sikurse u tha, ishin me origjinë nga fshati sot i zhdukur Gropa, që dikur ndodhej në Grykën e Madhe të Dibrës së Epërme. Më vonë, siç e dëshmon historia e saj, familja e Gropajve, u kthye në një familje dinastike tepër e fuqishme, e cila selinë e vet e shpërnguli(se nuk e dimë me saktësi), nga qyteti i Dibrës në qytetin e Ohrit." (Kristo Frashëri 2012, faqe 83).

Mbështetur në këto dokumenta mund të mendohet se po të ishte fshati "Gropa" në rrethinat e Zerqanit, nuk kishte pse ti falej Zerqani se për fuqinë që kishte ky fis, Zerqanin duhet ta kishte të tijin, por ai ka mundësi të ketë qenë nga Gropa (më pas Zogje) dhe i kanë falur, Kovashicën, Vaun e Gjoricës dhe dy Radikat (Këto lidhen me lumin Radikë dhe jo me dy Grykat, e Madhe dhe e Vogël) për të dalë në Dibër, si dhe Krajkën, Zerqanin e luginën e

Bulqizës për të dalë në Mat e më poshtë.

Pra diploma që ka marrë Pal Gropa " Për shërbime të kryera në disa fshatra të Grykës së Madhe e Grykës së Vogël " (Kristo Frashëri 2012, faqe 83), mund të çojë në mendimin që fshati "Gropa" që nuk gjendet në Grykën e Madhe të Dibrës së Epërme, nga mendohet se e ka origjinën fisi i Gropajve, mund të jetë Gropa e Zogje në Grykën e Vogël, po në Dibrën e Epërme.

Në mbështetje të kësaj ideje mund të jetë edhe një e dhënë tjetër e rëndësishme, toponimi "Ara e Palit", afër kishës së Shën Kollit të Gjurasit, në malin e Zogje. Toponime të tilla ruheshin vetëm për më të shquarit e fiseve. Ky mendim mund të mbështetet edhe në faktin se, në Gropën e Zogje e rreth saj kemi disa kisha dhe më të rëndësishmen atë të Gjurasit të ndërtuar brenda në Kala, në kufi me Gropën e Zogje, ndërsa në Grykën e Madhe, në afërsi ose për rreth Zerqanit ku mund të ndodhej fshati Gropë, nuk kemi asnjë të dhënë për ndonjë kishë të rëndësishme pranë këtij fisi katolik me emër, si Gropajt.

Kjo ide ngelet për tu ndjekur nga hulumtuesit e ardhëshëm, që mbështetur në dokumenta të reja që mund të gjenden në arkiva të vërtetojnë ose jo këtë mendim.

Redaksionale

"Rruga e Arbërit", një zë origjinal në median e shkruar

(Vijon nga faqja 1)

Gazeta ka synim që në të ardhmen të fokusohet të shkrimet ekskluzive të bashkëpunëtorëve të saj, shkrimet origjinale të tyre. Çdo shkrim do t'i nënshtrohet kontrollit të plagjiaturës apo kopjimit dhe për çdo rast, kur konstatohet një gjë e tillë, materialet nuk do të botohen.

Gjithashtu, redaksia i njofton bashkëpunëtorët e saj, se të njëjtat shkrime të botuar në mediumet e tjera nuk do të mund të botohen në faqet e gazetës, përveç rasteve kur çështja mbetet aktuale dhe e nevojshme për riinformim.

Redaksia angazhohet si deri më tani, të krijojë më shumë hapësira dhe t'u japë mbështetje zërave të rinj në fushën e publicistikës, letërsisë, gazetarisë, sidomos gjimnazistëve dhe studentëve.

Gazeta i fton të rinjtë të fokusohen jo vetëm në krijimtarinë e tyre, por edhe në problematikën që shqetëson komunitetin ku ata jetojnë dhe punojnë, duke i dhënë më shumë zë mendimit dhe shqetësimit të qytetarëve.

Gjithashtu, besojmë se në të ardhmen edhe të zgjedhurit vendorë do të kenë më shumë dëshirë dhe vullnet, që nëpërmjet gazetës të komunikojnë me bashkëqytetarët e tyre jo vetëm në prag fushatash elektorale, por gjatë gjithë kohës që qeverisin.

Gazeta ka synim që në të ardhmen të fokusohet të shkrimet ekskluzive të bashkëpunëtorëve të saj, shkrimet origjinale të tyre.
Gazeta, si deri më tani, do krijojë më shumë hapësira dhe do t'u japë mbështetje zërave të rinj në fushën e publicistikës, letërsisë, gazetarisë, sidomos gjimnazistëve dhe studentëve.


Redaksia fton gjithë bashkëpunëtorët dhe lexuesit e saj ta mirëpresin dhe të na mbështesin në këtë përpjekje për krijuar një model të ri dhe të veçantë të gazetës "Rruga e Arbërit", duke i dhënë më shumë medias rajonale, si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor dhe, njëkohësisht, lexuesve të saj një aromë të re nga vendlindja. **(B.Karoshi)**

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 1 (81). 1 - 31 Janar 2013

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë Fejzulla Gjabri, Naim Plaku, Jahe Delia Selmani, Resul Bedo, Fejzulla Gjabri, Haki Pernezha, Abdurahim Ashiku, Sakip Cami, Mustafa Tola, se shkrimet e tyre jane në redaksi dhe do shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:
Nuri KOLECI
Bashkim RAMA
Xhafer MARTINI
Abdurahim ASHIKU
Rexhep TORTE
Arben MUKA
Fejzulla GJABRI
Qazim PREJSI
Bedri TAHIRI
Ramiz GJINI
Ilir SPATA
Ali HOXHA
Rruzhdi BITRI
Dionis XHAFA
Sakip CAMI
Mentor HOXHA
Faik XHANI
Mevlud BUCI
Naim BERISHA
Halil RAMA

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

aktualitet

Si vidhet dhe kontrabandohet kromi nga minierat e Shqipërisë

Emisioni investigativ "Fiks Fare" në Top Channel jep fakte tronditëse për grabitjen e pasurisë kombëtare





REAGIM I ISH-DREJTORIT TË POLICISË SË DIBRËS, SHEMSI PREMÇI:
"Atë që kam thënë unë para 8 muajsh u provua më së miri nga gazetarët investigativë, të cilët e sollën në ekrane televizorit live se si ishin intervistuar, si shiteshin licencat, si ishin te mbivendosura licencat, si vidhej pasuria e nëntokës, si transportohej deri në Durrës dhe si shkonte drejt Kinës. Me Milionë, mos me miliarda dollarë".

Për disa ditë me radhë, emisioni investigativ "Fiks Fare" ka shfaqur një nga grabitjet më të mëdha që po i bëhet pasurisë kombëtare, atij të shfrytëzimit mineral në vendin tonë e konkretisht mineralit të kromit. Në ditën e parë, gazetarët investigativë kanë denoncuar grabitjen e kësaj pasurie në minierat e palicencuara të Bulqizës. Gjatë investigimit të "Fiks Fare", punonjësit e galerive dhe rojet e tyre janë shprehur se "shfrytëzimi pa kriter i vendburimeve minerale ka mbushur komplet malin e Bulqizës me vrima, që rrezikon të shembet, duke rrezikuar jetë njerëzish. Po kështu, ka pronarë të këtyre minierave, të cilët vendosin këmbë druri nëpër galeri, duke përfituar nga moskontrolli i tyre nga ana e inxhinierëve". Ndërsa në një bisedë me një banor, "Fiks Fare" ka sjellë para ekranit edhe një fakt tjetër korruptiv. Një nga banorët e këtij rrethi ka treguar se kishte aplikuar për të marrë licencën, por sipas tij, marrja e licencës kushtonte 100 mijë euro dhe kjo kishte bërë që ai të tërhiqej nga marrja e licencës. Në këto kushte, ai ka pritur kunatin e tij për ta marrë licencën dhe ka punuar me dokumentacionin e tij. Gjatë bisedës, ai ka treguar se pavarësisht se nuk kishte licencë, ai mund të pajisej me një bllok shënimi pa TVSH dhe pa numër NIPT-i, ose mund të gjente letra të firmave të tjera për të transportuar mineralin drejt Durrësit. Ndërsa në një tjetër bisedë të gazetarëve, është një roje i galerive, nga i cili është mësuar se "firmat që merren me shfrytëzimin e kromit, vazhdimisht konfliktohen dhe për këtë është fajtor shteti". Sipas tij, njërës firmë i jep leje për zbulim dhe në të njëjtën pikë dhe koordinatë i jep leje firmës tjetër për shfrytëzimin e mineralit.

Të njëjtën gjë ka pohuar për gazetarët edhe një përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë që kishte shkuar për një kontroll. "Situata në Bulqizë është mjaft problematike. Kjo vjen për arsye se shteti ka pajisur me leje disa firma në të njëjtin vend dhe kjo ka sjellë përplasjen e pronarëve të minierave që shfrytëzohen prej tyre", shprehet zyrtari.

Po kështu, një pronar i një galerie ka treguar se transportin e mineralit e kryente me dokumente të një tjetër firme. Ndërsa roja i një subjekti privat është shprehur se "në një galeri në Bulqizë punon në të njëjtin vend si ACR-ja, ashtu edhe privati",

Ndërsa në ditën e dytë të transmetimit të këtij investigimi të gjatë, "Fiks Fare" ka ndjekur ankesën që pronari i një subjekti privat në Has të Kukësit, ka bërë në adresë të këtij emisioni. Sipas Rexhep Dautit, pronar i firmës "Elidoni 06", subjekte të palicencuara futen në zonën ku ai ka licencë, pikërisht në fshatin Vlahën të Hasit, duke grabitur mineralin dhe pasi e nxjerrin atë nga galeritë, e pajisin me dokumente të formës së licencuar dhe e dërgojnë në Durrës dhe në Devë të Gjakovës. Ai është shprehur se është tatimpagues i rregullt i shtetit. Ndërkaq, ai denoncoi drejtuesit e Policisë së Hasit, por edhe punonjës të policisë, që sipas tij, mbështesin firmat e palicencuara për të grabitur pasurinë kombëtare. Dauti kishte bërë denoncim disa herë në Policinë dhe në Prokurorinë të Kukësit e deri te Prokuroria e Përgjithshme. Madje, i ishte drejtuar Kryeministrit dhe Presidentit, por nuk kishte gjetur zgjidhje. "Fiks Fare", nëpërmjet pamjeve filmike kishte arritur të kapte firmat e palicencuara, që merrnin kromin në mënyrë të paligjshme në Vlahën dhe e transportonin deri në një pikë grumbullimi në Has. Pasi e shkarkonin, minerali ngarkohej në një tjetër mjet dhe dërgohej për në Durrës. Gjatë gjithë rrugës, gazetarët kishin ndjekur itinerarin e lëvizjes së mjeteve dhe momentin kur mjeti që udhëtonte për në Durrës pajisej me dokumente të shoqërimit të mallit nga një subjekt i licencuar. Në momentin e mbërritjes në Portin e Durrësit, gazetarët biseduan edhe me drejtuesin e mjetit që solli ngarkesën, i cili u shpreh se kishte dy vite që sillte mineral në Portin e Durrësit. Ai tha se nuk kishte asnjë problem me policët, pasi ata e dinin se ai transportonte mineral të varfër, të cilin e pajiste me fletë shoqërimi, sikur do ta dërgonte në Fllakë dhe jo në Portin e Durrësit. Kur gazetarët i kërkuan të transportonte një sasi kromi nga Kalimashi në Durrës, sasi minerali që e kishin të marrë pa licencë, drejtuesi i mjetit u shpreh "flisni me firmat që ta nxjerrin deri në anë të autostradës, më pas e bëj unë dokumentacionin nëpërmjet dajës (të cilin e kishte pronar të një subjekti të licencuar) dhe ua sjell unë deri në Durrës pa problem, pasi policia nuk më ndalon". Më pas, gazetarët kanë kontaktuar inspektorin e sheshit të Portit të Durrësit Flamur Kastrati. Gazetari, në takimin me të, i ka kërkuar një shesh për hedhjen e mineralit në port, pasi më pas do ta dërgonte jashtë shtetit. Përfaqësuesi i shtetit në Portin e Durrësit i ka ofruar gazetarëve 300 metra katrorë në port, ndërsa u ka kërkuar atyre një milion në gjysmë lekë, pasi mineralin do ta fusnin aty me ermin e një firme tjetër, të cilën Kastrati ua adresoi gazetarëve. Gjithashtu, ai është shprehur se nuk duhet të paguajnë as katër e as dhjetë lekë për shtetin. "Mjafton kjo sasi lekësh që të mbyllni të gjithë shpenzimet në këtë port", u shpreh ai. Ky investigim ka treguar se nga Hasi deri në Durrës të gjitha hallkat që duhet të funksionojnë për goditjen e kontrabandës ishin bashkëfajtore.

Ndërsa në ditën e tretë, gazetarët kanë investiguar sesi dërgohet kromi në Devë të Kosovës. Një nga pronarët e një karriere kromi në fshatin Cahan të Hasit është shprehur se "kishte kohë që punonte duke nxjerrë krom". Pasi e nxirrte në karrierën e tij, ai e dërgonte në Has, e prej aty e merrte një firmë nga Kosova, duke e dërguar në një fabrikë të pasurimit të kromit në Devë të Gjakovës. Pronari është shprehur se për transportin e mineralit përdorte emrin dhe vulën e një subjekti tjetër të licencuar, por që nuk kishte punuar asnjëherë për nxjerrjen e mineralit. Sipas pronarit të karrierës së palicencuar, ky nuk ishte rasti i parë që dërgonte krom në Kosovë me dokumente të falsifikuara, por kishte më shumë se një vit, pasi kishte edhe mbështetjen e policisë. Pas kësaj bisede, gazetarët kanë ndjekur të gjithë itinerarin e lëvizjes së mjeteve, që nga ngarkimi në Has e deri në fabrikën e pasurimit të Kromit në Devë të Gjakovës. Mjeti që ka ngarkuar kromin me dokumente false ka kaluar në Kosovë e më pas e ka shkarkuar në Fabrikën e Pasurimit. Edhe në këtë fabrikë, gazetarët kanë kontaktuar me një nga bashkëpronarët e kësaj fabrike, ku kanë mësuar se "pronari ka pesë licenca dhe tri prej tyre i ka në minierat e Bajram Currit". Por, ai ishte i detyruar të mos i shfrytëzonte, pasi nuk i ishte rinovuar leja për shkak se i kishin kërkuar para për ta kryer një gjë të tillë. Ndërsa ka pranuar faktin që merret prej vitesh me krom në Has e Tropojë dhe e kalonte atë pa problem në doganën e Qafë-Prushit, mjaftonte të paguante renderën minerale. Një fakt tjetër interesant që ka treguar pronari i kësaj fabrike është ai se ndryshe funksionojnë organet qeverisëse në Shqipëri e ndryshe në Kosovë. "Nëse në Kosovë ke letrat e rregullta, nuk të kërkon kush qoftë edhe një kafe", ka përfunduar bashkëpronari i kësaj fabrike.

Gazeta "Shqip", 18-01-2013

Shfaqet dokumentari për rrugën e Arbërit në "Dibra TV". Si po vazhdojnë punimet dhe prespektiva

(Vijon nga faqja 1)

Edhe kjo thënie tanimë mbetet në thesarin e gjuhës sonë vetëm si thënie. Durrësi tanimë nuk është larg. Do të afrohet edhe më tepër me Dibrën. Kjo ëndërr e kahmotshme në një të afërme tejet të afërt po shndërrohet në realitet. Ne njëmend dimë t'i vrasim largësitë.

Në vend të karvanëve me kuaj e mushka të tregtarëve të dikurshëm, këndej do të kalojnë automjetet e të gjitha llojeve. Afërsia ajrore me Tiranën po realizohet edhe me afërsi tokësore. Së shpejti zona jonë malore, krahina e Dibrës në tërësi, ka për t'u lidhur edhe më shumë me ultësirën e bregdetit shqiptar. Dhe përsëri na kujtohet thënia: "Afër detit, afër mbretit". E ne kemi përparësinë se do të jemi edhe afër mbretit - Tiranës dhe afër detit - Durrësit.

Kjo rrugë antike, fatkeqësisht, gjatë sistemit të një ideologjie të rrejshme për pesë dekada ka fjetur në gjumë të thellë. Askush nuk e ka përmendur e lodhur trurin se e njëjta kërkon të gjallërohet. Në pluralizëm, intelektualët shqiptarë, vetë dibranët e Peshkopisë, të Dibrës së Madhe dhe ata që jetojnë në Tiranë shpenzuan dije dhe kohë, me të vetmin qëllim që ta gjallërojnë këtë rrugë të mirëpritur nga të gjithë.

Sot e tutje kjo rrugë nuk do të mbetet vetëm si legjendë. Çdo fillim ka mbarimin e vet. Dhe duam që të shlyejmë nga truri i skeptikëve te të cilët dominon bindja se me ndërtimin e rrugës ka zvarritje të

pashpjegueshme, njëherit edhe të nxisim ca më shumë Qeverinë Shqiptare që ëndrrën e kahmotshme ta bëjmë realitet.

Punët ecin dhe ne bashkë kalojmë andej ku rruga është e ndërtuar, andej kah është e trasuar dhe andej kah duhet të ndërtohet së shpejti.

Ecim nëpër male të mbushura plot me gjurmë historish, rrënoja kalash, ura të vjetra, rrënoja hanesh gjithmonë të rrethuara me bukuri përrallore të këtyre trevave. Ecim drejt vendbetejave të popullit shqiptar që dëshmoi një trimëri të paparë. Sa e sa herë ka shkelur këtej Skënderbeu me bashkëluftëtarët e tij ....

Duket ende se këtej frymon Pal Engjëlli, që na la dokumentin e parë të gjuhës sonë të lashtë. Pjetër Budi këtej ka shkelur, nëpër këta shkëmbinj.

Kalojmë nëpër krahinën e Matit, që popullit shqiptar i ka dhënë shumë. Në këto vise është prodhuar baruti, por edhe është përdorur. Kudo që shkelim, imagjinata jonë shtohet dhe shtohet. Gjeologët, ata gjurmues të resurseve nëntokësore na nxisin të mendojmë se nëpër këto vise të një natyre pothuajse virgjine dhe

tejet magjike, ka edhe pasuri të pashtershme nëntokësore, metale dhe jo metale ... Shpresat e gjallërimit kanë mbetur në duart tona. Në duart shqiptare. Presim me padurim që kjo rrugë regjionale të rivitalizojë ekonominë, të zbusë shpërnguljet e njerëzve. Na presin ditë më të bardha.

Kjo shpresë dëshmohet me ofrimin e ndihmës së banorëve të këtyre viseve që nuk përtuan që të ecin bashkë me ne orë të tëra drejt gjurmëve të vjetra të Rrugës së Arbërit dhe gjurmëve të reja andej kah gumëzhijnë makineritë e trasimit të kësaj rruge të shumëpritur.

Malet me gropa. Fenomen i rrallë natyral. Të përvetësojnë me bukurinë e tyre. Kjo rrugë, që do të jetë pranë këtyre peizazheve mahnitëse, sigurisht që do të tërheqë turistët malorë dhe nuk ka të ngier nga këto bukuri joshëse që të përvetëson e si shmangesh dot ... .

Afrohemi drejt Tiranës. Në afërsi të liqenit të Bovillës, prej ku Tirana shuan etjen. Takohemi me dibranë të Tiranës. Të gjithë kanë të njëjtat shpresa. Të njëjtin entuziazëm dhe dëshirë. Në sytë e tyre lexohet një optimizëm që edhe më skeptikët i zgjon nga gjumi.

Ky rrugëtim që ne e shkelëm dhe patëm rastin që ta shpalosim në këtë emision, ka qëllim që shikuesit t'i ngjallin shpresat dhe njëherit të dëshmojmë se gjërat po lëvizin drejt ëndrrës, e cila nga dita me dite përqafon realitetin e shumëpritur. Njëherit, nëse eventualisht paraqiten zvarritje eventuale edhe nga faktorët politikë, le të jetë ky emision përshpejtues i dëshirave tona të përbashkëta.

Që të gjithë nga Tirana, Mati, Dibra, Gostivari, Tetova, Shkupi, Kosova e më gjerë e mirëpresim mbarimin e kësaj rruge që na zgjeron një zhvillim të gjithanshëm në të gjitha sferat e jetës.

N.KOLECI

Rruga e Arbërit nr. 81



Shumbati
ose Myzeqeja e Dibrës

reportazh

Që të arrijmë në konkluzion se Shumbati është vend prehistorik na vijnë në ndihmë jo vetëm gjetja e sopatës së gurit, por dhe gjetje monedhash e një kandili të periudhës së Justianit që përkon me vitet 527-565 të cilat dëshmojnë për një zhvillim ekonomik gjatë shekullit VI

Nga **SHAQIR SKARRA**

Poshtë nën këmbët e Korabit legjendar e deri në brigjet e Drinit të Zi, nga Përroi i rrëmbyer i Kapçit e deri në përruan e Madh shtrihet një fushë e gjërë e mjaft pjellore e cila në gjeografinë e Shqipërisë njihet si fusha e Shumbatit. Për nga madhësia kjo fushë është e dyta në Dibër pas asaj të Kastriotit. Jo më kot në vitet e regjimit totalitar, e quanin Fushën e Shumbatit hambar për gjashtë fshatrat e ish kooperativës bujqësore Sllatinë, ose "Myzeqeja" e Dibrës. Sot e gjitha kjo fushë mjaft e madhe dhe pjellore, të vetmin burim për vaditje ka rezervuarin e fshatit, i cili nuk i plotëson nevojat e saj. Për vaditjen e tokës shumbatasit herët kanë blerë me flori Gurrën e Dypjakës, e cila vadiste një pjesë të fushës së madhe të Shumbatit. Hapja e kanalit të Vleshës dhe Çernjevës për shumbatasit ka qenë një ngjarje historike. Uji i pijshëm ka qenë një problem tjetër për shumbatasit. Jo që nuk kishte burime e kroje, ato ishin të shumta në fshat por fakt është se të gjitha ishin larg. Me ardhjen e ujit të pijshëm në fshat nga bjeshkët e Korabit ku sot çdo shtëpi e ka futur brenda këto kroje dhe burime kanë mbetur thjeshtë si toponime që ende ndjejmë mallë. Megjithëse Shumbati nuk është më shumë se 600 metra mbi nivelin e detit, stina e dimrit është tepër e ftohtë, me ngrica e reshje të shumta dëbore. Përjashtim bën vetëm stina e verës, e cila është e ngrohtë dhe mjaft e begatë. Në Shumbat kultivohen të gjitha pemët, bimët dhe lulet që ka falur natyra. Si fshat është bërë i njohur për kultivimin e kumbullës, nga ish NB, ku varietetet e ndryshme të saj mbushnin tregjet e perëndimit. Jo vetëm kumbulla, por edhe dardha, një varietet dardhe i veçantë që kultivohej vetëm në Shumbat e quajtur dardha e kuqe, molla, rrushi, qershia, jonxha, fasulja, gruri e misri. Para viteve të çlirimit dushku rritej me shumicë në të gjithë luginat dhe kodrinat e fshatit. Këto pyje dushku plotësonin nevojat e fshatarëve për dru zjarri, si dhe me lëndë ndërtimi dhe mbronin tokën nga erozioni. Ashtu siç është e pasur dhe mjaft pjellore Fusha e Shumbatit, edhe nëntoka e saj fsheh rezerva minierare. Shfrytëzimi i tyre është në dobi jo vetëm të fshatit, por dhe të fuqizimit të mëtejshëm të ekonomisë së vendit. Sipas studimeve të kryera nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Dega Rajonale Peshkopi rezulton si ma poshtë: Në fshatin Shumbat e pikërisht në lagjen Hurdhë, afër kroit të Xhipit, ka depozitime të shumta minerale të kalciumit dhe natriumit(Shape), kripëra. Këto duken në sipërfaqen e gurëve në shpatin përballë fshatit. Ka me shumicë vonadium(që përdoren për telat e dritave elektrike) dhe grafit(që gjen përdorim për prodhimin e lapsave). Tereni mjaft i thyer nuk mund të jetë pengesë për shfrytëzimin e tyre. Shumbati është i pasur dhe me argjil të shumtë e mjaft cilësor. Argjila gjen përdorim në ndërtim. Këto studime me mjaft vlera për fshatin, janë kryer nga inxhinieri gjeolog Nexhat Hysa. Që në lashtësi besohet të jetë shtrirë Shumbati në kufi me Dypjakën, në kufirin aktual të sotëm, në përroin e Kapçit e shtrihej deri në Salbatra por gjithmonë në anën e majtë të Shkekës, pra përgjatë luginës. Sipas të dhënave gojore flitet se kjo zonë ka qenë një qytet i madh antik, dhe pikërisht kjo shtrirje luginës ishte bërë për arsye që të mbrohej nga të ftohti dhe erërat e shumta që frynin në stinën e dimrit. Varrezat kanë qenë në kodër si Lbuzhdë, varret e Gjovaçit, varret e Butme, varret e Fanës. Të paktën që nga koha e pushtimit romak, pa folur për vite ma parë, dy fshatra njiheshin të mëdhenj në Dibër;Shumbati dhe Maqellara. Fak është se të dy kishin një shtrirje gjeografike nga brigjet e Drinit të Zi dhe ngjiteshin deri rrëzë maleve të larta. Ka një hipotezë për emërtimin e fshatit se pikërisht i ka mbetur ky emër që ka nga fjala "shumë i madh" Megjithatë kjo le të mbetet thjesht një hipotezë , një nga opsionet e lëshuara pasi nuk na bind plotësisht për emërtiminin e fshatit. Shtrirja e Shumbatit në mesjetë ka qenë nga Ura e Lushës, përroi i Kapçit apo i Blliçes e dilte në Dypjakë. Vazhdonte përsëri poshtë rrjedhës së Drinit të Zi e dilte afër mëhallës Topuze, ngjitej lart përroit të Madh e arrinte në afërsi të Zhuparrave. Shumbati kishte dy mëhalla dhe sejcila ishte më e madhe se tjetra. Ishte pikërisht përroi i Biçasë(Ozunit) ai që ndante fshatin në dy mëhalla. Në popull tregohet se Shumbati në kohë të hershme ka qenë një qytet antik mjaft i madh ku shtrirja e tij zinte fill nga Salbatra e arrinte në afërsi të Dypjakës. Thonë se në Salbatra ishte një kishë disi e veçantë dhe me pasuri të mëdha.

Të moshuarit tregojnë se këmbana e kësaj kishe dëgjohej në Dibër të Madhe në rast meshe. Qyteti shtrihej më së shumti në anën tjetër ku përballë është fshati Blliçe dhe Rrenx pasi këtu ishte më i mbrojtur dhe nga kushtet atmosferike. Pikërisht këtu është dhe Kodra e Kalasë si dhe Bukadolli, vende të hershme dhe me bazë të sigurtë për të gërmuar kazma e arkeologut . Kur turqit erdhën në vendin tonë tregojnë se qytetin e shkatëruan totalisht. Prishën dhe kishën duke rrëmbyer dhe pasuritë e saj. Edhe pse asnjëherë nuk janë bërë gërmime arkeologjike, gjetje sporadike ka patur shumë në Shumbat. Nga nxënësit e shkollës së fshatit është gjetur një sopatë prej guri, të vrimuar me përmasa 26. 5x7. 5 centimetra e cila i përket periudhës së vonë të gurit të latuar-1)

Gjetje të tilla si fragmente enësh, vegla pune prej guri, qeramikë, tulla e tjegulla që i përkasin periudhave të hershme ka patur dhe tek kalaja e Bukadollit në Shkekë. Në Shumbat kanë ekzistuar gjashtë objekte kulti(kisha). Një ndër kishat më të mëdha të fshatit ka qenë kisha e Shënmateut. Kjo kishë e mori emrin nga vetë prifti që e ndërtoi dhe shërbeu për një kohë të gjatë si prift pranë kësaj kishe. Nga emri i kësaj kishe është dhe hipoteza bindëse se dhe vetë fshati Sumbat i mbeti nga kjo kishë. Për ekzistencën e kësaj kishe përveç toponimit që ende ndodhet në Shumbat na bind dhe një fakt mjaft interesant. Në prag çdo katastrofe dhe rrënimi kishat kishin si mision të shenjtë strehimin e thesarit të saj jo më larg se pesëdhjet metra nga vendndodhja e kishës. Për këtë përpiloheshin pastaj dhe harta të sakta, të cilat dërgoheshin në selinë e shenjtë në Vatikan. Me dyndjen e hordhive turke në vendin tonë edhe objektet e kultit në Shumbat u bënë pre e këtyre vandalizmave të pa para ndonjëherë. Nga këto barbarizma nuk shpëtoi dot as kisha e Shën Mateut, një ndër kishat më të bukura dhe më të mëdha në fshat. Në vitin 1993, në vendin e quajtur Can Kade, dy metra poshtë rugës këmbësore që bie poshtë në Manjanze e ngjitesh pastaj për në Lubqërz u zbulua një thesar. . . Ishin pikërisht vitet kur mjaft njerëz me aparate metalkërkues bridhnin kudo nëpër Dibër. Një mëngjes fshati u zgjua i habitur, kur pa pikërisht në këtë vend një gropë të hapur natën me përmasa 1X2X2 metra. Në fundin e kësaj grope dukej dhe një gropë tjetër me përmasa 1X 50 centimetra, ndërsa në fundin e saj dukej qartë forma e diçkaje që ishte rrëmbyer. Nuk bëhej fjalë për ndonjë qyp por përmasat e gropës tregonin për ndonjë arkë metalike. Pikërisht hamendësojmë se rrëmbimi i këtij thesari i përket kishës së Shën Mateut e cila ia kishte lënë tokës amanet. -2). Përveç kësaj kishe në Shumbat kanë qenë edhe katër kisha të tjera si ma poshtë: Kisha në Zhuparra, kisha në lagjen Smaç, kisha në Fushë të Shirës si dhe kisha tek kroi i kumonës apo siç quhet ndryshe lemja e diellit. Sipas burimeve më të fundit të studiuesit Iljaz Kaca edhe në Salbatra ka qenë një kishë më e madhe se pesë të tjerat. Pikërisht për këtë kishë populli ka mjaft gojëdhëna ku njëra ndër to është ajo që thonë se në afërsi të kësaj kishe ka qenë dhe një tunel i nëndheshëm. Për këtë kishë thuhej se ka patur një pasuri përrallore. Dera e kësaj kishe thonë ishte aq e madhe sa kur mbyllej dëgjohej zhurma e saj deri në Shehër të Dibrës së madhe-3)

Që të arrijmë në konkluzion se Shumbati është vend prehistorik na vijnë në ndihmë jo vetëm gjetja e sopatës së gurit, por dhe gjetje monedhash e një kandili të periudhës së Justianit që përkon me vitet 527-565 të cilat dëshmojnë për një zhvillim ekonomik gjatë shekullit VI-4)

Lashtësia e fshatit matet dhe me varrezat e tij ku pothuaj të gjitha varrezat e fshatit kanë një moshë relativisht të madhe. Kështu mund të përmendim varrezat e kishës në Jakovinë, varrezat e Butme në Hurdhë, varrezat e kishës tek shtëpia e Arif Shirës, varrezat e Gjovaçit. Udha e Madhe nuk kalonte nëpër Shumbat por kalonte fare pranë tij. Rruga kryesore dhe mjaft e vjetër që kalonte mes përmes fshatit ka qenë rruga e Gramës, e gjatë 52 km. Kjo rrugë ndiqte grykën e Gramës dher nëpërmjet Shkallës së Sllatinës dhe Shkallës së Rrahmane ngjitej në Beck të Gramës dhe pikën më të lartë e arrinte në Lakun e Xhipve, 2352 metra mbi nivelin e detit. Pastaj varej poshtë në fshatrat e Rekës për tu lidhur me Pollogun e më tej. Rruga e Grykës së Gramës është një ndër rrugët më të vjetra të gjithë krahinës. Kjo rrugë lidhte fshatin Dypjakë me kalanë e tij që ndodhej në hyrje të Gramës. Për herë të parë për rrugën e Gramës flet Jastrebovi në fund të shekullit XIX. Ai nuk jep hollësi, por jep drejtimin e rrugës, tregon shpatet jugore të malit të Gramës-Dardhë-Lurë-5.)

Plaku Demir Skarra tregonte:" Nëpër këtë rrugë shkohej në Shkup, Manastir, Selanik e deri në Turqi" Dhe vërtet ruga nëpër të cilën kaloi konsulli rus përputhet plotësisht me intinerarin që jep plaku Demir Skarra i cili tregon se shumbatasit për të shkuar në Manastir dhe Selanik kalonin rugën e vjetër Shumbat-Gramë. Kjo rugë në drejtim të perëndimit të nxjerr edhe në Dardhë dhe

Poshtë nën këmbët e Korabit legjendar e deri në brigjet e Drinit të Zi, nga Përroi i rrëmbyer i Kapçit e deri në përruan e Madh shtrihet një fushë e gjërë e mjaft pjellore e cila në gjeografinë e Shqipërisë njihet si fusha e Shumbatit. Për nga madhësia kjo fushë është e dyta në Dibër pas asaj të Kastriotit. Jo më kot në vitet e regjimit totalitar, e quanin Fushën e Shumbatit hambar për gjashtë fshatrat e ish kooperativës bujqësore Sllatinë, ose "Myzeqeja" e Dibrës. Sot e gjitha kjo fushë mjaft e madhe dhe pjellore, të vetmin burim për vaditje ka rezervuarin e fshatit, i cili nuk i plotëson nevojat e saj. Për vaditjen e tokës shumbatasit herët kanë blerë me flori Gurrën e Dypjakës, e cila vadiste një pjesë të fushës së madhe të Shumbatit.


©Foto: Bujar Karoshi

Lurë siç e thotë dhe Jastrebovi, pra Dypjakë-Shumbat-Topuze-Lugje dhe pastaj me va ose me urë kalonte Drinin e dilte në Zalldardhë-Lashkizë-Tajan-Lanë-Lurë-Fushë-Lurë dhe më tej. 6)

Në fakt pikënisja e kësaj rruge ka qenë Dypjaka e pikërisht tek kalaja e saj. Shenja të rrugës së Gramës janë gjetur në Shkallën e Rrahmane, Vendi i keq si dhe pjesë kalldrëmi janë gjetur dhe në Fushë të Korabit-7)

Edhe pse Shumbati është nën udhë me shumicën e fshatrave të Ujë e M'ujës, prania e rrugës së madhe në afërsi të fshatit si dhe rruga e Gramës, një ndër rrugët më të vjetra që kalonte mes përmes fshatit, tregon më së miri se Shumbati përveçse një vendbanim prehistorik është edhe një fshat me kulturë të hershme. Dëshmitë arkivore, historike dhe gojore nuk mungojnë. Të gjithë studiuesit e huaj apo vendas, albanolog apo historianë në Fushën e Shumbatit janë ndalur, kanë hulumtuar dhe shkruar. Megjithatë përsëri Shumbati në këtë drejtim mbrtet një treve e virgjër. Toponime në Shumbat ka shumë por askush nuk është marrë me to, thjeshtë kanë mbetur ashtu siç na kanë ardhur deri në ditët tona në bazë të gojëdhënave por që shumica kanë bazë historike por disa prej tyre tek ne kanë ardhur në formën e legjendave. Shumbati edhe vite më vonë, pra në perudhën e pushtim turk rezulton të jetë fshat i madh, fshat me shumë shtëpi . Dy defterët osman, ai vitit 1467 dhe ai vitit 1583 na jep një popullsi relativisht të madhe në krahasim me fshatrat e tjera të Dibrës. Kështu vetëm Shumbati në vitin 1467 ishte 26 shtëpi. Fusha e Shumbatit(Shimbar-Pole me 3 shtëpi . Në defterin e vitit 1583, në një periudhë kohe mbi njëqind vitesh rezulton:Shumbati 38 shtëpi. Fusha e Shumbatit (Shëmbar-Pole) mbetet mera, e pa banuar nga askush. -8). Në këto dy defterë që ndodhen tashmë të përkthyer sot nuk është asnjë fis. Pra popullsia e sotme e fshatit është më e vonë. Vetëm fisi Shumbati që në ato vite ishte mjaft i hapur në Dibër si në Shumbat, Kallë, Luzni, Sinë e gjetkë, sot kemi shumë familje me këtë mbiemër në Shkup. Ajo që ia vlen të ndalemi më gjatë është se si fshat Shumbati është një ndër fshatrat kryesor në të gjithë Dibrën si fsdhat arsimdashës, por kthesa ma e madhe në këtë fushë ka ndodhur në vitet 1945. 1954. Shkolla e parë shqipe në fshat u hap në vitin 1945 tek shtëpia e met Shabanit ku të gjithë arsimtarët do të flinin në shtëpitë e fshatarëve. Shumbati edhe ato pak shtëpi që kishte në ato vite jo vetëm për arsimtarët por i vu edhe në funksion të pushtetit lokal. Në vitin 1946 Shumbati do të bëhej nënprefekturë, ku nënprefekt do të vinte Xhetan Ndreu, sekretar Shaban Maqellara, shef administrate Shemsi Plaku, shef policie Sami Buci nga Skrapari, komandant vendi Beshir Sufa, përgjegjës rinie Fiqiri Alia nga Shkodra, përgjegjëse e gruas Ollga Tollga nga Korça, sekretar partie Hysen Mata, guzhinier Malok Palamani, korier Lutfi Sulejmani. Ardhja e Nënprefekturës në Shumbat solli dhe të mirat e saj. Kështu me një vendim të posaçëm filloi ndërtimi i rugës Kastriot-Shumbat. Natyrisht që rruga kërkonte mjaft punë e sakrifica sepse punohej me mjete primitive por së fundi në kohë rekord u arrit që rruga të përfundonte. Në vitin 1953 Shumbati do të bëhej rreth me kryetar Rexhep Balliu dhe sekretar Haziz Ndreu. Kryetar i degës së punëve të brendëshme Ali Bega(Shtino), nënkryetar Metush Qamili(Braho), shef policie Dervish Sanxhaku, shef arsimi Ahmet Laçi, me rininë Baftjar Kamberi, me tregtinë Bajram Doçi, komandant policie Emin Bekteshi i cili më vonë u vra dhe në vend të tij erdhi Osman Doda-9). Ishte pikërisht kjo periudhë kohe kur vendit i vinte era barot, kishte filluar ndërtimi dhe rindërtimi i vendit plotësisht e djem e vajza nga Shumbati edhe në moshë madhore drejtoheshin tek e vetmja shkollë që ishte tek shtëpia e Met Shabanit. Është në fakt merita e të ndjerit Ivzi Shehu nga Vlesha i cili jo që e filloi i pari në këtë shkollë por falë përgaditjes së tij profesionale nxënësit e parë të shkollës së Shumbatit, vite më vonë të gjithë do të bëheshin kuadro jo vetëm për fshatin por dhe në sektor të ndryshëm të ekonomisë shqiptare. Në vitin 1961 hapet shkolla shtatë vjeçare ku drejtor i parë ka qenë Ahmet Çushi, mësues Murat Koltraka e Naim Plaku-10). Vite më vonë nga Shumbati do të dilnin universitarët e parë si Hasan Leka e Shuaip Skarra ku Hasani bëhet për mjaft vite dhe drejtor i kësaj shkolle. Edhe pse në Shumbat shkolla shqipe u hap shumë vite me vonesë duke e krahasuar me fshatra të tjerë të Ujë e m'Ujës si Trojaku, Palamani, Vlesha, Sllova, themi me bindje se Shumbati ka bërë një revolucion në këtë drejtim. Sot janë me qindra e qindra djem të Shumbatit të arsimuar brenda e jashtë vendit dhe ku drejtojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë tonë. Ia vlen të përmendim të ndjerin Hasan Leka, kandidat i shkencave i cili ka një vit që nuk është më midis nesh. Hasini ishte modeli i intelektualit shqiptar që kudo ku punoi e në sektor mjaft specifik ngriti lart jo vetëm vlerat e tij, të familjes por dhe të vetë fshatit Shumbat ku ishte lindur, rritur dhe punuar po në Shumbat për disa vite në arsim. Prof. Dr. Selami Xhepa, edhe ky bir i Shumbatit, sot deputet në Kuvendin Popullor. Neshat Fana, jurist, aktualisht antar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Dr. Hajri Mandrri, Tofik Sulejmani, Sali Shira e shumë e shumë emra të tjerë. Ajo që padyshim ia rrit vlerat më shumë këtij fshati përballë fshatrave të tjerë të Dibrës është uniteti që kanë patur fiset vite me radhë dhe Itifaku i fshatit. Jo që nuk i bindeshin kanunit të Dibrës, ai në ato vite ishte rregullatori i vetëm, ishte kushtetuta e Dibrës, por Shumbati brenda për brenda kishte dhe një tjetër kanun të tij të pa shkruar, kishte Itifakun i cili rregullonte organizimin brenda për brenda fshatit. . Itifaku i fshatit ishte besa e dhënë mes fiseve dhe pikërisht këtij itifaku i bindeshin të gjithë. Itifaku i Shumbatit ishte një kanun më vete brenda për brenda fshatit, ishte kjo një kontratë gojore që fiset kishin bërë njëri me tjetrin. Itifaku ishte regullator i gjithçkaje brenda për brenda fshatit dhe dënimet e saksionet që jepte Itifaku, nuk i pqërmbante kanuni. Edhe të huajt, edhe udhëtarë të rastit ishin të detyruar kur kalonin në teritorin e Shumbatit të zbatonin pikë për pikë Itifakun. Mes shumë pikave që përmbante ky itifak tre ishin më kryesoret:

1-Mos të bëhet pushkë në fshat
2-Mos të vritej hasmi në fshat
3-Kushdo që kalon mes përmes fshatit, qofte edhe nga Shumbati nëse është i armatosur, pushkën duhet ta mbaj me grykë poshtë. Falë këtij itifaku në Shumbat nuk kishte vjedhje, grindje e shamatë mes njëri tjetrit. Në vitin 1967, kur zhvillohej lufta kundër fesë, në Shumbat si kudo u prishën dhe objektet e kultit dhe u kthyen në magazina për kooperativën bujqësore. Kjo ishte një llavë që nuk mund të shpëtonte as Shumbati. Në fakt ndryshe nga fshatrat e tjerë Shumbati nuk u privua nga e drejta themeltare e besimit. Ritet fetare për të ishin të shenjta dhe zbatoheshin me rigorozitet nga të gjithë pa përjashtim. Një fakt ndoshta më i rralli, në të gjithë zonën dhe më gjërë, të vdekurit i bëheshin të gjitha ritet. Edhe pse në ilegalisht shumbatasit i përcillnin të vdekurit për në banesën e fundit sipas zakoneve qindra vjeçare. Jo vetëm kaq, por përballë unitetit të fshatit, edhe lufta e klasave ishte tepër amorfe në fshat, thua se nuk ekzistonte fare. Shembulli më i mirë për të është se nga fshati nuk u dënua askush nga neni famëkeq agjitacion e propogandë. Në tre shtylla kryesore bazoheshin shumbatasit: Në besë, bujari e trimëri. Besën shumbatasit dinin kujt ia jepnin, por mendoheshin gjatë para se ta jepnin. Për bujarinë e fshatit tregon më së miri fakti se dhe pse fshat anës udhës së pazarit, ku lëviznin udhëtarë të ndryshëm më së shumti nga zona e Lumës, nuk ka patur hane kjo rrugë. Por ma mirë për Shumbatin dhe shumbatasit ka shkruar Xhelal Ndreu: "Thonë se s'ka pasë trim si Cen Dika. Por për trimni s'ka masë e kandar, djemt e Shumbatit janë e kanë qenë që të gjithë trima të përvuejtë, nuk lëshonin ku të zatekshin, vinë nji për nji me ma trimat në Dibër, mende damë, të pa tufa, t'u ndodhshin afër kur të jetë rreziku ma i madh. Aq e vërtetë asht , kjo sa që në dyqind shtëpi Shumbat, sun e gjejsh nji djalë a burrë, që të thuesh se ky s'ban. Të urtë e hjekakëqinj, fodulla pushke e jo grashë, besnik e të dashtun hatërlinj, dallohen jo vetëm n'Ujë e n'Ujë por në të gjithë Dibrën"-11)

Xhelal Ndreu: "Thonë se s'ka pasë trim si Cen Dika. Por për trimni s'ka masë e kandar, djemt e Shumbatit janë e kanë qenë që të gjithë trima të përvuejtë, nuk lëshonin ku të zatekshin, vinë nji për nji me ma trimat në Dibër, mende damë, të pa tufa, t'u ndodhshin afër kur të jetë rreziku ma i madh. Aq e vërtetë asht , kjo sa që në dyqind shtëpi Shumbat, sun e gjejsh nji djalë a burrë, që të thuesh se ky s'ban. Të urtë e hjekakëqinj, fodulla pushke e jo grashë, besnik e të dashtun hatërlinj, dallohen jo vetëm n'Ujë e n'Ujë por në të gjithë Dibrën"


©Foto: Bujar Karoshi

Referenca

1-Hysen Çera "Ujë e m'uja faqe 32
2-Hysen Çera "Ujë e m'Uja faqe 32
3-Iljaz Kaca: Rrugët e vjetra të Dibrës faqe 55
4-Iljaz Kaca: Rrugët e vjetra të Dibrës faqe 41
5-Jastrebov Stara albania faqe 226
6-Iljaz Kaca Rrugët e vjetra të Dibrës faqe 266-267
7-Iljaz kaca Rrugët e vjetra të Dibrës faqe 268
8-Haki Përnezha, Zyber Gjoni "Dibra në defterët osmanë) faqe 44-46
9- Shaqir Skarra "Shumbati, histori dhe tradita" faqe 128
10- Shaqir Skarra "Shumbati , histori dhe tradita" faqe 129
11-Xhelal Ndreu "S'ka qetsi në Lisivalle" faqe 55

Rruga e Arbërit nr. 81

shënime



© Foto: Abdurahim Ashiku (Arkiv)

KUÇLA-ZDOJAN

Rrafshina e Dibrës-RASHNAPOJA

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Meditimin për Rashnapojën ma ngacmoi një vajzë e re, një bijë e Salkurteve, Ana. Ajo më shkruan:

Përshëndetje z. Abdurahim. Uroj të jeni mirë dhe me falni që po ju shqetësoj. Po ju drejtohem pasi dikush më orientoi tek ju si një person që mund të më ndihmoni në lidhje me diçka. Jam një studente dhe po bëj një studim për fshatin Rashnapojë, por puna është se s'kam gjetur të dhëna as në komunë dhe as në qark. Doja t'ju pyesja nëse keni ndonjë informacion rreth këtij fshati, çfarëdolloj qoftë, do t'ua dija shumë për nder nëse ma tregoni. Duke iu uruar gjithë të mirat, Ana Salkurti.

Përgjigja ime ishte:

Përshëndetje Ana dhe faleminderit për respektin. Unë jam larg, jam në Athinë dhe letrat e shënimet e mia kanë mbetur në Shqipëri. Megjithatë kujtimet i kam me vete edhe pse paksa më janë zbehur nga mosha. Do të mundohem të gjej ndonjë të dhënë apo të të orientoj ku të kërkosh...

Po i përcjell kujtimet e mija për Ana Salkurtin, studenten që kërkon rrënjët e fshatit të vet, rrënjët e të parëve të saj. Po i përcjell publikisht me dëshirën që brezi i ri që ka ardhur në jetë, një brez i shkolluar dhe i kulturuar të shkruajë për vendlindjen, të kërkojë në arkivat e shkruara por mbi të gjitha në "Arkivin e gjallë" tek gjyshërit dhe gjyshet, te baballarët dhe nënat, t'i shkruajë fjalët e tyre, jetën dhe përjetimet e tyre, të regjistrojë në magnetofon kujtimet e tyre, ti fotografojë dhe filmojë, t'i fusë në kujtesën kompjuterike, t'i botojë në gazeta e në libra.

Kam me vete shumë libra me histori e kujtime për Dibrën dhe dibranët. Kam "Isuf Karasanin" e Ilias Kacës, "Thatina e Dibrës" të Qeram Cibakut, "Origjina Dibrane e Skënderbeut" të Besnik Këbejt, "Golloborda" të Velo Cfarkut, "Gollobordasit e Dibrës" të Hilmi Sadikut, kam "Kanunin e Dibrës" dhe disa libra të Xhaferr Martinit, kam "Dibra në prag të historisë" (Dorëshkrim) të Haki Stërmillit, kam (së fundi) librin e Kristo Frashërit "Historia e Dibrës", një libër që duhet të bëhet disiplinë studimi duke dhënë edhe provim, në Universitetin e Dibrës... Kam një raft si një "ograde" historike e letrare e Dibrës, "ograde" që më ngjall kujtime, që e "punoj" në krijimtarinë time publicistike... larg jAna Salkurtin që më mbushi mbrëmjet e ftohta të emigrimit me kujtime të bukura për Rashnapojën dhe njerëzit e saj, sido e sado që shumë gjera tashmë janë në kufij të harresës në rrethin e kujtimeve të mija...

* * *

Rashnapoja është katundi, rrugët dhe rrugicat e të cilit i kam shkelur më shumë se sa rrugët dhe rrugicat e vendlindjes time, Brezhdan-Zdojanit. Kjo jo vetëm për dy vjetët e rrugëtimit tim të përditshëm, viteve 1952-1954 si nxënës në shkollën shtatëvjeçare Peshkopi, por edhe në vitet e mëvonshme dhe veçanërisht vitet 1960-1961 kur si agronom i lokalitetit të Qendrës hyra jo vetëm rrugëve dhe rrugicave dhe ngastrave të mbjella me bimë të arave por edhe odave mikpritëse të rashnapojasve. Rashnapoja hyri dhe mbeti në jetën time, në kujtimet e mija, po me atë bukuri e shpirt njerëzor sa katundi im i lindjes, sa mëhalla ime në krye të katundit e shtëpia ime në fund të mëhallës së Ashikëve.

Kjo për vetë pozicionin gjeografik që zë Rashnapoja në udhëkalimin e gjerë që lidh Peshkopinë, luginën e Drinit të Zi me Muhurrin e Malet e Dibrës. Ndonëse ky arter i madh rrugor u anashkalua nga udhët e kalldrëmta automobilistike, ai mbeti kryesori në rrugën e pazarit të Peshkopisë, i vetmi në tërë Dibrën e Poshtme.

Rashnapojën e kam përshkuar, verës dhe dimrit, në dy rrugëkalime. Verës rrugës kryesore, e gjerë sa mund të kalonin dy pendë qe dhe dimrit në atë që e quanim"Rruga mbas Rashnapoje", një rrugë këmbësore, vende-vende me shkallasija, (gardh i thurur me thupra me dy shkallëza druri në të dy krahët).

Rruga këmbësore degëzohej tek "Shenjat e Rashnapojes", linte majtas shtrazën e mullirit të vjetër, shtëpitë e katundit, përshkonte mes për mesi tokat e bukës, Kuçlat e Sopoteve dhe Ashikëve dhe bashkohej me rrugën kryesore poshtë varreve të Kecit, varrezë e përbashkët e lagjeve Ashike, Sopote dhe e Zdojanit. Ishte një anashkalim i detyrueshëm këmbësorësh për shkak të asaj që në fjalorin dibran ka hyrë me nofkën "Baltat e Rashnapojës", të pakalueshme veçanërisht tek mulliri i katundit. Aq të lodhshme ishin për kalimtarët "Baltat e Rashnapojës" sa thonë se në Stamboll jetonte në gojën dhe kujtesën e mërgimtarëve pyetja "A janë tharë Baltat e Rashnapojës"?

Rashnapoja në kujtesën time ka qenë katundi më i mbledhur, një grusht shtëpish bashkë njëra me tjetrën e njëra pranë tjetrës. Ajo kufizohej midis "dy mullinjve", njeri, ai në perëndim, ishte "mulli i gjallë" që nuk pushonte së bluari drithë verë e dimër, ditën dhe natën. Tjetri, ai në lindje, ishte "mulli i vdekur". Mbaj mend shtrazën e tij që niste që nga "Shenjat", plepat në degradim dhe gurët e blojës zhytur pingul mbi tokë. Mbaj mend edhe shembjen e shtrazës së mullirit dhe tabanin e tij të shndërruar në rrugë në një kthesë të butë.

Rashnapoja lidhej me dy rrugë të tjera, njëra prej të cilave zbriste në përroin e Zdojanit për tu ngjitur në Pilafe kurse tjetra zbriste në përroin e Ushtelencës për tu ngjitur në Pollozhan e për të vijuar në Dohoshisht e më tej...

Tokat e Rashnapojës shtriheshin mbi një rrafshulët nga të dy anët e përroit të Zdojanit nga ana veriore dhe përroit të Ushtelencës nga ana jugore, përrenj që lidheshin me tokat e Pilafe nga njëra anë e Pollozhanit nga ana tjetër. Në lindje tokat e Rashnapojës i ndante rruga automobilistike nga tokat e Tominit kurse në perëndim ndaheshin me tokat e Sopoteve pak para kodrës së Kuçlave.

Pjesën perëndimore po e shoqëroj me një foto të vitit 1957 ku katër pendarë të kooperativës bujqësore Zdojan me në krye bujkun e dalluar Can Demiri plugojnë tokat e katundit pikërisht në kufi me tokat e Rashnapojës. Një foto tjetër po e kësaj periudhe tregon plugimin e tokave të Pollozhanit nën kujdesin e bujkut të rendimenteve të larta për kohën, Ymer Doda.

Pjerrësia nga ana e përroit të Ushtelencës, shullani, për shkak të ngrohtësisë nga rrezet e diellit mbulohej nga vreshtat, ku më të gjerat kanë qenë "Vreshtat e Argaçit" që shtriheshin nga degëzimi i rrugës që zbriste për në Gropën e Brezhdanit deri në shullanin e Sopoteve, edhe ai i mbushur me vreshta.

Pjerrësia nga ana e përroit të Zdojanit, tokë usur, e ftohtë për shkak të pozicionit verior ishte djerr ose me ndonjë zabel të vogël gështenjash.

Tokat në të dy krahët e Rrugës së Madhe, rrugë që i ndan thuajse simetrikisht, zbrisnin shkallë - shkallë drejt perëndimit, në brezare shekullore, fryt i një kulture pune të bujkut rashnapojas.

Në Dibër nuk njoh ndonjë katund me toka kaq të rrafshëta, toka që i rrethojnë shtëpitë siç rrethon e bardha e vezës të verdhën e saj gatuar e vënë në pjatë, ndaj u quajt edhe "Rrafshina e Dibrës"

Ujitja e tokave bëhej me "Vijën e Malit" siç quhej vija që e merrte ujin nga burimet mbi Llixha. Rashnapoja kishte pjesërisht të drejtën e një brazhde uji, përdorimit të saj vetëm disa ditë të muajit. Ditët tjera brazhda kalonte për ujitjen e tokave e Zdojanit e Brezhdanit. Gjatë gjithë vitit mbi këtë vijë bluhej drithë në mullirin e Çengës në Tomin, në mullirin e Rashnapojës si dhe në pesë mullinj të fshtrave Brezhdan-Zdojan (Mullirin e Dik Ashikut, të Hilmi Karasanit, Rexhep Kolës -dy mullinj- dhe të Maliq Hakores). Me ujin e kësaj vije në vjeshtë të vitit 1955 u ndërtua hidrocentrali i Brezhdan-Zdojanit që u jepte dritë më se 300 shtëpive.

Në tokat e Rashnapojës kultivohej misër, fasule në përzierje me misrin, grurë, perime, elb, tërshërë, urof, thekër, këta të fundit në sipërfaqe të vogla. Vreshtat në shullanin e tokave me ekspozim jugor dhe gështenjat, mollët, arrat, dardhët, kumbullat, qershitë etj, mes shtëpive dhe në usurin me ekspozim verior, gjenin kushte të përshtatshme për kultivim. Rashnapojasit ishin bujq shumë të kujdesshëm dhe rendimentet e tyre



Ymer Doda - Pollozhan

shquanin midis më të mirëve të Dibrës.

Rashnapoja nuk ka pas asnjë burim uji të pijshëm në qoftë se përjashtojmë këtu një burim "me shtupë" që mblidhte në një rezervuar të vogël shumë pak ujë. Për ujë të pijshëm gratë rashnapojase detyroheshin të shkojnë në Pilafe, Tomin apo Peshkopi.

Rashnapojasit për të respektuar ritet e myslimanizmit shkonin në xhaminë e Tominit ose në atë të Peshkopisë. Katundi nuk kishte xhami të vetën. Rashnapoja, pak para se të shkosh tek "Shenjat", në krah të mullirit të vjetër, ka pas një "Varr të Mirë", shumë i respektuar dhe i nderuar nga vendasit dhe nga udhëtarët e shumtë drejt Peshkopisë. Njëkohësisht një "Varr të Mirë" ka pas edhe në rrugën që kalonte bri varrezave të fshatit dhe të çonte në Pilafe.

Rashnapoja nuk ka pas shkollë të sajën. Fëmijët shkonin në shkollë në Peshkopi dhe në Tomin. Interesimi për shkollimin 7-vjeçar i prindërve dhe i fëmijëve të Rashnapojës, ka qenë i paktë. Në kohën kur unë vazhdoja shkollën 7-vjeçare (1952-1954) nuk mbaj mend që të ketë pas ndonjë djalë apo vajzë që e ndiqte atë.

Rashnapoja ka pas dy pika pushimi të udhëtarëve në drejtim të Peshkopisë.

I pari ishte tek "Shenjat". Dy shenja me moshë gati shekullore, me rrënjë në vijën e ujit dhe një jeshillëk çlodhës, ishin një vend i këndshëm për pushim, një vend ku udhëtari në vapë gjente freski, madje duke futur edhe këmbët në ujin gurgullues.

I dyti ishte tek "Vorret e Deli Hasanit", ku udhëtarët preheshin në hijen e një plepi shekullor që i kishte hapur krahët mbi dynymë toke, nën gurgullimën e ujit. Plepi, me sa mbaj mend, u pre në "zinë e të ftohtit", në dimrin e egër të vitit 1954, kur rezervat drunore për banorët ishin në mbarim dhe të ftohtit solli edhe viktima. Nën plepin legjendë të Varreve të Deli Hasanit, janë zhvilluar kuvende historike dhe takime me rëndësi lokale e kombëtare të parisë së Dibrës. Fatkeqësisht ajo hapësirë e bukur, e të gjithëve, sot është mbushur me shtëpi banimi, shtëpi mbi varre.

Rashnapoja, sipas të dhënave demografike të vitit 1979 ka pas 48 familje me 329 frymë prej të cilëve 157 femra. Nga këta në moshë pune kanë qenë 157 vetë kurse kanë punuar 145 vetë. Sipas të dhënave të vitit 1989 Rashnapoja ka pas 85 familje me 414 banorë prej të cilëve 200 meshkuj dhe 214 femra. (Flamur Cena- vjetar statistikor- dorëshkrim)

Për të dhëna më të hershme për popullsinë e Rashnapojës dhe lëvizjet e saj duhet të shfrytëzohet arkivi i shtetit-dega Peshkopi si dhe arkivi i gjendjes civile me të dhëna para vitit 1938 dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Rashnapoja me ligjin e datës 5 maj 1938 shpallur në Fletoren Zyrtare Nr. 34, datë 11 maj 1937 dhe vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 753, datë 6.7.1938 botuar në Fletoren Zyrtare Nr.64, datë 26 gusht 1938, faqe 8-9 riemërtohet me emrin Rrafshinë-a (Qeram Cibaku, "Thatina e Dibrës dhe shpirtra në qiell" faqe 78)

Rashnapojën në histori do ta gjesh në "Historia e Dibrës" të Kristo Frashërit. Personalisht Rashnapojën e kam hasur në gazetën "Përlindja e Shqipënies" ku "Nga një raport zyrtar" janë përshkruar "Barbarizmat e mizorinat e serbëve kundër shqiptarëve" ku theksohet se "Gazeta Korierere delle Puglie botoi këto ditë, gjer e gjatë, mizorinat e barbarizmat të vepruara nga ushtria sërbe në Dibrën e Sipërme e në Dibrën e Poshtme dhe në Lumë..." (Përlindja e Shqipëniës Nr.35, 25/7 dhjetor 1913, e mërkurë f. 4-5). Barbarizmat serbe në Dibër janë shkruar edhe në "Kalendari kombiarë 1914" dhe në "Dibra në prag të historisë" – libër në dorëshkrim i Haki Stërmillit si dhe në disa libra të autorëve dibranë. Unë po citoj vetëm botimin më të fundit, atë të Kristo Frashërit "Historia e Dibrës".

"Në Rashnapojë – Nuk mundën t'i digjnin tërë shtëpitë e fshatit, por i plaçkitën. U vranë me bajonetë 6 krerë të fshatit: Bajram Mehmeti, Maliq Rakipi, Behxhet Beluli, Osman Azemi dhe Hajredin Maliqi. U morën me vete 20 qe."

Në Rashnapojë kam njohur dhe u kam ngrënë bukën e dashurisë shumë familjeve por midis tyre dua të veçoj familjen e Vehbi Salkurtit, një burrë që të krijonte respekt me pamjen dhe bisedën e tij dhe Xhaferr Cerjanit, një prej specialistëve më të vjetër të bujqësisë dibrane që për shumë vite ka punuar në laboratorin e analizave të farërave pranë Komitetit Ekzekutiv të Peshkopisë.

Në bllokun e shënimeve të mia nuk e gjeta Rashnapojën në ditën e krijimit të kooperativës bujqësore. Shënimet e mia janë një konspekt i shkurtuar i studimit që asokohe ka pas bërë Basri Muskurti, studim i cili duhet të jetë në arkivin e rrethit të Dibrës, ashtu si duhet të jenë edhe të dhënat demografike të gjendjes dhe lëvizjes së banorëve të Rashnapojës në regjistrin e gjendjes civile si të kohës së mbretërisë po ashtu edhe të viteve të mëvonshme, deri në migrimet brenda vendit dhe emigrimet jashtë vendit në vitet '90-të, studimi i të cilave i jep vlera Rashnapojës në rrugën e zhvillimit të saj në kohë dhe hapësirë.

Të studiosh të kaluarën dhe të sotmen e katundit tënd siç po bën Ana Salkurti është një detyrim intelektual dhe kulturë.

Athinë, 20 janar 2013

vendlindja



© Foto nga FB: *4 Grykët Selishtë, Qafmurrë, Lukan, Kacni*

Katër Grykët

Ky vend ku natyra ka krijuar resurse e bukuri te mëdha të cilat presin dorën e njeriut për ti shfrytëzuar në dobi të tij.
Dhe kjo do të mundësohet vetëm me lidhjen e rrugës Klos - Katër Grykët, si degëzim i rrugës së Arbërit.

Nga **QAZIM PREJSI**

Në veriperëndim të trevës së Dibrës, që përshkohet nga rruga automobilistike Dibër-Mat, 28 Km nga qyteti i Peshkopisë dhe 37 Km nga ai i Burrelit (Lunara mesi i zonës) si dhe 133 Km nga qyteti i Tiranës, janë vendosur me banim banorët e Katër fshatrave: Selishte, Qafmurrë, Lukani e Kacni , të ngulmuar në katër grykë nga ku kjo zonë njihet tradicionalisht e emërtuar "Katër Grykët" me qendër administrative "Komuna Selishtë", në fshatin Selishtë.

Ajo kufizohet nga lindja me fshatrat Muhur, Luzni e Gjuras, në jug me zonën e Bulqizës, në veri me ato të Lurës dhe në perëndim me fshatrat Vinjoll e Kurdari te trevës së Matit.

Kjo zonë është kryesisht vend malor me dimër të dalë e të ftohtë , ku trashësia e dëborës në disa vite i kalon 1,5 m. Lartësia mbi nivelin e detit në vendet e banuara varion nga 700 deri 1550 m, ndërsa majat e maleve më të lartë janë ato të Balgjajt, të Kacnisë me 2100 m dhe te Runjës së Lukanit me 2048 m.

Banorët e kësaj zone tradicionalisht të ardhurat ekonomike i kanë siguruar me bujqësi e blegtori.

Në fillim të viteve '90 këtu banonin rreth 5400 fryme, përkatësisht në një sipërfaqe tokësore 14500 ha, nga kjo mbi 1 1000 ha pyje e kullota, 1464 ha toke e punueshme etj .

Ashtu si dhe ne zonat e tjera te vendit, sidomos në ato malore, me ndryshimin e sistemit politik shumë banorë të saj u shpërngulën nga ky vend për t'u vendosur me banim në zona të tjera të ulta, kryesisht në Tiranë e Durrës.

Në ditët e sotme në këtë zonë kanë mbetur rreth gjysma e banorëve në fillim viteve '90.

Krahas faktorëve ekonomik, në largimin e banorëve nga kjo zonë ndikuan dhe faktorë të tjerë social shoqërore, si te qënurit larg qëndrave të mëdha urbane, mungesa e standardeve në infrastrukturën rrugore, rënia e shërbimeve shëndetësore dhe ndërlidhjes, mbyllja e shkollës së mesme etj.

Në fillim u largua krahu i aftë për punë, duke emigruar në Greqi, Itali, Angli Gjermani, Amerikë etj., ku nëpërmjet të ardhurave të dërguara pranë familjeve të tyre bënë të mundur shpërnguljen e banorëve të zonës në vendet e ulta të vendit, duke ngritur banesa të kohës dhe duke u internuar me banorët vendas ku u vendosën.

Ndër këto të shpërngulur, pati dhe individë të aftë të kësaj zone që bënë emër, që me kurajë dhe përkushtim krijuan biznese të fuqishme, sidomos në sektorin e ndërtimit, si Rustem BIBA, Faik BRUCI, Ramazan BIBA, Latif MIHA, Xhetan NDREGJONI, Bashkim NDREGJONI, Sule LALA etj. të cilët dhe kanë punësuar dhjetëra familjare të kësaj zone në bizneset e tyre.

Por megjith faktorët që përmendëm më lart, të cilët dhe i detyruan banorët e kësaj zone për t'u larguar e vendosur me banim në vendet e tjera, në kërkim të një jetese më të mirë, në një bisedë të bërë para disa ditësh me Kryetarin e Komunës së kësaj zone Z. Xhemal DELISHI (nga ku mori nxitje dhe ky shkrim) ky i fundit theksoi se edhe në se nga kjo zonë janë larguar mbi gjysma e banorëve të komunës, këtu kanë lënë mjaft resurse, që me shfrytëzimin e tyre, do të nxirrnin të ardhura të mëdha ekonomike.

Ndër këto resurse Kryetari do të përmendte, përveç sektorit të blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë etj. dhe të shfrytëzimit të resurseve të masivit malor, i cili i kalon të 1 1000 ha, masiv ndër të rrallët e masiveve të vendit tonë.

Në këtë masiv malor ka rezerva ujërash të bollshme e të pashtershëm, që rrjedhin nga lartësitë e tij, duke krijuar mundësinë e instalimit të HC lokal, krijimit të rezervateve të rritjes së peshkut (troftës), krijimit të impianteve të mbushjes së ujit të pijshëm, prodhimit të pijeve freskuese etj.

Ka rezerva bimësh të shumëllojshme eterovajore dhe medicinale, si për nevojat e tregut të brendshëm dhe për eksport.

Ky masiv krijon dhe mundësi të mëdha për turizmin klimaterik veror dhe atë sportive dimëror.

Në këtë masiv duhen përmendur rezervat e mëdha e të pa shfrytëzuara të mineralit të kromit. Me rivënien në shfrytëzim të këtyre rezervave, referuar një grupi studiuesish të fushës së gjeologjisë, të botuar në gazetën "Rruga e Arbërit", Maj 2008, me autor Prof.Dr. Bashkim Lleshi, Dr. Vesel Hoxha etj. të cilët japin të dhëna të plota për vendndodhjet e studiuara të kromeve në këtë zonë, si në fushe Balgjaj, kodrën e Lerës, kepat e Dik Nelit, Bataqet e Kacnisë, fushe Shtrunz, Rrënja e Milloshit, Maja e Hurdhës etj. disa prej te cilëve dhe qenë të shfrytëzuar deri në prag të viteve '90.

Në shfrytëzimin e ujërave që rrjedhin nga këto male mund të ngrihen disa HC lokal, ku dhe për vetë konfiguracionin e kësaj zone , për to nuk del domosdoshmëri ndërtimi i digave, të cilat përveç se do të donin shpenzime të mëdha, por dhe për shkak të prurjeve të rrëmbyeshme, do të mbusheshin shpejt me dhera e materiale të tjera të ngurta. E për këtë ujërat mund të merren duke devijuar nga shtratet e lumenjve e nëpërmjet kanaleve përcjellës dërgohen në disnivelin e kërkuar për ndërtimin e HC.

Theksojmë se në këtë drejtim ka filluar puna, ku janë projektuar e dhënë për t'u ndërtuar HC, një në lagjen Hane të fshatit Selishtë, me kapacitet 1,3 MW dhe një tjetër në lagjen Margjoke të fshatit Kacni, me kapacitet 1,1 MW. Në HC Selishtë ka filluar ndërtimi nga biznesmeni i kësaj zone Z.Ramazan BIBA.



Përveç këtyre dy HC, në këtë zonë ka dhe vende të tjera, që me studime të vazhdueshme, mund të ngrihen dhe në lagjen Kodrrase e Lunar të Kacnisë etj.

Si burim të energjisë elektrike në këtë zonë mund të shfrytëzohet dhe era, kjo sidomos në Limoqe të Qafmurrës dhe ne Qafthanë të Selishtës, ku për vetë konfiguracionin e këtyre dy vendeve erërat në drejtim Lindje-Perëndim përshkoj në një luginë të ngushtë me mbi 30 km (nga Muhurri në Qafmurrë).

Me ujërat që burojnë e rrjedhin nga këto male mund të kultivohet dhe peshku, sidomos trofta, me vlera të mëdha për cilësinë e tij, duke krijuar rezervate si dhe mbjelljen e tij në ujëmbledhëset e ndërtuar për ujitjen e bimëve, si në Qafmurrë, Lukan e Zmaq të Selishtës.

Masivi malor i kësaj zone është shumë i pasur dhe me bimë eterovajore e medicinale, si lule shtrydhe, mullage, trëndafil i egër, lule delli, lule shtogu, dëllinje e kuqe dhe të zezë, hithra, druna kuqi, çaje mali, sherbel etj., që disa prej tyre dhe mund të mbillen e kultivohen në parcela nga vetë fermerët e kësaj zone, e ndër ta mund të përmendim sherbelën.

Në një artikull të botuar në gazetën "Rruga e Arbërit", në muajin Mars 2008, të shkruar nga studiuesi i kësaj fushe Z. Dali Horeshka, jepen në detaje vendet ku mundësohet kultivimi i sherbelës dhe leverdishmëria e saj, ku në përllogaritjet e bëra arrihet që nga një dynym i mbjellur me këtë bimë, nxirret jo më pak se 100 mijë lekë të ardhura në vit.

Kultivimi i saj ka filluar në shumë fshatra të Kukësit dhe në disa fshatrave të Dibrës.

Brenda kësaj zone ka masive të mëdha guri gëlqerore për prodhim gëlqere e deri në atë të çimentos si dhe material guri të fraksionuar për shtrim rrugësh.

Siç kemi përmendur dhe më parë sipërfaqja tokësore e kësaj zone predominohet nga masive malore, kjo gati sa 10-fishi i tokës së punueshme.

Ajo është e veshur me shumëllojshmëri drujsh, që fillojnë me dushqet, palnjen, fi-asherin, shkozën dhe varion me ahun e halorët. Në të rriten dhe pemë te zhvilluar në mënyrë natyrale si molla, dardha, thana, arra, lajthia etj.

Në lugina e shpate malore rriten e zhvillohen luleshtrydhe, manaferra, dredhza, qershia e egër etj. si dhe lule të shumë lloj ngjyrave, si lule pishe, lule zonje, lule gjashtëgjishte, etj.

Malet e kësaj zone janë të populluar dhe me kafshë të egra si ariu, derri i egër, ujku, dhelpra, kunadhja, lepuri, ketri si dhe shpend të egër si shqiponja, skifteri, thëllëza, rosa e egër, gjeli i egër etj. të cilat shërbejnë edhe si rezervat gjuetie.

Në majë të malit Balgjaj të Kacnisë, në 2100 m lartësi mbi nivelin e detit, janë rreth 10 liqej karstik me origjinë akullnajore të rrethuar me pyje e lëndina alpine, të cilat i japin bukuri të mëdha këtij vendi.

Brenda këtyre maleve ka mjaft burime ujërash të ftohtë e të kristaltë, si kroi i Skënderbeut, gurr vorba, kroi i bardhe, kroi i selizës etj.

Në veri të kësaj zone, në kufi me atë të Lurës, lartësohet mali i Rrunjës të fshatit Lukan, me 2048 m mbi nivelin e detit. Nga maja e këtij mali shihet gati e gjithë treva e Dibrës dhe e Matit, e ndërsa në orët e mbrëmjes, në ditët e kthjellta, nëpërmjet lenteve zmadhuese (dylbi), shihet qyteti i Durrësit, e më tej deti.

I gjithë ky masiv malor, që për shekuj të tërë ishte shfrytëzuar kryesisht për mbarështim të blegtorisë dhe material drusor, për ndërtim të shtëpive dhe ngrohje, vetëm nga mesi i shekullit të kaluar e më vonë, në të u bë shfrytëzimi i pyjeve për material drusor dhe nëntoka e tij për nxjerrjen e mineralit të kromit, ky kryesisht në malin e Balgjajt.

Në kohët e sotme, ku kërkesat shkojnë në rritje për frekuentimin e turizmit malor, si nga brenda dhe jashtë tij, nga turistë të huaj mbështetur në resurset e kësaj zone, që dhe i përmendëm në mënyrë të përmbledhur, mendoj se ata do të gjejnë vendin e përshtatshëm për to, si në atë klimaterik veror dhe të atij sportive dimëror.

Në turizmin klimaterik veror, ku klima është dhe prioriteti parësor tërheqës , si ajri i pastër, që vjen si rrjedhojë e lartësive me mbi 1000 m mbi nivelin e detit, të ujërave të ftohta e të kulluara, të të qenunit midis pyjeve , duke thithë aromën e tyre si gjate pushimeve apo në ecje në formë shëtitje në udhëtimet në këmbë apo në automjet (ku për arsye të transportit të materialit drusor dhe të mineralit të kromit, gati i gjithë masivi malor, deri tek liqejt, përshkohet me rrugët automobilistike).

Krahas turizmit veror, në këtë zonë mund të zhvillohet dhe ai sportiv dimëror, për vozim me ski. Për këtë që në dimër ky vend mbulohet me dëborë. Brenda kësaj zone ka disa pista natyrale për ski, si në Prat e rrethinat e tij, në Lulaq, mbas Runje, Balgjaj etj .

Turistët, sidomos të huajt, të shtyrë nga kureshtja, mund të vizitojnë dhe vende historike të kësaj zone, te cilat dhe nuk janë të pakta.

Ndër to kalanë e Stelushit (Skënderbeut) kjo në veriperëndim të fshatit Qafmurrë, që në kërkimet arkeologjike del të ketë qene si vend i populluar që në vitet 700 para erës sonë, si qytet i takon të jetë i periudhës mesjetare dhe si kala të jetë ndërtuar mes shekujve 13 - 14.

Brenda kësaj zone ka dhe rrënoja e toponime të tjera, si kalaja e qyteza në fshatin Selishtë, të cilat i takojnë periudhës romake e më vonë, si dhe shumë vend toponime të kishave, në çdo fshat, ku ndërtimi i tyre mendohet të jetë i periudhës së shekujve 13-14, ku kanë funksionuar deri në fillim të shekullit 17 me islamizimin e banorëve vendas.

Për të aktivizuar turizmin në këtë zonë, që deri në ditët e sotme nuk funksionon, si fillim mund të akomodohen shtëpitë ekzistuese të kësaj zone, duke u krijuar kushtet e nevojshme si ujin, dritat, të ushqyerit si dhe të mundësive lëvizëse të tyre.

Është fakt se në këtë vend me tradita të zhvillimit bujqësor e blegtoral, ato do të gjejnë të gjithë ushqimet "BIO", si frutat, perimet e sidomos ato blegtorale si mishin, qumështin e nën produktet e tij, mjaltin etj.

Kohë pas kohe këtu mund të ngrihen dhe

(Vijon në faqen 9)

Në foto: Xhamia e 100 dritareve në Dibër të Madhe. foto poshtë: Kryetari i bashkisë së Tiranës, kryetari i Bashkësisë Islame të Maqedonisë, Sulejman Rexhepi dhe kryetari i BDI, Ali Ahmeti, duke prerë shiritin e përurimit. Fotot: ©Rexhep Torte

Përurohet xhamia e 100 dritareve

Marrin pjesë në përurim kryetari i BDI Ali Ahmeti dhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Lulzim Basha



Nga **Rexhep TORTE**

Në Dibër të Madhe të shtunën, më datë 26 janar 2013 u bë përurimi solemn i Xhamisë të Sahati. Në këtë eveniment morën pjesë shumë dibranë besimtarë, në mesin e të cilëve edhe Lulzim Basha, kryebashkiaku i Tiranës, Nijazi Kosovrasti, kryetar i Këshillit të Tiranës, Reis Sulejman efendi Rexhepi, kryetar i BFI, Argëtëm Fida, kryetar i Komuns së Dibrës, Petrit Imami, kryetar i KK të Dibrës, Ruzhdi Lata, myfti i Dibrës së Madje, Ali Ahmeti, lider BDI, Xhemal Gjunkshi, shef Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë së Shqipërisë, Gëzim Ostreni, general nga Dibra e Madhe, Faruk Borova, kryetar i Shoqatës "Bashkësia Dibrane" në Tiranë, Yllka Çausholli, kryetare e Komitetit për Rrugën e Arbërit, Hysen Xhara, kryebashkiak i Njësisë bashkiake 4 në Tiranë, Florent Pustina, Drejtor Infrastrukturës Tiranë, Gazmend Dibra, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve Tiranë, Flamur Gjylikbashi, Drejtor i përgjithshëm i Doganave Tiranë, Ilir Krosi, kryetar i Bashisë së Peshkopisë, Naim Gazidede, kryetar i Qarkut dhe Genc Sharku, Prefekt i Dibrës, përfaqësues të myftinive dhe institucioneve të dy vendeve.

Evenimente të tilla të bukura e të paharruara mund të ndodhin vetëm në Dibër të Madhe, në Dibrën e Perëndisë, bujarisë, besës, mikpritjes, urtësisë, të pushkës e mençurisë. Kjo xhami përbri rrugës që çon nga Dibra në drejtim të Strugës, është karakteristike për nga ndërtimi, kulla e sahatit dhe 100 dritaret në shenjë të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Me këtë rast u vendosën lule të freskëta te varri i rilindasit Said Najdeni, që ndodhet në oborrin e kësaj xhamie, u shpalos Pllaka Përkujtimore dhe shpalosja e grafikës për nder të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shtetit Shqiptar.

Ruzhdi Lata, myfti i Dibrës së Madhe, duke e hapur këtë ceremoni, tha se "sot është ditë e shënuar, ditë gëzimi, manifestim për muajin e lindjes së Muahmedit a.s.. Është një ngjarje që ne dibranët e kemi pritur me ditë, me muaj, kemi bërë disa biseda dhe më në fund u realizua ajo që mendonim që këtë xhami do ta përurojë kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe Reiz Ulemaja i BFI. Këtë manifestim e ndajmë në dy pjesë, në atë fetare si shtëpi fetare, dhe atë historike ku dibranët e kanë historinë e vet, duke filluar nga Haxhi Vebi Dibra, kryemyfti i Shqipërisë dhe kryetar i Senatit të parë shqiptar, duke përmendur Hafuz Ismetin, pedagog dhe teolog i shquar në Tiranë, duke kujtuar gjithmonë me respekt dhe nderim Muharem Mullain, vaizin e Tiranës, duke kujtuar mësuesin e fesë dhe gjuhës shqipe Haki Sharofin dhe të gjithë të tjerët. Të gjithë këta kanë vepruar dhe punuar në Dibër të Madhe, në këto xhami që ne i gëzojmë sot e që dikur një dhunë i shkatëroi, por ne arritëm ti rindërtojmë, arritëm të ndërtojmë objekte tjera fetare për nevojat e Dibrës. Kjo xhami që sot e përurojmë është një simbolikë. Ne festuam 100 vjetori e Pavarësisë së Shteit shqiptar dhe ditën e Flamurit. Sot në vitin 2013 kujtesa dibrane e kujton shumë mirë vitin 1913, që ishte vit i zi i dibranëve, vit i gjenocidit në Dibër. Kur Dibrës sofrën e madhe ja hapi dhe ja ofroi Tirana. Ne Myftini e Dibrës dhe si Bashkësi islame në këtë vend dëshirojmë të fillojmë me Bismilah. Dëshirojmë të fillojmë në emër të Zotit përurimin e kësaj xhamie, duke kujtuar të kaluarën e duke ecur përpara, të zhvillohemi më shumë me bindje në Zotin ashtu do ti shërbejmë edhe popullit. Amanet e kemi nga Haxhi Vebiu, Hafëz Sherifi e të tjerët, të cilët morën pjesë në shpalljen e Pavarsisë, që ta duam Dibrën, ta duam Tiranën, ashtu si Muhamedi a.s. deshi Mekën dhe Medinën. Të këtillë duhen të jenë dibranët në tërësi. Sot përjetojmë një gërshetim të dibranëve kudo që jetojnë, kanë ardhur të festojnë me shpirtin dibran, kanë ardhur të festojnë festën e Dibrës së Madhe, kanë ardhur të përurojnë xhaminë që simbolizon Xhaminë e Isen Beut në Tiranë. Jo rastësisht kjo Xhami e ka këtë pamje, është e vetmja sahatkullë në 100 vjetët e fundit që ndërtohet në Dibër si ajo në Tiranë. I nderuari profesor Mahmud Hysa ka shkruajtur një libër që na inspiron, ku flitet për gjenocidin që u bë në Kosovë, ku thuhet një Kosovë e vogël në Dibër të Madhe, sot është ndryshe një Tiranë e Madhe në Dibër të Madhe. Në Dibër ashtu si kanë punuar të parët tanë që kanë ditur të gërshetojnë shumë mirë nacionalen me fetaren, sot përveç xhamisë do të shpalosim Pllakën përkujtimore 100 dritare për 100 vjetorin e Pavarësisë. Ishte ide e një të riu dibran që ndërtoi 100 dritaret prej guri sepse guri simbolizon qëndresën e shqiptarëvë në historinë e vet. Bashkë me të kemi mbjellur edhe 100 drunj që do t'i japin në mënyrë simbolike jetë Dibrës. Në Tiranë ka ekzistuar një shoqëri "Djelmëria dibrane", por sot në Dibër ekziston një grup të rinjësh të cilët na kanë dhuruar një grafikë kushtuar 100 vjet Pavarësi në emër të respektit për Myftinë edhe atë do ta shpalosim bashkërisht të gjithë ne. Mysafirëve u dëshiroj mirseardhje, qëndrim të gëzueshëm dhe lirshëm të deklarojmë se e duam Dibrën", tha myftiu Ruzhdi Lata.

Sulejman efendi Rexhepi, kryetar i Bashkësisë Islame të Maqedonisë, deklaroi se,"Sot është kënaqësi shumë e madhe që ndodhemi në mesin tuaj që sëbashku me ti gëzohemi këtij manifestimi në Dibrën e Madhe në përurimin e këtij tempulli të shenjtë, që Kur'ani famëlartë thot Xhamitë i themelojnë, xhamitë i meremetojnë vetëm ata që kanë besim të fuqishëm në Allahun fuqiplotë, që kanë një respekt shembullor ndaj Muhamedit a.s., besojnë në ditën e gjykimit dhe e duan shpirtin e vet. Ju dibranët sot demostroni besimin e paluhatshëm që keni pasur brez pas brezi dhe jo rastësisht në ditën e sotme, Dibra në të kaluarën ka qenë një depo e intelektualëve fetarë e kombëtarë. Lus Allahun Fuqiplotë që gjithë ulematë islam, të gjithë dijetarët islam që kanë dhënë kontribut të madh në histori si në aspektin shpirtëror ashtu edhe në aspektin kombëtar, që Allahu Fuqiplotë ti shpërblejë me të mirat e tij që i ka në thesarin e Tij të pashtershëm. Sot është kënaqësi e veçantë dhe këtë që kanë bërë dibranët, djersa e këtij populli e shohim sot të gjithë sëbashku dhe është një dëshmi konkrete. Në Dibrën e Madhe shumë xhamia mungonin, u rënuan nga sistemi totalitar komunist por deshti Zoti me ardhjen e demokracisë në këto troje numri i xhamive në Dibër u plotësua me ndihmën e të gjitha strukturave duke përfshirë edhe Komunën e Dibrës dhe kryetarin e saj, i cili në asnjë moment nuk u zbraps që të gjitha kërkesat e Bashkësisë Islame të Maqedonisë i ka miratur dhe ka qëndruar besnik sëbashku me njeriun e parë të Bashkësisë Islame këtu në Dibër z.Ruzhdi Lata. Të flasim për personalitetin e Myftiut të Dibrës me të vërtetë duhet shumë kohë. Ruzhdi Lata ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, ka pasuar rrugën e Vehbi Dibrës dhe shumë kolosëve të tjerë fetarë, intelektualë dhe patriotë të këtij nënqielli. Në këtë xhami që sot e përurojmë lus Allahun fuqiplotë që ai ta bekon kontributin e të gjithëve që kanë kontribuar. Më lejoni të përkujtoj një thënie të Muahmedit a.s. i cili thoshte" Kushdo që merr pjesë në ndërtimin e një tempulli të shenjtë të Xhamisë sadopak që të jetë ajo pjesëmarrje Allahu Fuqiplotë e kundërshpërblen dhe në jetën e amshueshme do të ketë pallate në Xhehnet". Të gjithë ato që kontribuan dashtë Zotin që tju jep shëndet, forcë, energji, kapital, për të bërë edhe punë të tjera të infrastrukturës me interes për popullin tonë. Qoftë i bekuar ky

RUZHDI LATA: Dëshirojmë të fillojmë në emër të Zotit përurimin e kësaj xhamie, duke kujtuar të kaluarën e duke ecur përpara, të zhvillohemi më shumë me bindje në Zotin ashtu do ti shërbejmë edhe popullit. Amanet e kemi nga Haxhi Vebiu, Hafëz Sherifi e të tjerët, të cilët morën pjesë në shpalljen e Pavarsisë, që ta duam Dibrën, ta duam Tiranën, ashtu si Muhamedi a.s. deshi Mekën dhe Medinën.

LULZIM BASHA: Ne dimë dhe duam të ndërtojmë në paqe dhe të ardhmen me fqinjët tanë, dhe padyshim do ta bëjmë këtë. Për këtë duhet shumë punë dhe puna e cila ka nisur do të përfundojë. Sikurse Rruga e Arbërit që shtrihet përditë ne do të shembim edhe pengesën e fundit do t'i japim Dibrës, tërë kombit shqiptar Rrugën e Arbërit, qendrën e Dibrës me qendrën e Tiranës do ta bëjmë që të jetë larg vetëm një orë.

RUZHDI LATA: Dëshirojmë të fillojmë në emër të Zotit përurimin e kësaj xhamie, duke kujtuar të kaluarën e duke ecur përpara, të zhvillohemi më shumë me bindje në Zotin ashtu do ti shërbejmë edhe popullit. Amanet e kemi nga Haxhi Vebiu, Hafëz Sherifi e të tjerët, të cilët morën pjesë në shpalljen e Pavarsisë, që ta duam Dibrën, ta duam Tiranën, ashtu si Muhamedi a.s. deshi Mekën dhe Medinën.



vendlindja

tempull i shenjtë, qofsh të bekuar të gjithë ju, zoti u shpërbleftë".

Argëtim Fida, kryetar i Komunës së Dibrës, u shpreh se, "Edhe kjo vepër të cilën sot do ta inagurojë ka qenë shprehje e një bashkëpunimi të frytshëm të pushtetit vendor me Myftinë e Dibrës dhe BFI-në. Siç ishte Bulevardi "Iliria" dhe qendra sportive në Dibër. Uroj që këtë xhami ta gëzojnë gjithë besimtarët, këtë arkitekturë tradicionale dibrane dhe këto 100 dritare të 100 vjetorit të Pavarësisë të jenë shembull se këtu dibranët do të të qëndrojnë dhe të rrezatojnë siç kanë rezatuar ndër shekuj", tha Argëtim Fida.

Lulzim Basha, kryetar i Bashkisë së Tiranës, u shpreh se, "për mua është një nder dhe emocion i veçantë që ndodhem sot midis jush si kryetar i Bashkisë së Tiranës, por edhe si bir dibrani e nip dibrani. Falenderoj që jam pjesë e kësaj ngjarje të shënuar për Dibrën e Madhe, sepse Dibra ka qenë, është dhe do mbetet nji e vetme dhe e bashkuar. E bashkuar në ato vlera të cilat i morëm njiqind vite më parë në kushte të një eksodi pothuajse biblik ku urrejtja, përçmimi, paragjykimi dhe lakmia u turrën mbi trojat tona stërgjyshërore dhe bënë që mijëra familje dibrane që i mbijetuan gjenocidit të shpërnguleshin drejt qyteteve perëndimore të kombit tonë. Në një qytet pak a shumë sa Dibra e Madhe e sotme ishte Tirana sokohe. Ku mbërritën me mijëra familje dibrane. Tirana sot është një qytet i Madh, Dibra quhet Dibra e Madhe por këta dy qytet janë të mëdhenj sepse banohen nga njerëz me shpirt të madh, nga njerëz me një kulturë të madhe, një dashuri të madhe për njërin tjetrin, për kombin dhe për Zotin, sepse këto vlera bënë që të hapeshin dyert e shtëpive dhe vatrave të banorëve të Tiranës. Për një kohë fare të shkurtër dibranët e shpërngulur i thanë vetes së tyre se edhe jemi qytetarë të Tiranës. Unë jam sot këtu për tu përcjellë juve vëllezërve dhe motrave, nënave dhe baballarëve të Dibrës përshëndetjet më të përzemërta të qytetarëve të Tiranës, si dhe garancinë se ajo që ndodhi para 100 vjetësh nuk do të kujtohet me trishtimin që përshkon çdo gjë e hidhur, me vetbesimin se na ka bërë më të fortë, duke na na sjellë më afër njëri-tjetrit siç jemi sot këtu. Vlera më e madhe e njeriut është besimi. Kjo ngjarje e sotme është një ngjarje emocionuese se këtu në qendër të Qytetit të Dibrës përurojmë sëbashku një objekt të veçantë Xhaminë e Dibrës, përgëzoj Myftiun e Dibrës dhe të gjithë ata klerikë që punuan në këtë projekt dhe të gjithë ata që e mbështetën. Duhet të përgëzoj edhe për ndërtimin në zemër të Dibrës një pjesë të zemrës së Tiranës duke përfshirë edhe Kullën e sahatit. Garantoj se unë vazhdoj të marr frymëzim nga Dibra dhe dibranët, dhe frymëzim është që kësaj pranvere tia nisim punës për Xhaminë e Madhe në Tiranë. Pak ka rëndësi nëse jemi në Tiranë apo në Dibër, Manastir, Strugë, Ohër apo Preshevë. Ne jemi një, siç është Zoti Një, Dibra një dhe kombi shqiptar një dhe i pandarë.Vlerat që na bashkojnë dhe që na kanë mbajtur gjallë, vlerat e tjera me të cilat kemi ndërtuar dinjitetin tonë përballë shkuljeve shumë herë më të furishme, janë vlera të tolerancës, besimit tek Zoti të paqës dhe dashurisë. Askush nuk duhet të ketë frikë nga një komb i bashkuar shqiptar. Bashkimi ynë është një bashkim shpirtrash. Ashtu siç thotë Sali Berisha projekti shpirtëror i çdo shqiptari. Sa herë që kemi qenë të bashkuar kemi qenë më të fortë kemi qenë më mirë, por më mirë kanë qenë edhe fqinjët tanë, më e sigurtë ka qenë Europa. Nuk ka shembull më të mirë se sa të kujtojmë stërnipin e kësaj toke heroin tonë kombëtar Skendërbeun. Bashkimi jonë nuk pengon por e ndihmon integrimin Europian të të gjitha trojeve dhe shteteve ku banojnë sot shqiptarët. Bashkimi ynë nuk është një bashkim kërcënues as lakmiqar, as grabitës, as paragjykues, sepse ne i hoqëm mbi shpinën tonë këto të zeza deri para disa dekadash e vitesh. Ne dimë dhe duam të ndërtojmë në paqe dhe të ardhmen me fqinjët tanë, dhe padyshim do ta bëjmë këtë, sepse jemi të vendosur, kemi vizonin dhe udhëheqjen për ta bërë këtë. Për këtë duhet shumë punë dhe puna e cila ka nisur do të përfundojë. Sikurse Rruga e Arbërit që shtrihet përditë ne do të shembim edhe pengesën e fundit do t'i japim Dibrës, tërë kombit shqiptar Rrugën e Arbërit, qendrën e Dibrës me qendrën e Tiranës do ta bëjmë që të jetë larg vetëm një orë. Do na duhej ta shpjegonim këtë deklaratë para shtatë apo tetë vjetësh, e sot ju themi mosbesuesve shikoni tunelin e Kalimashit dhe të Krrabës se brënda një kohe të shkurtër edhe zemra e Murrizës do jetë e shpuar jo me nji po me dy tunele. Bashkimi ynë do vijë pra nëpërmjet një pune e cila ka nisur e duhet të vazhdojë me infrastrukturë të re, me projekte të reja, me bashkimin ekonomik, me bashkimin shpirtëror, kuluror, artistik me bashkimin e të rinjve tanë që të jenë gjithmonë e më afër njëri-tjetrit. Nuk e kemi asnjë synim grabitqar as destabilizues, duam dhe urojmë që rajoni ynë të përqafojë praktikën europiane nëpërmjet integrimit të plotë në Bashkimin Europian. Askush nuk e dëshiron më shumë se shqiptarët këtë, por le ta dijë çdo kush që i bën hesapet me paragjykimet e së kaluarës që frymëzohet akoma me veprimet e kërcënimit, paragjykimit, të presionit, se çdo shqiptar pavarësisht ku jeton nga Medvegja e Bujanovci në Manastir e Ohër, ka mbrapa kombin shqiptar të bashkuar si një trup i vetëm, ndaj duke marrë frymëzim nga ky bashkim i dibranëve sot pavarësisht se ku jetojnë në SHBA, mikun dhe aleatin tonë strategjik e historik, apo në vendet e Bashkimit Evropian, të frymëzuar siç dijnë të frymëzojnë bijt dhe bijat e Dibrës, të bashkuar në këtë ceremoni të inagurimit të këtij tempulli të Zotit, duke uruar me urimin e vjetër dibran që projektet tona individuale, përpjekjet tona dhe të pushtetarëve tanë për një jetë më të mirë, për paqe dhe më shumë mirëqenie, për shumë punime për më shumë shanse për rininë, përpjekjet tona kombëtare për të qenë më afër njëri tjetrit, t'i çojmë me fjalën e vjetër krakateristike të Dibrës me Zotin përpara", u shpreh Lulzim Basha.

Ali Ahmeti, kryetar i BDI, tha: "Shpreh respektin dhe mirënjohjen ndaj të gjithë atyre predikuesve që sfiduan në kohet e vështira e të rezikshme dhe tërë atyre predikusve e ligjëruesve që kanë kontribuar te shqiptarët me dinjitet dhe krenari, guxim që të përballen me vështirësitë, që koha i ka organizuar dhe nxjerrë në sipërfaqe për të gllabëruar, coptuar shqiptarët. Me të vërtetë viti 1913 ka qenë kob i zi. Mijëra e mijëra njerëz janë ekzekutuar e persekutuar nga ushtria barbare serbe. Sot jemi mbledhur të gjithë këtu që të përjetësohen të gjithë ata njerëz me këto 100 dritare. Këto 100 dritare do të flasin në 100 e 100 vitet e ardhshme të të gjitha gjeneratave që do vijnë pas nesh, sepse janë përjetësuar në gurë. Urime dibranëve, dalshim faqebardhë në të gjitha punët që i kemi përpara me të gjithë këta njerëz të devotshëm dhe të përgjegjshëm. Përshëndes kryetarin e BFI, të gjitha myftintë me përfaqësuesit që i përfaqëson e që ngërthen të gjitha vlerat ato kombëtare dhe ato fetare" tha Ali Ahmeti.

Gjatë qëndrimit në Dibër, Lulzim Basha dhe shoqëruesit e tij u pritën nga Argëtim Fida në ambientet e Komunës me çrast u mbajt edhe një mbledhje e Këshillt të Komunës të Dibrës ku morën pjesë edhe mysafirët nga Tirana. Pas kësaj vendosën lule edhe te shtatorja e Skenderbeut.

Zyber Lata, lexoi pjesë nga Kur'ani, nërsa lutjen për përurimin e xhamisë e bëri Alifekri Esati, myftiu i Tetovës.

Mexhit Capa, pronari i Banjave të Dibrës, për nder të inagurimit të kësaj xhamie dhe të mysafitëve nga Shqipëria shtroi një drekë për më shumë se 300 veta me meny karakteristike dibrane.

Katër Grykët

(Vijon nga faqja 7)

kampingje, në vende ku preferohen nga pushuesit, sidomos pranë burimeve ujore dhe tek liqenjt e Balgjajt. Në një të ardhme këtu mund të ngrihen dhe hoteleri, si ne lagjet shesh të Kacinisë dhe në krye të lagjes Skënderë të Selishtës, të cilat ndodhen atje ku fillon masivi malor me mbi 1000 m mbi nivelin e detit.

Në vënien në efiçencë të turizmit në këtë zonë, krahas propagandimit për njohjen e saj nëpërmjet shkrimeve, rol me shumë rëndësi do të luanin emigrantët, të punësuar në vende të ndryshme të botës, të cilët do të tërhiqnin turistë si për periudhën e verës dhe atë të dimrit, siç kanë vepruar në zona të tjera të vendit, në Lurë, Steblevë apo në Theth të Malësisë së Madhe, Dardhë të Korges etj, që nga viti në vit është shtuar numri turistëve të ardhur, si nga Anglia, Gjermania, Amerika etj. ku disa nga familjet e këtyre vendeve i kane kthyer shtëpitë e tyre në hoteleri për këtë qëllim, duke siguruar të ardhura të mëdha prej tyre.

Krahas turistëve të ardhur nga vende të tjera të botës, në këtë zonë mund të vijnë dhe nga qytete të vendit, për t'u larguar për disa kohë nga vendet urbane të ndotura si nga dendësia e popullimit dhe të industrisë. Për këtë mund të ndikojnë banorët e larguar nga kjo zonë e vendosur me banim në këto qytete për të reklamuar tërheqjen e tyre në këtë vend malor.

-Por që të vihen në shfrytëzim resurset e kësaj zone në radhë të parë duhet t'u kërkohet organeve përkatëse të qeverise, e nëpërmjet tyre donatorëve të huaj e vendas, sidomos shfrytëzimin e mineralit të kromit, të prodhimit të energjisë elektrike, qoftë hidrike dhe ato nëpërmjet shfrytëzimit të erës.

-Në mbledhjen e grumbullimin e bimëve medicinale, ku të mundësohet ngritja e pikave të blerjes nga vetë tregtarët përkatës.

-Në kultivimin e peshkut, i cili dhe do investim paraprak në ngritjen e rezervateve, të blerjes rasatit e ushqimit, për to lipset që kultivuesve t'u jepet kredi nëpërmjet bankave.

Edhe për vënien në efiçencë të turizmit del domosdoshmëri dhënia e kredive, sidomos për akomodimin e shtëpive.

Për të gjitha këto resurse që përmendëm më lart, duke përfshirë këtu dhe zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, bletarisë etj., për ta do të mbetej shqetësim infrastruktura rrugore, e cila bën që kjo zonë të afrohet më shumë me qytetet e vendit, e aq më tepër me ato të Tiranës e Durrësit, ku dhe pas vitit 1990 dhe janë ngulur me banim mbi 90 % e banorëve të larguar nga kjo zonë.

-Për këtë varianti më i mirë do të ishte ai I ndërlidhjes së kësaj zone me një degëzim të rrugës së "Arbërit", që fillon në qytetin e Klosit, përshkon fshatin Patin e Kurdari (kjo rrugë ekziston), për të vazhduar në fshatin Vinjoll e të bashkohet me rrugën ekzistuese në fshatin Qaf-Murrë.

Segmenti që mund të ndërtohet kjo rrugë (Kurdari - Qaf-Murrë) megjithëse do studim, por nuk i kalon 20 km - e ndërsa segmenti Klos - Kurdari thuhet të jetë rreth 15 km, nga ku rruga Klos- Qaf-Murrë nuk do t'i kalojë 35 km.

-Sa përmendëm më sipër, ndërlidhja e kësaj zone me qytetin e Klosit e më tej me Tiranën, do te bënte që qyteti I Tiranës me zonën e Katër grykëve të ishte jo më shumë se 70 km (Tiranë - Klos 35 km + Klos - Qafmurrë 35 Km = 70 km) ose sa gjysma e rrugës që ekziston në ditët e sotme.

Histori njerëzore

I shpëtoi jetën nxënësit

Para pak ditesh ne shkollen ne shkollen "Isa Boletini " Tirane ndodhi nje ngjarje qe trondit i punonjes e nxenes.

Nxenesi i klases se 7-te, E.C., ra papritur ne gjendje koma diabetike me shenja epilepsie, renkime, gjuha i iku duke rrezikuar vdekjen. Alarmi solli ne menyre te rrufeshme mesuesin e edukukimit fizik Edmond Leskaj, i cili se bashku me kolegun Nesim Fusha i dhane ndihmen e pare me mjete rrethanore.


Edmond Leskaj

Djali po luftonte me vdekjen por profesori nuk u dorezua. Mesuesit shtangen, shoket dhe shoqet e klases qanin, Anila i jepte kurajo Edit, Liljana vrapoi drejt ambulances se Koder-Kamzes per mjekun per te dhene ndihmen e pare mjeksore, ndersa Artani beri gati makinen per ta cuar urgjent ne spital. I semuri nuk jepte shenja jete. "Nga emocionet e forta,- thote Edi,- me shteruan edhe forcat. Kjo situate zgjati shume aq sapo humbisnim shpresat".

Vendosmeria dhe kembengulja e mesuesit pas gjysem ore ne lufte me vdekjen e djalit 12-vjecar e sollen ne jete ate duke deshmuar nje akt humanizmi per te cilin ka aq shume nevoje shoqeria jone.

Ndihma nuk ishte vetem fizike por edhe profesionale. Ky akt human ishte pjese e sa e sa akteve humane qe kane realizuar prinderit e Edit si mjek ne qytetin e Tiranes. Shpetimi i nxenesit u kthye keshtu ne nje gezim te papershkruar tek nxenesit e mesuesit krenar per kolegun e tyre.

Drejtori i shkolles Zaim Gjana falenderoi Edin, Anilen, Gerta Hysen dhe gjithe mesuesit qe treguan gadishmeri ne funksion te jetes se nxenesit. Ky eshte nje shembull dhe pervoje per te qene gjithnje optimist e me kurajo te perballojme te gjitha emocionet e situatat qe na krijohen ne shkolle. Domosdoshmeri do te ishte prania e nje mjeku gjate gjithe diteve te javes, pasi jemi shkolle me nje numer te konsiderueshem nxenesish.

Mirenjohje dhe falenderime mori mesues Edi edhe nga prinderit e nxenesit, si dhe gjithe komuniteti i Koder-Kamzes. Faleminderit profesor!

ZABIT LLESHI

Rruga e Arbërit nr. 81

rajoni

Foto ilustruese



Nuk mund të këtë bashkim kombëtar të shqiptarëve pa një shkallë të lartë të zhvillimit të tyre politik, ekonomik, kulturor, arsimor, si dhe të nivelit të demokracisë dhe të qytetarisë, "në kuotat" dhe në nivelin e duhur të demokracisë europiane. Ky zhvillim bëhet jo me deklarata (nga lart), por me punë (nga poshtë) dhe varet vetëm nga ne, nga përpjekjet tona, nga përkushtimi ynë për qytetarët dhe vendin.

Nacionalizmi, si forcë e fuqishme politike dhe bashkimi i shqiptarëve

Nga **Prof. Dr. BASHKIM RAMA**

Historia politike, teoritë dhe praktika njerëzore kanë vërtetuar, në mënyrë konstante, se ***nacionalizmi është forca më e fuqishme politike në Botë***. Madje, jeta ka vërtetuar se, të përpiqesh ta injorosh një dukuri të tillë, do të thotë të marrësh përsipër një faturë "të kripur" e të pallogaritur mirë.

Profesori i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në *Harvard University's Kennedy School of Government* dhe redaktor i revistës *Foreign Policy*, **Stephen M. Walt**, i pyeti studentët e tij**:** *Cila është forca politike më e fuqishme në Botën e sotme?*

Përgjigjet e studentëve, kuptohet, ishin nga më të ndryshmet:

- Disa thanë se mund të jetë "*net –work"- u (rrjeti) tregëtar*.
- Disa "vlerësuan" *ringjalljen e fesë dhe të rolit të saj*.
- Disa, të tretë, *avancimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut*.
- Të tjerë "hamendësuan" se mund të ishte *teknologjia dixhitale e simbolizuar nga interneti dhe gjithçka, që vjen "në paketë" me të?!*
- Disa të tjerë mendonin, gjithashtu, që mund të *ishin armët nukleare dhe efekti që kishte përhapja e tyre në mënyrën se si shtetet "e dimensiononin" sigurinë e tyre kombëtare dhe përdorimin e forcës*.

Këta ishin, pak a shumë, "*adresimet*" në të cilat studentët ishin pozicionuar jo keq, pa mohuar që mund të kishte edhe "*nominime*" të tjera, por përzgjedhja personale e profesorit të nderuar, lidhur me "*forcën politike më të madhe në Botë*" ishte e mbetet **- Nacionalizmi**. Argumentet për këtë janë të shumta.

Besimi se njerëzimi është i përbërë nga kultura të ndryshme – d.m.th. grupe që ndajnë të njëjtën gjuhë, simbolet dhe historinë e tyre të shkuar (e cila varion nga shërbimi për të krijuar një histori, deri në mite), si dhe kërkesa që kanë këto grupe *për të pasur shtetin e tyre, ka qenë forca më e fuqishme mbizotëruese në Botë, përgjatë dy shekujve të fundit:*

- Nacionalizmi ishte forca që krijoi shumicën e fuqive europiane të kohëve moderne, duke i kthyer ato nga shtete "*dinasti*", në shtete "*kombëtare*". Në të njëjtën kohë, ishte ideologjia nacionaliste ajo që "ndihmoi" në shkatërrimin e perandorive britanike, otomane, franceze, holandeze, portugeze, austro-hungareze e ruso-sovjetike.
- Nacionalizmi është arsyeja që Kombet e Bashkuara kishin 45 shtete anëtare në momentin e krijimit të organizatës në vitin 1945 dhe numërojnë sot 193 shtete anëtare.
- Kjo është arsyeja pse zionistët kërkonin dje, shtet për hebrenjtë dhe pse palestinezët kërkojnë shtet për veten e tyre, sot.
- Nacionalizmi u mundësoi vietnamezëve të mposhtin ushtrinë franceze dhe atë amerikane gjatë Luftës së Ftohtë. Kjo është arsyeja, pse kurdët e çeçenët ende kanë aspirata për shtetësi, pse skocezët po ushtrojnë presion për autonomi më të madhe brenda Mbretërisë së Bashkuar dhe pse, së fundmi, kemi një Republikë të Sudanit të Jugut.

Të kuptuarit e forcës së nacionalizmit ndihmon shumë për të sqaruar atë që po ndodh sot në Bashkimin Europian. Gjatë Luftës së Ftohtë, integrimi europian lulëzoi pasi u zhvillua brenda "*hapësirës*" së krijuar nga proteksionizmi amerikan. Gjithsesi, në ditët e sotme, kur SHBA-të po "*tërheqin*", në një farë mënyre, interesin e tyre për sigurinë europiane, vetë europianët nuk po shqetësohen e as nuk po përballen me ndonjë rrezik të madh që vjen nga jashtë, duke qenë se vetë projekti europian është zgjeruar dhe mbivlerësuar, duke krijuar një "*union monetary*", e thënë hapur - të kështilluar keq. Ajo që ne shohim sot, si pasojë, është një "*rinacionalizim gradual*" i politikës së jashtme evropiane, e cila "ushqehet" pjesërisht nga preferencat e papërshtatura ekonomike, si dhe nga rritja e frikës së "*identiteti lokal*" (d.m.th nacional).

Kështu, danezët shqetësohen për Islamin, katalanët kërkojnë autonomi, flamandët dhe valonët garojnë në Belgjikë, gjermanët hezitojnë, madje refuzojnë të ndihmojnë grekët dhe askush nuk *"jep dritë jeshile*" që Turqia të bëhet anëtare me të drejta të plota në BE, etj.

A nuk kemi të bëjmë me forcën apo fuqinë e nacionalizmit?

Fuqia e nacionalizmit është lehtësisht e miratueshme dhe e kuptueshme për ***realistët,*** siç pohon dhe bën të qartë edhe ***John Mearsheimer***. Kombet, duke operuar në një botë konkurruese, shpeshherë edhe të rrezikshme, kërkojnë të ruajnë vlerat e tyre të identitetit dhe ato kulturore. Në shumicën e rasteve, mënyra më e mirë për ta bërë këtë është që të kenë shtetin e tyre, pasi grupet etnike apo nacionale, që nuk arrijnë të kenë shtetin e tyre, janë me vulnerabël kundrejt pushtimit, absorbimit dhe asimilimit.

Në të njëjtën mënyrë, shtetet moderne kanë një stimul të fuqishëm për të nxitur unitetin kombëtar - me fjalë të tjera, për të nxitur nacionalizmin - sepse pasja e një popullsie besnike dhe të bashkuar, e gatshme të sakrifikojë (dhe në rastet ekstreme, të luftojë dhe vdesë) për shtetin, rrit fuqinë e tij, së bashku me aftësinë për të përballuar kërcënimet e jashtme.

Në hapësirën konkurruese të politikës ndërkombëtare, dihet se kombet stimulohen për të formuar shtetin e tyre, ndërsa shtetet kanë stimuj për të nxitur një identitet të përbashkët kombëtar ndër popullatat e tyre. Të marra së bashku, këto dinamika të dyfishta, krijojnë një trend afatgjatë në drejtimin e shteteve kombëtare, gjithnjë e më të pavarura.

Natyrisht, kombet dhe shtetet jo gjithmonë e arrijnë qëllimin e formimit të një "*shteti komb*" të unifikuar. Disa kombe nuk kanë sukses, asnjëherë, për sa i përket fitimit të pavarësisë, si dhe disa shtete nuk kanë sukses, asnjëherë, në krijimin e një identitetit të unifikuar kombëtar. Por, jo çdo grup kulturor ose etnik e konsideron veten si një komb apo aspiron pavarësinë (edhe pse asnjëherë nuk mund të jesh i sigurt për faktin se kur një grup mund të fillojë të pajiset me "*ndërgjegje kombëtare*" dhe të aspirojë për pavarësi). Megjithatë, shekulli i kaluar është karakterizuar nga një rritje e vazhdueshme e numrit të shteteve dhe nga shfaqja e lëvizjeve të fuqishme kombëtare në shumë prej tyre, si rrjedhojë, nuk shohim asnjë arsye që ky trend të ndryshoje në një të ardhme të afërt.

Nga çasti që themelohet një shtet komb, bashkë me të "lind" një fenomen vetë- përforcues. Shtetet kombe janë të vështira për t'u pushtuar, sepse popullsia, si rregull, do t'i rezistonte pushtimit të huaj dhe do të vazhdonte të luftojë kundër pushtuesit të huaj. Lëvizjet e suksesshme kombëtare kanë tendencë të imitohen, duke rritur në këtë mënyrë kërkesat për shtetformim. Me përjashtim të rasteve problematike (si dhe shembujve të dukshëm të shteteve të dështuara si Somalia, Jemeni ose Afganistani) shteti kombëtar i ka shanset të mbetet subjekti politik më i rëndësishëm në politikën botërore për një të ardhme, që mund të parashikohet. Identiteti kombëtar amerikan ka tendencën të theksojë dimensionin qytetar (të bazuar në principe të supozuara universale si liria individuale) dhe të minimizojë elementët historikë dhe kulturorë, ndonëse këto ekzistojnë. Për këtë arsye liderët amerikanë nënvleftësojnë rëndësinë e afërsive lokale dhe forcën e "besnikërive" kulturore, fisnore dhe territoriale.

Gjatë kohës së Luftës së Ftohtë, në mënyrë të vazhdueshme, u ekzagjerua forca e ideologjive mbikombëtare (*si në rastin e komunizmit*) dhe u minimizua masa, në të cilën identiteti kombëtar dhe interesat nacionale gjeneronin konflikte të mëdha në botën marksiste. Osama Bin Laden bëri të njëjtin gabim, kur mendoi se sulmet terroriste dhe mesazhet video do të mund të provokonin një lëvizje masive dhe formimin e një "*Kalifati Islamik*" mbikombëtar. Kushdo, që mendon se një Kinë, gjithmonë në rritje, do t'u nënshtrohet "*principeve amerikane dhe perëndimore*" për "*një rregull global të drejtë*" nuk vlerëson faktin, se *nacionalizmi është një pjesë thelbësore e botëkuptimit kinez*, për mendimin tim, *shumë më i rëndësishëm se idealet komuniste*.

Në qoftë se nuk vlerësojmë si duhet forcën e nacionalizmit, shumë gjëra që lidhen me realitetin politik modern, nuk do t'i kuptojmë si duhet. *Pra, është forca politike më e rëndësishme në Botë dhe, nëse do ta injorojmë, kjo forcë do të jetë thjesht në disfavorin tonë.*

Nacionalizmi nuk duhet parë aspak si një dukuri negative. *Të duash vendin tënd e gjuhën tënde, të vdesësh duke luftuar për atdheun tënd, të lartësosh historinë dhe identitetin tënd kombëtar, të respektosh popullin dhe trashëgiminë tënde kulturoro-artistike, të puthësh flamurin tënd kombëtar, të drithërohesh nën ritmin e himnit tënd kombëtar..., d.m.th nacionalizmi, në formën e patriotizmit jo vetëm që nuk është gjë e gabuar, por përbën "tharmin" e qëllimit të jetës njerëzore*. Nacionalizmi bëhet i dëmshëm, kur lidhet me forma e përmbajte të qëndrimeve politike, duke u kthyer në doktrina shoviniste politike në dëm të kombeve e vendeve të tjera, duke u shkaktuar këtyre të fundit kërcënime, dëmtime, vuajtje, gjenocide, luftëra e pushtime.

Nisur nga rasti i vendit tonë, mund të thuhet se veprimtaria e popullit tonë në shekuj, konfirmon, më së miri*, anët më pozitive të nacionalizmit*. Një popull që ka përjetuar dhjetëra luftëra e pushtime nga armiq të shumtë e të fuqishëm dhe ka mbijetuar në sajë të luftës për liri dhe pavarësi, një popull që, në asnjë rast të historisë, nuk ka sulmuar e nuk ka pushtuar asnjë popull e vend tjetër, madje ka kontribuar në çlirimin dhe lirinë e popujve të tjerë, në një kohë kur asnjë këmbë e ushtarëve të huaj nuk ka hyrë në territorin e shqiptarëve si "*çlirimtar*", përveç se, si "*pushtues*" është e vështirë ta akuzosh për nacionalizëm. Dëshmi të tilla e kanë dominuar bashkëjetesën e shqiptarëve me popujt e tjerë. Në "*shpërblim*", populli ynë ka pësuar humbjet më të mëdha në rajon, aq sa dënimet e historisë e ndane atë fillimisht në dy "gjysma". Më pas, njërën nga "gjysmat" e shpërndane në katër shtete të fqinjëve ballkanikë, gjendje që vazhdon dhe sot e kësaj dite dhe i fragmentarizon, dukshëm përpjekjet e popullit tonë për paqe, prosperitet dhe demokraci.

Shtrohet pyetja*: A është e drejtë çështja e bashkimit të shqiptarëve?*

"*Pse jo*" - do të përgjigjeshin me një pyetje shumica e njerëzve – "*kur janë bashkuar gjermanët, të cilët ishin "të penalizuar" me ndarje, nga një marrëveshje ndërkombëtare, legjitimuar në një Konferencë Paqeje për përgjakjet, që i shkaktuan Europës..?*"

Në përgjigje, kësaj pyetjeje do t'i shtohej dhe fakti i ekzistencës të një *parimi universal efektiv i së Drejtës Ndërkombëtare – Vetëvendosjes së Kombeve*, që për më se shtatëdhjetë vjet ka përcaktuar kufijtë e shteteve dhe ka "*bashkuar*" kombet në të gjithë botën moderne. Në një kohë kur shtete të tillë si Çekia dhe Sllovakia, "*bashkohen e ndahen*" sipas vullnetit e dëshirës së tyre.

E thënë shkurt, bashkimi i shqiptarëve nuk shkon ndesh dhe nuk dëmton interesat e asnjë populli tjetër, përkundrazi ndihmon në stabilitetin dhe prosperitetin jo vetëm të shqiptarëve, por të gjithë popujve ballkanas. Shqiptarët nuk kanë demonstruar në asnjë rast, tendenca ksenofobiste dhe shovene, aq më pak të kenë pasur doktrina nacionaliste, për t'i përdorur ato kundër popujve të tjerë fqinjë. Në të kundërtën, shqiptarët, më se njëherë, kanë qenë viktimë e doktrinave nacionaliste të fqinjëve të tyre agresivë. Në

(Vijon në faqen 14)

Shtetbërja është një ndjenjë e sinqertë dhe përkushtim atdhetar

Nga **XHAFER MARTINI**

Libri "12 prositë e Arbën Xhaferit" i Rudina Xhungës, me intervistat që ajo i ka marrë intelektualit erudit dhe politikanit Arbën Xhaferi në një hark kohor prej rreth tetë vjetësh, është me shumë vlera. Janë dymbëdhjetë intervista, e para më 2003-in dhe e fundit me 2011-ën. Titulli i librit është vënë, si duket, në bazë të numrit të intervistave. Por, për t'ia bërë lexuesit sa më të asimilueshme problemet që ngrihen, po ndjek rrugën e gjidhokjes së tyre në këto intervista, duke zgjedhur ato më të qenësishmet, mbasi një problem apo shqetësim kombëtar del në disa intervista.

1. Arbën Xhaferi bën dallimin midis Shqipërisë së Madhe dhe Shqipërisë Etnike. Këtë nuk e bën thjesht për erudicion, por për të riformatuar edhe një herë interesin kombëtar dhe për ta bërë më të prekshëm dhe më konkret bashkimin kombëtar. Me Shqipëri të Madhe Arbën Xhaferi kupton katër vilajtete shqiptare të bashkuara në një shtet të vetëm: vilajeti i Kosovës, Janinës, Shkodrës dhe Manastirit. Por Shqipëria Etnike me kuptimin që i japim ne sot këtij togfjalëshi, është më e rrudhur. Shqipëria Etnike që ne kërkojmë ta sendërtojmë është "ajo Shqipëri ku jetojnë shqiptarë dhe e ndjejnë veten shqiptarë dhe janë dominantë në këto rajone."(12 porositë e Arbën Xhaferit", f. 18) Po të shtyheshim më larg në kufijtë e Shqipërisë Etnike, do të shkonim edhe në rajone shqiptare ku sot ose nuk ka shqiptarë, ose numri i tyre është i papërfillshëm.

Shqipëria Etnike është krijuar më shumë nga të tjerët se sa nga ne shqiptarët, thotë Arbën Xhaferi me kuptimin se "Shqipërinë Etnike do ta krijojë dështimi i projekteve të kundërshtarëve tanë. Pra, çështja e Kosovës u hap kur dështoi çështja e Serbisë, pra e projektit të Serbisë së madhe. Ju e dini mirë ...se në asnjë institucion shqiptar as ushtarak, as politik, as shkencor nuk është hartuar projekti i krijimit të Shqipërisë Etnike, por Shqipëria Etnike vjen si pasojë e dështimit të projekteve joreale për Serbi të madhe apo për shtete etnocentrike siç synojnë të bëjë lidershipi aktual maqedonas."(At,f. 30)Ky është një mendim me vlerë jo vetëm pse thuhet për herë të parë, por shpjegon saktësisht faktin se përse sot shtrohet më me forcë se kurrë problemi i bashkimit kombëtar të shqiptarëve, pra, krijimi i Shqipërisë Etnike.

Gjithashtu me analizën e tij të thellë e të gjithanshme të këtij problemi, Arbën Xhaferi na bind se krijimi i Shqipërisë Etnike nuk krijon asnjë shqetësim në Ballkan dhe në asnjë vend tjetër, mbasi është problem me specifik të veçantë, i asaj natyre që merr zgjidhje përfundimtare. Arbën Xhaferi thotë se Shqipëria Etnike do të funksionojë. Bashkimi kombëtar i shqiptarëve, nuk do të shoqërohet me destabilizim të Ballkanit, siç mendohet, ose siç duan të thonë disa qarqe antishqiptare për të mbjell panik ndër ata që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e këtij problemi. "Shqipëria Etnike funksionon, - thotë A. Xhaferi, - meqë ndërtohet atje ku ka popullatë dominante shqiptare dhe kjo popullatë dëshiron të ketë komunikim dhe një interaksion të frytshëm me popullatën e ngjashme në Shqipëri apo në Kosovë. Po të bënim ndonjë sondazh sociologjik për disponimin e shqiptarëve do të shihej qartë se çfarë pëlqejnë ata. Ata nuk e bëjnë këtë për shkak të urrejtjes ndaj dikujt. Ne nuk kemi ide të mykura në kokën tonë që dëshirojmë të hapim ide shqetësuese siç është Shqipëria e Madhe apo Shqipëria Etnike, por këto ide shfaqen për shkak të ideve paraprake. Jugosllavia e parë dështoi për shkak se nuk arriti të ndërtojë kohezionin e brendshëm. Jugosllavia e dytë, e tretë, e katërt po ashtu dështuan për shkak se nuk arrihej kodi i kohezionit të brendshëm."(Aty, f. 60)

Kur Jugosllavia u shkatërrua, u hap çështja e vetëvendosjes së popujve që jetonin në të.Popujt e tjerë dolën me vete, me luftë dhe me sakrifica. Shqiptarët nuk vepruan në atë mënyrë. Ata nuk kërkuan Kosovën si shtet i pavarar. Shqiptarët e Kosovës kërkuan që të jenë njësi federative e ish-Jugosllavisë dhe të gëzonin të drejtën e vetëvendosjes. Serbët nuk e pranuan as këtë kërkesë minaimale të shqiptarëve. Kështu, me kërkesa minimale dolën edhe shqiptarët që jetojnë në ish-Republikën e Maqedonisë.Ata kërkuan të jetonin me maqedonasit si të barabartë, në një shoqëri ku respektohet diversiteti kulturor dhe etnik. As maqedonasit nuk e pranun këtë kërkesë minimale të shqiptarëve. Ç\duhet të bëjnë shqiptarët? Doemos se duhet të bëjnë bashkimin kombëtar, në bazë të Shqipërisë Etnike, dhe kjo gjë nuk ka pse të gjenerojë kriza në Ballkan, sepse shtetet e tjera të Ballkanit, që kanë po ato probleme që kishin jugosllavët, nuk janë shtete në krizë. Pra, nuk mund të pritet që të ngrihen turqit që jetojnë në Bullgari dhe ta destabilzojnë atë, as arvanitasit e Greqisë nuk do të ngrihen për të destabilizuar Greqinë, as hungarezët e Rumanisë nuk do ta destabilizojnë Rumaninë, sepse këto shtete që përmendëm nuk janë në krizë, nuk është aspak ajo situatë që ishte në ish-Jugosllavi.

2. Arbën Xhaferi jep kuptimin e vërtetë për nacionalizmin, duke e çdemnizuar atë edhe kur ky term përdoret nga shqiptarët dhe për shqiptarët. "Në Europë, - thotë A. Xhaferi, - kemi në 200 vjetët e fundit afirmimin e nacionalizmit, i cili fillon me revolucionin francez. Nacionalizmi ishte një fenomen shumë pozitiv meqë i afronte barazi të gjithë qytetarëve që në kohën e mbretërisë ishin pronë e mbretit. Ndërkohë, që me nacionalizëm u ofrua barazia, vëllazëria dhe liria për të gjithë pjesëtarët e shtetit."(Aty, f. 50) Arbën Xhaferi i di mirë parimet e demokracisë dhe aplikimin e tyre në praktikën e shteteve më demokratike të botës. Ai për këtë arsye nuk e kundërvë kombi tonë me ndërkombëtarët, me aletatët e vëretë të shqiptarëve. Por ai nuk ngurron të flasë për nacionalizmin, basi e di mirë se "Cilësia e Evropës është afirmimi i idesë kombëtare dhe jo shuarja e idesë kombëtare".(Aty, f. 51) Nacionalizmi është i shëndetshëm për çdo komb. Nacionalizmi është mobilizues për një komunitet apo qytetarët e një shteti, është ai nëpërmjet të cilit ruhet kohezioni i brendshëm i një shoqërie. Asnjë shoqëri nuk mund të funksionojë pa nacionalizëm. Jo rrallë gjatë intervistave të tij Arbën Xhaferi flet për dëshpërimin kolektiv , që është një sëmundje e rëndë për një shoqëri dhe për një komb, i cili ka humbur besimin në cilësitë e veta, në lidershipin e vet dhe nuk shikon asnjë breg se ku duhet të dalë. "Mungesa e nacionalizmit tek popujt krijon një dëshpërim nga krenaria e tyre, nga identiteti i tyre, pastaj vijnë forma të tjera të asmilimit dhe në fund dorëzimi. "(aty, f. 116)

Arbën Xhaferi flet për nacionalizmin si një fenomen që shëndetëson kombet, mbasi nacionalizmi shqiptar është i dobët, ndryshe nga ç'duhet të ishte, sidomos në rrethanat dhe kohën në të cilën jetojmë. Këtë e kanë vërejtur edhe të huajt, por sidomos mendimtarët tanë. "Në krejt Gadishullin e Ballkanit, në kohën kur shumica e vendeve u përfshinë në valët e egra nacionaliste, tek shqiptarët ndodh e kundërta. Kjo është një rënie në kurth nga më të pashpjegueshmet për një komb."(Kadare: "Kombi shqiptar në prag të mijëvjeçarit të tretë", Tiranë 1998, f. 24)

3. Një mësim të mirë jep Xhaferi për koalicionet, që ne nuk i kuptojmë mirë dhe, për më tepër, i zbatojmë keq, prandaj janë formale, jo efikase, pa rezultate. Arbën Xhaferi bën dallimin midis sistemit dhe koalicionit. Sistemi duhet të jetë demokratik, sepse prej tij burojnë edhe vlera të tjera demokratike, njera prej të cilave nuk është e domosdoshme të jetë koalicioni si praktikë qeverisëse. Në vendin tonë krijohen koalicione të gjera, edhe me parti që nuk kanë asnjë peshë në jetën e vendit, vetëm për të krijuar idenë se qeveris shumica, ose për ta pasur shumicën në parlament. "Format më efikase të ndërtimit të shtetit, - thotë Arbën Xhaferi, - janë fromat moniste. Nuk jam person që e adhuron komunizmin, por dëshiroj ta analizoj efikasitetin e shoqërive. Shtetet më të zhvilluara botërore, me demokraci të zhvilluar, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe, në esencë, janë shtete moniste për shkak se kur fiton Partia Demokratike, ajo nuk ka nevojë që të bëjë koalicion me parti të tjera se mund ta qeverisë vet shtetin, ose nëse fiton Partia Republikane është e vetme dhe vet i realizion vizionet që kanë prodhuar laboratoret partiake. Në Britaninë e Madhe nuk ka nevojë që partia kryesore të ketë 51 % të votave. Koalicionet e mëdha e shkatërrojnë në përgjithësi efikasitetin e një shteti për shkak se nga periudha e komunizmit kemi trashëguar doktrinën, çdo parti politike duhet të ketë një doktrinë. Ideologjizmat dhe doktrinalizmat në sens janë sisteme të mbyllura që nuk integrojnë në vetvete informacionet e reja, nuk janë të hapura dhe në përgjithësi ashtu si funksionojnë menjëherë, po ashtu stagnojnë si veten si shoqërinë."(Aty, f. 103)

Kjo gjë ndodh në vendin tonë. Për të qeverisur PD ose PS mbledhin rreth vetes sa më shumë parti të vogla, ndonëse ato kanë programe krejt të ndryshme nga njera-tjetra. Me shumë parti shpërndahet edhe përgjegjësia dhe copëzohet struktura e shtetit. Secili ministër përpiqet dhe arrin të fusë në punët më kyçe militantë e partisë së vetë. Derisa bën këtë punë, kalon një vit, pastaj, kur u kthehet punëve (nëse u kthehet) është fare vonë, se vjen koha për të dorëzuar mandatin. Kjo mënyrë veprimi ka sjellë që ne mos të kemi institucione të qëndrueshme, sepse i shkatërrojmë sa herë bëjmë zgjedhje, gati në çdo dy vjet. Me militantë nuk ndërtohen institucionet.

4. Mjaft mësime të vlefshme jep Arbën Xhaferi edhe për marrëdhëniet që duhet të kemi me ndërkombëtarët. Xhaferi është një lider i mençur dhe i arsyeshëm. Ai këto marrëdhënie i shikon jo për nga pikëpamja e përulsisë, servilizmit, frymës së më të voglit, ose për ruajtjen e pushetit personal. Ai i shikon për nga pikëpamja e vlerave që duam të përqafojmë. Nëse këto vlera janë evropiane perëndimore, amerikane, ai na këshillon që të mbajmë marrëdhnie të mira me ato shtete që përfaqësojnë këto vlera. Nëse këto vlera janë në një anë tjetër, të kthehemi andej nga janë vlerat që na interesojnë. Por shqiptarët e kanë bërë zgjedhjen e vet dhe jemi përcaktuar me kohë dhe drejt për nga vlerat auroatlantike dhe në shërbim të arritjeve të tyre. Kjo është rruga, autostrada nga e cila ne nuk duhet të lëvizim. Por që të kërkosh vlera, duhet të kesh vet një kod vlerash. Po këto vlera ne duhet t\i kemi për të kuptuar vlerat e të tjerëve dhe jo për t\iua imponuar vlerat tona atyre. Xhaferi me të drejtë kërkimin e vlerave e lidh me filozofinë e integrimit: "Nëse dëshirojmë që të integrohemi në Evropë, duhet t\i pranojmë standartet dhe vlerat evropiane. Integrimi nuk bëhet me imponimin të sistetmit të vlerave, por me pranimin e sistemit të vlerave ku synojmë të hyjmë." (Aty, f. 88) Por Perëndimi, thotë Xhaferi, jo vetëm dikton dhe sygjeron vlerat e veta, por edhe i pranon vlerat e tua, kur këto i bën të njohura, kur këto i dokumenton dhe i provon në mënyrë bindëse se janë të tuat. Ne qahemi se Evropa e krishterë nuk na do se jemi popull që në tre të katërtat jemi muslimanizar etj. Mirë kjo, mund të ketë një pjesë të së vërtetës, por ne çfarë bëjmë për t\i provuar botës dhe Evropës se ne kemi qenë popull tërësisht i krishter që, për rrethana që s\i kemi bërë kurrë sa duhet të njohura, u islamizuam. Ne, thotë, Arbën Xhaferi, të tulatur dhe të paditur, na kanë vënë para armiqtë tradicionalë, të cilët na kanë marrë jo vetëm territoret dhe popullsinë, por edhe kulturën dhe historinë. Ja si shprehet ai: "Shqiptarët për 17 shekuj kanë jetuar si të krishterë pra, prej shekullit të parë kur e kanë pranuar krishterizmin e deri në kohën kur ka filluar konvertimi apo apostazia e shqiptarëve në këto vise. Pra, shqiptarët kanë shkuar në ato kisha, sepse nuk kanë patur vend tjetër ku të shkojnë, ato kisha kanë qenë edhe të shqiptarëve. Por këtu qëndron një problem tek vet shqiptarët që nuk analizojmë në mënyrë të mirëfilltë traditën e tyre, historinë e tyre dhe bëjnë gabime trashanike duke ia lënë antiken grekëve, mesjetën sllavëve, periudhën osmane turqve dhe vet mbeten pa asnjë identifikim kulturor nga e kaluara. .. krishterizimi nuk ka qenë vlerë vetëm e sllavëve apo e grekëve, por ka qenë edhe e shqiptarëve. "(Aty, f. 53)

Po lidershipi shqiptar ka një sjellje pothuaj globaliste, të përgjithshme që është sjellja e moderuar edhe ndaj atyre që e meritojnë, edhe ndaj atyre që nuk e meritojnë, edhe ndaj atyre ndaj të cilëve kemi detyrime, edhe ndaj atyre të cilët na kanë



borxhe. Kështu, si shembull, ata sillen edhe me Maqedoninë njësoj si me vendet e Evropës. Këtë e bëjnë në emër të asaj se gjoja moderacioni çmohet nga Evropa. "Tirana zyrtare, do të thosha edhe Prishtina, e gjejnë të udhës që të sillen të moderuar karshi kërkesave shqiptare në Maqedoni. Prej aty vijnë sugjerime që të qetësohemi. Mirëpo faktori ndërkombëtar nuk e shpërblen siç duhet këtë pozicion të moderuar të Shqipërisë zyrtare apo të Kosovës.Shqiptarët në përgjithësi kanë dalë me kërkesa tej mase të moderuara dhe do të ishte shumë interesant që një institut shkencor në Kosovë apo në Shqipëri të bëhej krahasimi mes projektit serb për decentralizimin dhe kërkesave tona në Maqedoni dhe aty do të pasqyroheshin pozicionet. Kërkesat tona për decentralizimin janë të mbështetura në kartën evropiane për pushtetin lokal dhe nuk ka asgjë eksterme në të. Ndërkaq, në projektin serb kemi idenë e krijimit të kibucëve në terrenin e Kosovës, kemi idenë e krijimit të bastioneve serbe në Kosovë, kemi idenë e krijimit të pushtetit në dy nivele, ku komunat serbe formojnë regjionin, regioni ka edhe një krahinë autonome sipas koncepteve serbe kështu që pamundësohet çfarë funksionimi i shtetit kosovar në atë hapësirë. "(Aty, f. 87) Dhe më tej Xhaferi e thekson edhe më shumë përulësinë pa rezultat të shqiptarëve që nuk u përmbahen parimeve por lëshojnë pe aty ku nuk duhet lëshuar, duke përdhosur kështu programin politik dhe kontratën me votuesit: "Tendeca e vardisejs, tendenca e një servilizmi tipik të shqiptarëve mendoj se jep efekte të kundërta. Përfaqësuesit ndërkombëtarë i respektojnë më shumë ata politikanë që respektojnë vetveten dhe i mbështesin idetë me të cilat ata kanë lidhur kontratë me popullin."(Aty, f. 150) Në këtë kuadër Arbën Xhaferi vlerëson lëvizjen "Vetvemdosja" në Kosovë dhe liderin e saj Albin Kurtin, që e artikulon mllefin e popullatës kosovare në një kohë kur të tjerët e anashkalojnë. "Por unë, natyrisht, që nuk pajtohem me pozicionet e ashpra kundër faktorit ndërkombëtar për shkak se vetëm atë aleancë e kemi. Nëse e humbim atë aleancë, atëherë do të kemi telashe të mëdha."(Aty, f. 168) Çështja shqiptare është e pazgjidhur, thotë Arbën Xhaferi. Ne duhet të insistojmë në zgjidhjen e saj. Për këtë na duhet ndihma e faktorit ndërkombëtar. "Nuk mundet çështja shqiptare të zgjidhet jashtë kornizave të sistemit të vlerave perëndimore. Nëse shteti shqiptar, institucionet e shtetit shqiptar do të tregonin një agresivitet më të madh që do të binte ndesh me manitë e diplomacisë evropiane më shumë do të krijonte dëm sesa do të ndihmonte."(aty, f. 177)

5. Janë me shumë vend mësimet e Arbën Xhaferi edhe për luftën kundër korrupsionit. Ndër të gjithë ata që flasin ditë e natë, por që nuk i bien kurrë shenjës, Arbën Xhaferi e shikon filozofikisht këtë problem dhe arrin në përfundimin se korrupsioni nuk ekziston, në kuptimin që ai nuk ka qenësi, nuk është dukuri në vetvete, por është rrjedhojë, pasojë, shkak. Po të shprehemi me figurë, korrupsioni nuk është një mikrob, një bacil për të cilin duhet përdorur ky apo ai lloj ilaçi. Tellallët e retorikës bërtasin se korrupsioni është shoqërues i kapitalizmit, se ai ekziston kudo,

(Vijon në faqen 14)



Ismail Keta sjell eksperiencën gjermane në Tiranë

Kampioni i botës në Kick & Tai Box me origjinë nga Bulqiza pas themelimit të Akademisë "Deutschland Kick Box" në Mynih ka hapur dhe "binjaken" e saj në Tiranë, si një përpjekje për të nxitur përhapjen e sportit

Nga **ARBEN MUKA**

Ismail Keta, me llagapin sportiv Xhoni, është 35 vjeç dhe prej vitit 1998 zhvillon aktivitetin e tij në Gjermani. Nga dhjetori i vitit 2012 Ismaili është mbajtës i titullit kampion i botës në Kick & Tai Box, pas një ndeshjeje spektakolare në Dyseldorf, ku mposhti që në raundet e para me "knockout" boksierin holandez Remo Arnst. Prej disa muajsh tashmë jeta i Ismailit është ndarë mes Mynihut dhe Tiranës, ku kërkon të përcjellë tek më të rinjtë dhe të apasionuarit frymën e marrjes me sa më shumë me sport dhe angazhimet për rezultate të larta në rradhët e sportistëve profesionistë.

Ismail Keta është nga fshati Koçaj në Fushë-Bulqizë, në verilindje të Shqipërisë. Që në moshë të vogël ai ishte i dhënë pas sportit, duke u ushtruar në mënyrë sistematike me vrapime dhe shtangë. Në moshën 20 vjeçare ai emigron në Greqi dhe një vit më pas në 1998 mbërriti në Gjermani. Përballja për mbijetesë ishte me fat për Ismalin duke arritur të siguronte një punë pjatalarësi në restorant, por pa shumë fat në debutimin e ndeshjeve të para në Kick & Tai Box, ku humbjet ishin me "knockout". Si një njeri me karakter të fortë, ai i pa disfatat në ring me shkak tek vetja, një vetëreflektim që i shtoi orët e stërvitjes shumëplanëshe për të kapur treguesit jo vetëm të rezistencës, por dhe skemave taktike në përballjen me kundërshtarin.

TROFE KAMPIONI BRENDA DHE JASHTË GJERMANISË

Rezultatet erdhën shpejt. Nga viti 1999 Ismail Keta u shpall kampion i Gjermanisë për tre vite rresht. Me uniformën gjermane ai arriti në nivelin e nënkampionit të botës në Kick & Tai Box më 2002. Por ngarkesa e jashtëzakonshme dhe pasioni i zjarrtë për sportin marrin një kthesë të beftë tre vite më pas, kur Ismaili pëson një dëmtim serioz në gju, një ngjarje që ndryshon jo vetëm axhendën sportive të tij, por dhe vendbanimin, duke u vendosur në Mynih. "Trajtimi shëndetësor për dëmtimin në gju më tërhoqi përkohësisht nga konkurrenca në ring, por asesi nga planet e mia për sportin. Akademia"Deutschland Kick Box" në Mynih ka pasur dhe ka si synim kryesor përhapjen e Kick & Tai Box-it, por dhe nxitjen e të rinjve dhe të apasionuarve për të muarrë me sa më shumë sport" -thotë Ismaili.

Në Akademinë që ai drejton vijnë më shumë se 400 persona, të rinj, njerëz të zakonshëm, por dhe personalitete të jetës publike, të cilët gjejnë kushte gati laboratorike për nivele të ndryshme të ngarkesës dhe mundësisve që ka gjithësecili që afrohet aty. Mbajtja e lidhjeve të ngushta me vendlindjen e çoi Ismailin në një vendim të natyrshëm për të themeluar para disa muajve dhe "binjaken" e "Deutchland Kick Box" në Tiranë.

PËRVOJA E MYNIHUT NË TIRANË

"Ndjeheshim të paplotë deri sa hapëm filjalin e Tiranës. Sepse kemi pasur dhe kemi bindjen që edhe në Shqipëri ka të rinj dhe të apasionuar pas sportit. U duhen krijuar kushtet të gjithëve për të qenë të shëndetshëm, për të ecur në karrierën sportive. Eksperienca gjermane fare mirë po aplikohet dhe këtu në Shqipëri dhe për këtë jam tërësisht i bindur që do të kemi rezultate konkrete. Sportin unë e shoh si një mundësi për njerezit që të jenë me dinjitozë, më të shëndetshëm dhe më të fortë përballë çdo lloj fatkeqësie, sëmundje, rreziku të jetës etj."

Një prej "produkteve" konkrete sportive të Ismailit si trajner është i vëllai më i vogël, Gjetani, 30 vjeç, që mbështetësit në ring e thërrasin Majk Keta. Në vitin 2007 Gjetani ka fituar turneun e Kick Box-it në Tiranë. Pas titullit si kampion i Gjermanisë në këtë sport, ai kalon në ligën profesioniste të boksit ku bilanci i ndeshjeve është 15 fitore (14 me knockout) dhe 2 humbje.

Gazetari sportiv Dëfrim Methasani ka rreth dhjetë vite që ndjek nga afër aktivitetin e Ismail Ketës. Sipas tij, rasti i vëllezërve Keta, është modeli i sakrificave të jashtëzakonshme për sportin.

"Ata janë jo vetëm kampionë të sportit, por mbi të gjitha kampionë të vlerave njerëzore. Ismaili dhe Gjetani dinë të fitojnë një ndeshje, dinë të fitojnë trofe, por mbi të gjitha ata dine te sillen si qytetarë, si njerëz dhe si patriotë. Ndaj dhe janë të rrethuar nga miq të shumtë në Gjermani dhe Shqipëri. Kolegë të mi gjermanë më kanë përmendur shpesh vlerat që vëllezërit jashtë garave sportive. Kjo e shton popullaritetin e tyre në të dy vendet, si dy ambasadorë të sportit, kulturës dhe të integrimit europian."

Redaktoi: Auron Dodi
Marrë nga "Deutsche Welle"
(http://www.dw.de)



media

Dibra me sytë e fotografit britanik

Një set fotografik i publikuar në prestigjozen britanike "The Guardian" dokumenton jetën e varfër të banorëve të Dibrës, të ardhurat e të cilëve i kanë duke prodhuar vetëm djath, makarona, apo duke shitur gështjenja.

Në tetor të vitit 2012, fotografi David Levene, erdhi në Shqipëri për të parë por dhe dokumentuar aktivitetin e organizatës jo qevertare OXFAM në zhvillimin e zonave rurale në vendin tonë. Seti fotografik, i shoqëruar dhe me audio është publikuar nga "The Guardian" ku tregohet jeta mes varfërisë së banorëve në Dibër.

"Nuk e imagjinoja të ishte një vend aq i bukur."- thotë Levene në fillim të setit të tij fotografik. Levene udhëton në kohën e vjeljes së gështenjave dhe tregohet i mahnitur nga bukuritë natyrore, por shpreh dhe habinë me mënyrën e tregtimit të gështenjave. Ai tregon sesi kishte parë një njeri që kishte shkuar me furgon në atë zonë dhe i bleu fermerit gështenjat për t'i shitur në treg. "I gjithë transaksioni u bë në anë të rrugës.

Madje ai shton se një nga projektet që po punon OXFAM është që njerëzit të gjejnë një mënyrë të vjelin gështenjat pa i dëmtuar pemët.

Më pas tregon se kishte udhëtuar drejt Dibrës në veri të vendit, një ndër qytetet më të varfra. Aty takoi Lilianën dhe bashkëshortin e saj, të cilët drejtojnë një kooperativë (baxho të prodhimit të djathit të dhisë), i cili është karakterisitik për zonën pasi prodhohet nga qumështi i dhive që ushqehen lart në male.

Fotografi tregon se si Liljana i milte një nga një dhitë dhe më pas i dërgonte me kova drejt baxhos për të prodhuar djathin. Levende thotë se një sipërmarrje e tillë ka ndihmuar banorët për të rritur të ardhurat e tyre ekonomike.

Ai citon Bedrijen, një punonjëse të kësaj baxhoje, e cila thotë se të ardhurat ekonomike të saj janë rritur 50%, duke ndihmuar në përmirësimin e jetës, por dhe për të dërguar fëmijët në shkollë pasi më parë nuk kishte mundësi ekonomike ta bënte. Më pas ndalon në një punishte makaronash të etiketuara "Jufka", të cilat tashmë janë çertifikuar dhe janë mjaft të përhapura në tregun vendas.

David Levene punon si fotograf i "The Guardian" që prej vitit 2000 dhe punimet e tij publikohen në faqen online guardian.co.uk.

Fotot: David Levene ("The Guardian")
Teksti "Shqiptarja.com".(I redaktuar)













Rruga e Arbërit nr. 81

opinion

Nacionalizmi, si forcë e fuqishme politike dhe bashkimi i shqiptarëve

(Vijon nga faqja 10)

rastin e retorikës*"nacionaliste"* të kohëve të fundit, kemi të bëjmë *me një keqkuptim në kumtimet e shqiptarëve, në hapësirë dhe në kohë, për bashkim kombëtar,* nga njëra anë dhe të shfrytëzimit, të qëllimshëm, të momentit nga struktura të caktuara të disa prej fqinjëve tanë, nga ana tjetër, më së tepërmi, për ta përdorur këtë keqkuptim për "*konsum të brendshëm*" në vendet e tyre.

Sigurisht, kërkesa për një bashkim kombëtar të shqiptarëve, e "*aktualizuar*" në sfondin e 100 Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë të Shqipërisë etnike është një e drejtë legjitime. Madje, pa hezitim dhe pa as më të voglin "kompleks profesional", do të thosha se pa një bashkim kombëtar shqiptarët do ta kenë tepër të vështirë, për të mos thënë të pamundur, të arrijnë zhvillimin ekonomik, kulturor dhe politik modern, pra, të arrijnë shkallën e prosperitetit dhe të nivelit të demokracisë të vëllezërve të Europës, në lëvizjen drejt tyre, përgjatë "*pistës*" së Brukselit. Një bashkim i shqiptarëve *jo vetëm si bashkim numrash, por në radhë të parë, si bashkim vlerash, si bashkim idesh, tregjesh, kulturash, sinergjish dhe hapësirash, do ta rendiste shtetin e shqiptarëve në një shtet europian të barabartë me të gjithë shtetet e tjerë të rajonit, për nga fuqia dhe për nga parametrat, pak a shumë të përafërta, të kritereve gjeopolitike të forcës në Ballkan*.

Pra, çështja e bashkimit të shqiptarëve përbën jo vetëm një të drejtë themelore të popujve, por është një proces që në mënyrë normale mund dhe do të bëhet "*në shtratin*" e vlerave të sotme demokratike europiane dhe të integrimit euroatlantik të shqiptarëve. Në këtë "*linjë*" është fakt sot se janë shënuar hapa të mëdhenj, të paimagjinueshëm më parë, në afrimin midis shqiptarëve dhe për rrafshimin e "ndryshimeve" formale, "të prodhuara" nga të jetuarit për një kohë tepër të gjatë, *detyrueshëm*, të ndarë. Aq sa mund të thuhet se procesi i bashkimit midis qytetarëve shqiptarë, *si shumatrore vlerash demokratike* këtej dhe matanë "*kufirit londinez*", në realitet është kryer. *Për të kaluar nëpër një derë të hapur, mendoj se nuk është e nevojshme që, duke kaluar, të thyesh derën... .*

Duke përfaqësuar një proces legjitim, të nevojshëm dhe të pakthyeshëm, mendoj se do të përbënte *një nonsens*, "arsyetimi", sipas të cilit, me integrimin euroatlantik të shqiptarëve komuniteti ndërkombëtar do të "konstituonte" tre shtete shqiptare të ndara, si anëtare të ardhshme të Bashkimit Europian.

Lidhurmekeqkuptimin, *nëkohë dhe në hapësirë*, për deklarimet e kohëve të fundit për çështjen e bashkimit të shqiptarëve, mendoj se praktika ndërkombëtare lidhur me zgjidhjen e problemeve të tilla delikate, pa përballuar "kosto të panevojshme" dhe pa krijuar shqetësime për të tjerët "sugjeron" disa "rregulla" të rëndësishme dhe logjike:

Së pari, bashkimi kombëtar ***nuk deklarohet, por bëhet me punë e vepra konkrete***, në përputhje me kushtet konkrete gjeopolitike. Si njohës i problemit gjerman dhe nga praktika ime e punës, si diplomat në "terrenin" gjerman, konfirmoj se për pesëdhjetë vjet radhazi, asnjëherë dhe nga askush nuk u bënë deklarime për bashkimin gjerman. Madje, të flisje, "*out off the recorder*"[1] për një temë të tille, ishte jo vetëm i pabesueshëm, por të vihej menjëherë në dyshim "statusi" mendor e psikik. Por kjo nuk do të thoshte se "*underground*"[2] gjermanët nuk punonin për bashkimin e tyre kombëtar. Pritën "kohën" dhe e bënë realitet me punë e vepra, unifikimin e tyre....

Së dyti, bashkimi kombëtar ***nuk bëhet "nga lart", por "nga poshtë"***. Shembull tipik për këtë janë përpjekjet për krijimin e Bashkimit Europian. Ideja për një Europë të Bashkuar ka qenë e vjetër, ashtu si dhe iniciativat për realizimin e saj. Po përmend tri nga përpjekjet më të thekshme. Përpjekja e parë për bashkimin e Europës nëpërmjet "*Koncertit të Europës*", ndonëse dha shenja të qarta premtuese, nuk arriti ta bënte bashkimin europian, me anën e një sistemi ndërkombëtar. Përpjekja e dytë u bazua në kontributin e mendimtarëve dhe të ideologëve më të shquar europianë të kohës me në krye *Kalergin*, por, përsëri nuk pati sukses. Përpjekja e tretë, siç dihet, u bë nga Hitleri me "*Raihun e tretë*", nëpërmjet luftës dhe "*lebens raum*"[3], që pati një "kosto" tepër tragjike për njerëzimin.

Të tria këto përpjekje dështuan, sepse ishin veprime të imponuara *"nga lart"*. Europa u bashkua atëherë kur u bashkua "*hekuri me qymyrin",* kur u arrit bashkëpunimi ekonomik, kur "u rrit" mirëqenia dhe demokracia, si "*emërues të përbashkët*", të këtij bashkimi "*nga poshtë*".

Së fundi, nuk mund të këtë bashkim kombëtar të shqiptarëve ***pa një shkallë të lartë të zhvillimit të tyre politik, ekonomik, kulturor, arsimor, si dhe të nivelit të demokracisë dhe të qytetarisë, "në kuotat" dhe në nivelin e duhur të demokracisë europiane.*** Ky zhvillim bëhet jo me deklarata (*nga lart*), por me punë *(nga poshtë*) dhe varet vetëm nga ne, nga përpjekjet tona, nga përkushtimi ynë për qytetarët dhe vendin. Askush nuk na e ndalon një gjë të tillë, përkundrazi na ndihmojnë, madje na "*kërkojnë llogari*" për t'i plotësuar sa më parë këto standarde europiane të domosdoshme. Si për prosperitetin për demokratizimin e shqiptarëve, ashtu dhe për bashkimin e tyre nuk na "*penalizon*" askush. Mjafton të kemi vullnet dhe t'i arrijmë këto synime me punë, me vepra e me përkushtim.

Prof. Dr. Bashkim Rama

(Kjo pjesë është marrë nga libri "Ballkani dhe rënia e Murit të Berlinit", i cili është në proces botimi)

1. (angl,) - në konfidencë.
2. (angl.) - "nen dhe ..."
3. (gjerm.) - "hapësirë jetike".

Shtetbërja është një ndjenjë e sinqertë dhe përkushtim atdhetar

(Vijon nga faqja 11)

edhe në vendet më të zhvilluara etj., etj. "Korrupsioni, - thotë Arbën Xhaferi, - nuk është entitet më vete, nuk është një substancë e mëvetësishme, por pasojë e mosfunksionimit të shtetit. Nëse funksionon shteti mbi bazat e ligjit me automatizëm, eleminohet korrupsioni. Pra, siç thashë, korrupsioni nuk është një fenomen më vete që ka një zhvillim paralel, por vetëm nëse nuk funksionon shteti mbi baza të ligjit..."(Aty, f. 189) Dhe dihet që në Shqipëri ligji funksionon me dobësi të theksuara. Sistemi i drejtësisë është nga më të dobëtit, madje nuk mund të thuhet se ka ndonjë sistem drejtësie përderisa ai nuk funksionon si i tillë. Korrupsioni e la mbrapa Shqipërinë, e la një vend të pazhvilluar, ku populli ende jeton në varfëri. Vetëm një Shqipëri e pasur është e fortë, ajo mund të bëhet piemonti për shumë probleme në lidhje me shqiptarët e tjerë jashtë Shqipërisë, pse jo, edhe i bashkimit kombëtar. Shqipërisë i ka falë Zoti shumë të mira e begati, siç thoshte Pashko Vasa, ka një vijë bregdetare të gjatë dhe të bukur, një popullsi të re dhe pothuaj të shpëndarë në tërë vendin, ka një klimë të favorshme dhe shumë gjëra të tjera që bota na i ka zili.

Xhaferi thotë se në Shqipëri është krijuar një klimë e favorshme për zhvillimin e korrupsionit. Në Shqipëri zotëron mashtrimi dhe jo sinqeriteti për ta bërë Shqipërinë të bukur dhe të betgashme. Politikanët akuzojnë njeri-tjetrin për korrupsion të nivelit të lartë që shkon në miliona euro. Por drejtësia nuk vepron mbi asnjerin, as kur janë në pushtet, as kur zbresin nga pushteti. Politikanët që janë sharë dhe nemur me njeri-tjerin, që kanë akuzuar njeri-tjetrin për korrupsion marramendës, neser mund të jenë në një qeveri, përkrah njeri tjetrit, por me një ndryshim: tani nuk do të merren me njeri-tjetrin. Të tjerët do të merren me ta. Në Shqipëri sa të zbresësh nga pushteti, nuk merret më njeri me ty, edhe nëse je akuzuar me qindra herë dhe për miliona euro për shpërdorim pushteti. Shtetbërja, thotë Arbën Xhaferi, kërkon drejtësi, sinqeritet dhe përkushtim atdhetar.

Një e metë tjetër e politikanëve shqiptarë, thotë Arbën Xhaferi, është mllefi për njeri-tjetrin, është helmi i zi që u është mbledhur në shpirt, dhe e derdhin nëpër foltore nga duhet të burojë fjala e mençur dhe jo helmi i marrëzisë. Grindjet e kacafytjet nuk kanë të bëjnë me debatin. Arbën Xhaferi thotë se me xhindosje politikanët shqiptarë fshehin mungesën e ideve, vizioneve, rrugëve që duhen shkelur për ta nxjerrë vendin nga prapambetja. Ata në atë mënyrë mashtrojnë elektoratin. Atyre u duhet mungesa e standarteve dhe jo standartet evropiane, kjo edhe për mënyrën e sjelljes ndaj njeri-tjetrit. "Mendoj se është një zëvendësim për mungesën e ofertës reale politike, është një mungesë e projekteve të vërteta për rimëkëmbje ekonomike, shpirtërore të Shqipërisë, dhe, meqë duhet të futen në zgjedhje, atëherë potencohen mangësitë e sajuara artificialisht të kundërshtarëve. Në këtë mënyrë ata mendojnë se do të grumbullohen votat në një krah, ndërkaq krahu tjetër do t\i humbë zgjedhjet."(Ay, f. 184) Zgjedhjet në Shqipëri kanë qenë përherë të kontestuara. Xhaferi shikon një anë tjetër të këtyre zgjedhjeve: ato janë formale, pavarësisht se kush i fiton, pavarësisht se kush i humb. Humbëse është Shqipëria dhe shqiptarët, se zgjedhjet në këtë vend nuk shoqërohen me zgjidhje. "Mendoj se në këtë mënyrë, - shpjegon Xhaferi, - nuk fitohen zgjedhjet por fitohet vetëm një mandat për të vazhduar më shumë me këtë lloj satanizimi të njeri-tjetrit."(Aty, f. 184)

6. Në këtë libër duket kultura e gjerë jo vetëm filozofike, por edhe fetare e Arbën Xhaferit, i cili hyn thellë në fenomenet që vishen e amalgohen me lloj-lloj petkash dhe mënyrash për të mos u dukur nën dritën e së vërtetës. Këto mendime ai i jep nën titulln "Konferenca Islamike dhe Shqipëria". Pyetjes se a është Shqipëria një shtet islamik, pyetje ku kanë ngatërruar këmbët të gjithë ata që kanë marrë pjesë në debate të kësaj natyre, Arbën Xhaferi i përgjigjet thjesht, me argumente që ta mbushin mendjen dhe nuk lënë shteg për llafollogji të kota. Sipas tij "Shtet islamik do të thotë një shtet që punon sipas mësimeve Kuranore, sipas premisave që burojnë nga Kurani"(Aty, f. 154) Pra, Shqipëria nuk është shtet islamik. Ai që thotë të kundërtën, ose është injorant, ose do ta futë lëmshin në zabel me qëllime të caktuara. Për tolerancën fetare ai ka mendimin se nuk është e plotë, absolutizohet kot plotësia e saj për arsye se plotësia nuk kërkohet në drejtimin e duhur. Për të pasur tolerancë fetare, thotë Xhaferi, duhet të kemi tolerancë ndaj paragjykimeve, ndaj steriotipeve, ndaj keqkuptimeve. Autori bën mirë dallimin midis kodit të shqiptarëve dhe kodeve fetare, për secilën fe. Kodi shqiptar është i gjerë, human. "Në kodin shqiptar ka vend edhe për të krishterë, edhe myslimanët, edhe për agnostikët, edhe për të tjerët."(f. 154) Kjo që thotë Arbën Xhaferi është shumë e vërtetë. Me kodin shqiptar, në radhë të parë, sipas meje duhet kuptuar Kanuni. Në Kanunin e Dibrës me të cilin jam marrë shumë vjet, jo se nuk përfillet feja, por nuk përfshihet, sepse Kanuni është, si të thuash shtëpia e të gjithëve, i pranon të gjithë, pavarasisht nga bindjet fetare që kanë. As nuk favorizon njeri për shkak të besimit fetar, por as nuk persekuton njeri për shkak të fesë. Kurse "në kodet fetare nuk ka vend për të gjithë këto, në kodin e krishter nuk ka vend për myslimanët dhe anasjelltas. Prandaj, detyra parësore e çdo veprimi publik, është të kultivojmë kodin kombëtar. Brenda këtij kodi ka hapësirë për të gjithë.(Aty, f. 154). Vetëm në këtë kuptim Pashko Vasa ka thënë se Feja e shqiptarëve është Shqiptaria. Duhet forcuar dhe kultivuar Kodi i Vlerave të Shqiptarëve. Brenda këtij, si vlera më vete, janë edhe islamizmi e krishtërimi. Pra, parë nga ky kënd shikimi (që është i vetmi nga duhet parë), të dyja fetë i shërbejnë shqiptarizmit, hyjnë të dyja tek Kodi i Vlerave Shqiptare.

Të keqen e fesë, të çdo feje, Arbën Xhaferi e shikon tek fati se ato instrumentalizohen nga politika, përdoren prej saj. Rreziku prej Islamizmit ose prej çdo feje tjetër është absolutisht i shpikur nga politika dhe në shërbim të saj për të kryer veprime apo për të mbajtur qëndrime që janë të natyrës politike. Tezat për rrezikun e fesë islame ashtu edhe të çdo feje tjetër janë sa të pavërteta aq edhe qesharake. Në mbështetje të këtij mendimi, Arbën Xhaferi, thotë: "Do t\ju jap një fakt interesant. Gjatë periudhës së sundimit jugosllav në hapësirat shqiptare nuk ka patur asnjë rast të persekutimit të dikujt për shkak të bindjeve fetare, por ka patur persekutime për shkak të bindjeve kombëtare.Të gjithë shqiptarët që kanë kaluar nëpër kazamatet e Jugosllavisë, kanë kaluar për shkak të bindjeve të tyre kombëtare."(aty, f. 157)

Arbën Xhaferi e ndan shumë qartë interesin kombëtar nga interesi fetar. Ato j vetëm nuk janë e njejta gjë, por as që nuk rrezikohen njëlloj. "Interesi fetar, - thotë Arbën Xhaferi, - në asnjë zonë ku jetojnë shqiptarët nuk është i rrezikuar, por në të gjitha vendet është i rrezikuar interesi kombëtar"(Aty, 156)

Feja është një vlerë e njeriut dhe nuk ka pse ajo të pengojë vlerat e tjera. Ne, shqiptarëve, nuk na ka penguar fakti që tre të katërtat e popullsisë i kemi të myslimanizuar. As femohuesit, marksistët, as ideologët e fesë islame, janë të prirur drejt pernëdimit jo për arsye fetare, por për shkak të vlerave që ekzistojnë atje. A. Xhaferi thotë se marksistët-leninistët e Jugosllavisë "Asnjëri prej tyre nuk shkoi në Kinë apo në Rusi, por të gjithë shkuan në Perëndim. Po kështu nga këta ideologë fetarë të gjithë shkuan në perëndim. Khomeini kërkoi azil në Francë, nuk kërkoi në Arabinë Saudite. Kjo flet për kontesktin shoqëror ku ekziston vlera e njeriut, ku këto vlera janë avancuar më shumë, dhe nga ky fakt nuk duhet të bëjmë konfuzion, në këtë fakt nuk ka polarizim fetare, por është çështja e avancimit të të drejtave të njeriut dhe krijimi i një sistemi politik mbi të drejtën e lirisë së fjalës dhe lirisë së njeriut."(aty, f. 160)

Luftën fetare, shpjegon Arbën Xhaferi, e ndezin dhe përskeqin injoranët që më së paku jo vetëm që nuk kanë kulturë fetare, por nuk janë as besimtarë të vërtetë të asnjerës fe. Këta lloj njerëzish, të secilës fe, duke vendosur simbole të fesë së vet për t\i bërë karshillëk fesë tjetër, tregojnë injorancë të plotë. Me veprimet që kryejnë ata nuk kanë hallin të madhërojnë Zotin, por të madhërojnë veten. "Pra, ekziston një sens i vanitetit të dikujt që vendos një simbol religjoz në një breg apo bregun tjetër. Me atë ai tenton të madhërojë veten por jo Zotin. ... Nëse analizojmë mirëfilli fenomenin e Zotit, Ai është absolut dhe nuk ka nevojë të mbrohet nga askush, meqë janë qesharake ato teza që parashikojnë rrezikun e islamit apo fesë tjetër."(f. 155)

Këto ishin disa probleme, çështje, porosi apo quaji si të duash që zgjodhëm në një mori të madhe prej tyre, për t'ua paraqitur lexuesve. Janë probleme që ngrihen nga një burrë shqiptar, i urtë dhe i mençur, pa mllefe dhe inate, pa sedër të sëmurë, me një dashuri të sinqertë për atdheun e përbashkët. Vdekja e parakohshme nuk e la të shpaloste tërë vlerat dhe mendjemprehtësinë që kishte. Edhe sa ishte gjallë, atë e mundoi sëmundja, megjithatë la plot gjëra të mrekullueshme që duhen studiuar dhe prej tyre duhet të nxjerrë mësime tërë klasa politike shqiptare. Rudina Xhunga në punën e saj si gazetare është fokusuar dhe pothuaj është profilizuar në trajtimin e problemeve mbarëkombëtare. Ajo e ka bërë shpesh rrugën Tiranë-Prishtinë-Shkup. Por rrugën mund ta bësh, e rezultate mund të mos kesh. Merita e Rudina Xhungës qëndron në faktin se ajo i ka zgjedhur problemet që ka trajtuar dhe ka zgjedhur njerëzit për t'i intervistuar, duke mos ia krijuar mundësinë çdo sharlatani dhe injoranti. Një prej këtyre njerëzve që më shumë se askush e kishte hak ekranin e televizionit ishte Arbën Xhaferi. Ne kemi nevojë për mendimin e tij.

Xhafer Martini

folklor

Kënge e Luftës së Lumës në Qafë të Kolesjanit

Variante dhe gjeografia e këngës "Luma e serbi po luftojnë". Vështrim estetik

Nga **Dr. FEJZULLA GJABRI**

HYRJE

Kur je i gëzuar mos bërtit shumë se hidhërimi e ka gjumin e lehtë! Kështu thotë një fjalë e urtë popullore. Serbi mundi të marshojë me gëzim deri në Lumë, por 'i hasi sharra në gozhdë'.

U mbushën 100 vjet nga Beteja e Qafës së Kolesjanit, e cila u kulmua në truallin Nangë-Bicaj-Kolesjan. Pas lufte, jeta vazhdon. Prap bëhet dasëm, prap këndohet, edhe prap thurën këngë e rrefime për ngjarjen. Për betejen në Qafë të Kolesjanit, u thurën këngë epe për betejën, u kalua deri në lirizëm në këto krijime, duke shpalosur talentin më furishëm se përpara, në kufiije e jo vetëm në Lumë po gjithandej. Me këto këngë, me këto rrëfime, u pasurua kultura jonë popullore artistike, siç është folklori.

Duke qëndruar te kënga, konstatojmë se brenda Lumës ka disa variante që nga Vermica e deri në Veleshicë, që nga Drini i Zi e deri në malet e Sharrit. Variantet nuk mungojnë në Dibër, Kosovë, Has, Malësi e Madhe, Pukë, Mirditë, Mat e më tej. Përgjithësisht nuk mungojnë 4 vargje, gati si të Eposit të Kreshnikëve: "Sheja e Vogël kullon gjak,/ po i thotë Drinit:- Nihmom pak" dhe "Kllade t'mdhoja jam te çue,/ N'Shkodër t'Vogël me i kalue".

Krijimtaria folklorike ekziston nëpërmes variantesh e variante nga më të ndryshmet u krijuan për Betejën e Qafës së Kolesjanit.

Në viset e Lumës

Në Kolesjan i këndojnë Islam Spahisë: "Islam Spahia burrë i thajm,/ me Serbien tajm e n'tajm,/ Tajm e n'tajm mu te kulla,/ E mtoj Serbia se paska burra. / .../ "

Duke u ngjitur më lart, në Lusën, gjejmë vargjet: "Huxhum Lusna e Ramadani (Çajku), / Bini gjem se shkoi vatani,/Ç'ka me ba Ramadani i zi,/Te luftu me di krajli,/Karadak e me Serbi. /.../," (Lusën).

Një këngë radomirase (Kala e Dodës) ngre lart figurën e Ibrahim Haxhi Zeqirit: "Radomira me bajrak,/S'nalet sërpi jo pa gjak,/.... /Brahim Haxhi Zeqiri me pushkë e kollan, / Merr avdes e del n'mejdan,/ Jo për nesër, po sot ban bam. /.../. " (Radomirë)

Një këngë e Rrafshes së Lumës jep ankimet e armikut, të kreut të tij: "Qysh se u nisa nga Beligradi,/Nuk kam pa ksi mahlukati,/.... / Nuk ka udhë e nuk ka shtek,/Ven për ven pushka kërset. /Tan serbia ktu me ardhë,/Sall te nja s'pështon i gjallë. "

Në Bushtricë kënga veçon organizatorë, vlerëson shehitë, ngjall vrull: "Qazim Lika e Bajraktari,/Qazim Lik'e e Bera Gjana,/Rrallë ksi trimash i ban nana,/.../

Në Bicaj: "Pak pa plasë boumes ia ngjiti, /Stojniçit ia kthej opet,/ e la dekun me gjyle t'vet...". Është fjala për Nexhip Dullën në Kolesjan.

Një këngë e këtyre kohëve tregon për lidhje me Hasan Prishtinën e në ndihmë të tij të dyqind djemëve lumjanë: "N'kullë të Lumës janë bashkue,/Dyqind gjem kanë bisedue,/Sulë Elezi foli ni fjalë:/-Kush asht burrë e kush asht gjalë,/ Hasan Prishtinës zot me i dalë,.../

Në Kalis ndihma e Elez Isufit dhe e Baftjar Dodës vlerësohen në këngë, si organizatorë e si luftëtarë. Duke përmendur topat, duket sikur rritet vlera e ndihmës: "N'Kolesjan kallet baroti,/Ndihmë po vjen Elez Isufi. / Vjen Elezi me di topa,/ ki Sen Daci i komandoka. "

Këngë me ketë tëmë gjen për çdo fshat. Ka Bardhoci, Shtiqni, Pobregu, Ujmishti, Surroi, Mamëzi, etj.

Deri këtu u cekën vargje të këngës brenda Lumës. Dihet se ushtima e kësaj beteje i kalon caçet lokale. Me këtë lëndë, me lëndën e Betejës Lumës, janë thurur variante nga dibranët, gjakovarët, mirditorët, në mbarë Kosovën etj. Këngët e cituara janë në funksion të indentitetit, që folklori e ka detyrë parësore të japë këngë për bëma të tilla, po gjithnjë sipas ligjeve të veta.

Në Dibër këndohet: "N'at Stamoll këndon gazeta,/Mjer'dovleti për ilçe t'veta,/.... /N'Prizren po ban kuven,/I thotë Lumës:-Lirom ven,/Lirom ven, lirom vatan,/Të piqëmi n'Kolesjan".

Në fshatin Grevë të Dibrës një variant i kësaj kënge, shton shehitët e Betejes së Lumës me Has Fidën e Xhemali Ramën, që vihen në krah të Islam Spahisë: "-Ku i ka shokët Islam Spahia,/N'at Gjalicë e nër frengjia,/Nër fregjia tuj çënrue,/Hikën sërpi, majtet n'prrue. /.../ Çaj Has Fida n'tum'të ferrës,/Sa ma shpejt i jep manzerres,/.../Kur bërtajti Xheladin Rama,/ N'Stamoll i ka shkue xhama. " .

Në Shupenzë të Dibrës, një variant përmend emrat e luftëtarëve Ramadan Selmani e Hoxhë Mehmeti, duke marrë thelbin e këngës "Luma e serbi po luftojnë", thuhet: ".... ,/Kur fikati Ramadan Selmani,/Bini, voca, se shkoi vatani,/ Kur fikati Hoxhë Mehmeti,/Ka krisë pushka, gjimoi kepi. /.../.

Në Kosovë: "Ça kan' kodrat qi gjimojnë?/Has e Lumë, medet po luftojnë,/N'at Serbi shumë vajtojnë,/.../Shum' askeri ma myt n'Dri,/Shumë milet m'ka metë n'Shqipni,/Me tefter dymdhet mijë!" .

Në Mirditë kënga përmend Reç e Dardhë që: "...,/Luftojnë trimat malsisë,/Për të drejtat e Shqipnisë. /Prej Reçi e n'Kolesjan,/Për liri e për vatan,/.../".

Këngën nuk ta jep lehtë populli, por beteja e Lumës ishte aq e madhe, sa u ndie në gjitha viset shqipatare. Grimcat e shënuara janë vetëm ilustim i një qëndrese, ndoshta pas gjëmës së madhe të masakrave serbe, ndoshta si kundëpeshë e dhimbjes së madhe. Dhimbja e parë është humbja e luftëtarëve e drejtuesëve popullorë në ketë luftë, të cilët nuk janë pak. Ne jemi mësuar vetëm të dëgjojmë humbjen e 12 mijëve të serbit, po, me që kënga i ka përjetësuar njerëzit tanë, duket si lehtësim i dhimbjes për ta. Ata janë shumë dhe evidencimi është detyrë e shenjë qytetërimi

PERSONAZHE TË KËNGËS

Kënga bazë, siç mund ta quajmë atë të krijuar e kënduar afër një shekull në Lumë, ka më tepër se të gjitha variantet, heronj që veprojnë e nxisin luftën. . Veç Islam Spahisë, dy Ramadanëve, bajraktarëve e luftëtarëve, dalin nëpër këngë emra të tillë si: Elez Isufi, Hoxhë Bicani, Ali Bakalli, Idriz Bajraktari, Haxhi Zeqiri, Hoxhë Mehmeti, Bajram Gjana, Has Fida, Sen Daci, Baftjar Doda, Sulë Elezi, Dullë Visha, Abdy Myta Topojani, Idriz Bajraktari, Jemin Alia, etj, të gjithë kundërshtarë të Krajl Nikollës e Petro Krajlit.

MESAZHI REFERENCIAL DHE ESTETIK

Vlerat e këngës së 1912-ës, shtron çeshtjen e sakrificës në altarin e atdheut, si kërkesë e shejtë e legjitime. Në variantet e këngëve të kësaj kohe, nuk mbetet pa treguar atë pak gëzim të ngritjes së Flamurit. Një këngë nga Morini, thotë: "N'Kullë të Lumës janë bashkue, / Dyqin djem kanë bisedue,/Sulë Elezi foli ni fjalë,/ Kush asht burrë e kush asht gjalë,/ Hasan Prishtinës zot me i dalë". Brenda trevës së Lumës, çështja e flamurit ishte vetë lufta kundër pushtuesit. Haberet nga Vlora nxjerrin urimin: "/.../Tungjatjeta, Smail, qysh thue,/Për flamur n'kam jem çue,/.../" .

Siç kuptohet edhe nga këto vargje, lufta bëhet për flamur. Duket si një mesazh i dyzuar. Së pari urimi për Flamurin Kombëtar, për Pavarësinë dhe së dyti 'edhe Luma lufton për ketë Flamur, për ketë Pavarësi.

Nga ky qëllim buron edhe mesazhi optimist i këngës, si në Epos. Mesazhi i poetit popullor është mesazh i krijuesit artistik, të frymëzuar nga përjetimet vetjake, nga kontaktet me thellësitë e shpirtit njerëzor që do lirinë. Ky mesazh optimist vjen si një ndjenjë që përftohet nga skajshmëritë e dhimbjes dhe të krenarisë, të arsyes dhe të instinktit shtazarak, të qytetërimit dhe të primitivizmit. Dhimbje për të rënët, qytetërim dhe nga pala pushtuese instinkt shtazarak dhe primitivizëm. Ketë thotë kënga.

Variantet e shumta të këngës kanë hërë-herë trajtën tregimtare, të gërshetuar me dialogje të shkurtëra, që mundëson përcjelljen e një informacioni të gjerë luftarak me një dendësi të thellë mendësish kontradiktore, deri në grotesk. "Sheja kullon gjak". Një piktor do të frymëzohej nga ky varg, për të dhënë një tabllo në kontrast ngjyrat natyrore të peizazhit në orë të ndryshme të ditës apo të natës, të ngjeshur me ngjyrën e kuqe të gjakut, që kullon nga kokat e prepra dhe nga baruti i djegur, përzier me kundërmim kufomash kundërshtare. Do ishte një pikturë groteske. Kjo se betejave u paraprijnë kuvendet e trimave, debatet e diplomatëve dhe nga njëra anë dhe nga ana tjetër prapaskenat e krajlëve, të shfaqura si qenie mitologjike, që për nga veprimet dhe gjykimet, pak u ngjajnë njerëzve. Në art ky është grotesku.

Kënga e plotë, me të gjitha variantet jep mjaft mesazhe. Mesazhi i parë është referencial: Po bëhet luftë kundër një ushtrie të organizuar: "Xhit kanë malet që gjëmojnë?/-Gjemt e Lumës po luftojnë" . Thirrjet "bini burra!", "bini gjem" e të tjera të këtij lloji kanë karakter emotiv dhe hynë natyrshëm në kompozicionin e këngës. Shpesh këngët kanë edhe mesazh urdhëruesbetues, kjo veçmas për armikun: "Tan Serbia ktu me ardhë,/Sall te nja s'pështon i gjallë" . Mesazhi estetik synon të tëheqë vemendjen e marrësit, gjegjësisht të lexues – dëgjuesit. Vetë struktura e këngës është e tillë që rrëfimi kombinohet me elemente lirike, që zhvillojnë imagjinatën, të bën të meditosh. Do t'ia vlente ta ilustronim me shumë vargje, të cilat nuk mungojnë, ndër të cilat po veçojmë : "Po rrjedh Sheja plot me gjak,/Po i thotë Drinit: -Nihmom pak". Ky përfytyrim eposi, na çon në hershmëri, na bën të mendojmë për fenomenet e natyrës dhe mrekullitë natyrore, huazime të njeriut modern, që i merr nga lashtësia. Me ketë gjuhë, me gjuhën e artit, këngët shfaqin fakte kulturore të një populli të lashtë, siç është populli shqiptar në Ballkan. Këto mesazhe janë kode të kulturës tonë në përbërje të gjithë kulturës ballkanike e më gjërë. Do të ishin këto disa fakte me të cilat ne komunikojmë me historinë tonë, e cila flet se është më shumë e dhimbshme e pak e gëzueshme.

STRUKTURA

Kënga si art ka disa figura, shenja të përgjithshme e të veçanta (sema), që na çojnë te funksionet e para e të dyta. Gjatë kohës edhe këngët si shumë vepra arti e krijimtari artistike duhen parë sipas funksionit. Në momentin e krijimit kënga "Luma e sërbi po luftojnë" kishte funksion organizimi e rezistence të pritshme kundër invazionit e barbarive serbe, me mjete nxitëse e shpaguese, të cilat janë rezultat i një kompensimi për bëma të të dytëve (të tjerëve), në ketë rast të sulmit serb. Shembuj:

N'at Stamoll këndon gazeta, /Mjer dovleti për ilçe t'veta,/.... /N'Prizren po ban kuven,/I thotë Lumës:-Lirom ven,/Lirom ven, lirom vatan,/Të piqëmi n'Kolesjan" .

Pra, kënga jep arsyet e mobilizimit, nga arsye të tjetrit: Lirom vend. Pra, janë funksionet e para, ashtu si dhe ""Huxhum Lusna e Ramadani (Çajku), /Bini gjem se shkoi vatani,/Ç'ka me ba Ramadani i zi,/Te luftu me di krajli,/Karadak e me Serbi. /.../," (Lusën). Ose "Ku i ka shokët Islam Spahia,/N'at Gjalicë e nër frengjia,/Nër fregjia tuj çënrue,/Hikën sërpi, majtet n'prrue. /.../Çaj Has Fida n'tum'të ferrës,/Sa ma shpejt i jep manzerres,/.../Kur bërtajti Xheladin Rama,/ N'Stamoll i ka shkue xhama. "

Funksionet e dyta janë krejt artsitike. Ato mbeten të tilla për sa kohë nuk bëhen të nevojshme funksionet e para, funksioni pragmatik, përdorues. Sigurisht gjithnjë mendja te shkon te funksionet e para. Njëso si veshja popullore, e cila nevojitet në raste të veçanta, ndërsa në ditë të zakonshme pothuajse nuk përdoren, por mund të ekspozohen. Këngë gjatë periudhës 1920-1999 mbeti këngë artistike, ku brezat shijonin këngën nëpërmes këngëtarëve, shijonin figurat e melodinë e saj në disa variante. Pra kishte funksionin e dytë, funksionin artistik.

Prap funksione të para: "Kllade t'mdhoja jam te çue,/ N'Shkodër t'Vogël me i kalue".

Keto copëza vargjesh, të cituara nga vise të ndryshme nga Luma, Kosova, Dibra etj, janë vargje që japin luftën në kohën e vet, dmth funksionin e parë, funksonin e fillimit, funksionin pragmatik. Këngë "Luma e Serbi po luftojnë" në një kohë të afërt, më 1999, siç ishte rasti i sulmit serb më 1999 kundër shqiptarëve të Kosovës, mori përsëri funksionin e fillimit, funksionin pragmatik. Funksioni artistik sikur u zbe. Bisedat bëheshin rreth kohës së fillimit të shekullit 20-të, të sjella tashmë pragmatikisht në fund të shekullit. Kjo këngë filloi të këndohet dhe të komentohet në disa vise shqiptare, duke kujtuar ato vite të fillimshekullit. Përsëritja e ngjarjeve historike e çon këngën nga funksionaliteti artistik, në funksionin pragmatik, për mobilizim e gatishmëri. Kjo se 'Tjetri' nuk u qytetërua, mbeti po ai fillimit, primitiv. Gjithsesi kënga "Luma e Serbi po luftojnë" me të gjitha variantet e saj, mbetet një krijim artistik.

Po kjo vlen edhe për variantet e këngëve (të mëvonëshme për të njëjtën temë); ato vazhdojnë të krijohen duke pasuruar funksionin e dytë, artin. Në momente të caktuar ky funksion, siç u tha më parë, merr vlerat e të parit. Dëshira është që funksioni pragmatik të mos vijë, po gjithsesi funksioni artistik mbetet.

ROLI I KËNGËTARIT

Kënga është thurur për t'u kënduar. Atë mund ta këndojë gjithkush e gjithkund. Megjithketë këto papërcaktime, që vijnë nga anonimati, jo çdokush mund të japë vlerë këngës. Këngëtarët popullorë janë ata që e venë këngën në rolin e vet. Te këngëtari bëhet edhe verifikimi psikokulturor, (pëlqimi a mospëlqimi). Ai me intonacionin, ndjenjën, pauzat, ritmin, që lidhen me interpertimin, sqaron te dëgjuesi mesazhin e këngës.

Kënga historike merr jetë në bashkëlidhjen tekst- këngëtar (me vegla muzikore ose jo) dhe auditorit (dëgjuesit). Sikur njëra palë nga të tria të mungojë, cënohet mesazhi. Në dy të parat, teksti dhe këngëtari, kemi bashkëlidhje domosdoshmërie, kurse për dëgjuesin ka diskutime. Diskutimet varen nga gjendja momentale e gjeneratës. Një gjeneratë, ajo më e hershmja, gjatë këngës shfaq elementet e paragjuhësisë, që nuk janë tjetër, veçse veçori të etnokulturës. Kështu, kur një i moshuar dëgjon, p. sh. këngën "Luma e sërbi po luftojnë", imagjinata ka shfaqjen e jashtme me lëvizje të kokës anash, me sytë të këngëtari ose të ulur poshtë. Nuk mungojnë edhe semat kinezike, si shtërngim dhëmbësh apo gjeste mirënjohjeje e mirësjellje, që shkojnë deri te shprehja "të lumë". Dihet se lëvizja e kokës anash, shenjë miratimi, është për ne pohim, kur të tjerë e kanë mohim.

(Vijon në faqen 22)

Rruga e Arbërit nr. 81

përvjetor

Shqiptarët e kanë humbur heroin e tyre

Nga **DIONIS XHAFA**

Balkanizmi është një term gjepolitik i përdorur përgjatë shekullit të XIX-të dhe ka lidhje pikërisht me Gadishullin Ballkanik.

Definicioni që shpreh termi 'balkanizëm' është thuajse i barazvlefshëm me copëtimin, përçarjen apo kryeneçsinë në çdo aspekt të shteteve e kombeve.

Balkanizmi është një term që nuk përdoret vetëm në aspektin politik, por e hasim edhe në një aspekt më të gjërë, sidomos në atë social, teksa ligjëron përçarjen dhe fragmentarizimin, njohur në gjuhën e përditshme si 'pezhoratizëm'.

Pikërisht ky lloj termi është ngjallur ndër shqiptarët modernë, pezhoratizmi në shoqëri për arritjen e kënaqësive individuale.

Shqiptarët, historikisht e politikisht janë mbizotëruar nga ndjenja e mospranimit mbi krye të tjetrit, vetëm për të arritur shkallë në karrierë në mënyrë individuale.

Shqiptarët e kanë humbur heroin e tyre, e kanë humbur rrjedhën pacifiste në krah të kombeve të zhvilluara perëndimore e amerikane, e kanë humbur Gjergj Kastriotin.

Hamzai ndoshta ka humbur në histori, ndoshta i kemi dhënë dhe vazhdojmë teorikisht ti japim një konetacion negativ si personazh, por ai është rizgjuar në shpirtrat e shqiptarëve, shpirt i cili s'e ka lënë dhe s'po e lë Shqipërinë tonë, vendin tonë të udhëhiqet e të vishet me qytetarë të pajisur me sedër e moral shoqëror.

Duhet thënë me dhimbje, ndër shqiptarë 'ka vdekur' shpirt i Skëndërbeut dhe është ringjallur shpirt i Hamzait.

Homazh për Skënderbeun me rastin e 545-vjetorit të ndërrimit të jetës

Nga **ALI HOXHA**



Foto nga faqja në FB e shoqatës © Shoqata Çidhna Dhe Kastriotët- 17 janar 2013

Për Skënderbeun nuk mund të flitet e të shkruhet ndryshe, pëveçse kur është rasti për të bërë homazh për të, si në rastin tonë konkret në 545 vjetorin e ndarjes së tij nga kjo jetë, si dhe kur përmendja e emrit dhe e veprës së tij përdoret si shembull dhe model për t'u ndjekur nga brezat e sotëm dhe të ardhshëm, për frymëzimin dhe edukimin e tyre me dashurinë dhe sakrificën për atdheun.

Burrë shteti shqiptar, më i madhi i të gjitha kohërave është, pa dyshim, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, themeluesi i shtetit të parë kombëtar shqiptar.

Skënderbeu është emri më i nderuar, më i respektuar dhe më i dashur për gjithë shqiptarët, kudo që jetojnë dhe i tillë, ky emër do të jetë i nderuar për jetë të jetëve, sa kohë që do të ekzistojë në këtë botë kombi shqiptar dhe emri shqiptar, sepse emri i Skënderbeut është simboli numër një i kombit tonë; me emrin e tij lidhet krijimi i shtetit të parë kombëtar shqiptar, ndaj edhe flamuri i Skënderbeut është flamuri kombëtar shqiptar, i shtetit të Shqipërisë qindravjeçare dhe i gjithë shqiptarëve në Kosovë, i atyre në trojet e veta në Maqedoni e në Mal të Zi, si dhe i atyre që jetojnë kudo, në diasporë.

Skënderbeu, gjenerali më i ri dhe më i lavdishëm i Perandorisë osmane, në kohën e vet, 570 vjet më parë, në nëntor të vitit 1443, i nxitur nga ndjenja e atdhedashurisë, për gjakun dhe truallin e të parëve të vet, thënë ndryshe, për ruajtjen e identitetit të vet, braktisi jetën lukso, përrallore që bënte në oborrin e Sulltanit të superfuqisë më të madhe botërore të kohës së vet dhe, kur iu krijuan kushtet dhe rrethanat, në momentin e përshtatshëm për të, u kthye në Shqipëri, i shoqëruar nga 300 dibranë besnikë të tij ku, pasi çliroi, së pari, Dibrën dhe më pas Krujën, më 28 Nëntor 1443, në Kështjellën e Krujës valëviti i lirë Flamuri i Skënderbeut dhe i Principatës së Kastriotëve, Flamuri i Kuq me shkabën e zezë dy krenare, që më pas u bë flamuri kombëtar i gjithë Shqipërisë dhe i gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë. Më pas, në një kohë rekord, vetëm prej tre muajsh, Skënderbeu arriti bashkimin e të gjitha principatave shqiptare në Kuvendin ose Besëlidhjen e Lezhës, me 2 Mars 1444, ku Skënderbeu u zgjodh njëzëri kryekomandant i Përgjithshëm i ushtrisë së bashkuar kombëtare shqiptare, duke sanksionuar kështu de facto dhe de jure krijimin e shtetit të parë kombëtar shqiptar.

Siç dihet, Skënderbeu, për 25 vjet me radhë në krye të popullit shqiptar, luftoi me shpatë në dorë, me shembullin e vet personal, i pari në sulm dhe i fundit në tërheqje, dhe me fitoret e njëpasnjëshme sfidoi Perandorinë Osmane, superfuqinë më të madhe të kohës së vet, duke i shkaktuar asaj humbje të njëpasnjëshme dhe duke thyer mitin e pathyeshmërisë së saj. Skënderbeu zhvilloi dhe drejtoi 30 beteja kundër ushtrive të Perandorisë Osmane, prej të cilave fitoi 29 beteja, ndërsa humbi vetëm një. Prandaj qysh në gjallërinë e vet, Skënderbeu u kthye në një simbol në mbrojtje të lirisë e në një mit në gjithë Europën.

Emri i Skënderbeut u bë një simbol që e ka frymëzuar popullin shqiptar në të gjitha luftërat e tij qindra vjeçare kundër të gjithë pushtuesve të huaj. Në këtë aspekt edhe rilindasit shqiptar në të gjithë luftërat dhe përpjekjet e tyre për liri dhe pavarësi, jo vetëm që janë frymëzuar dhe udhëhequr nga emri dhe shembulli i Skënderbeut, por edhe shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912, e ideuan dhe e realizuan më 28 Nëntor, pikërisht në të njëjtën datë, në të cilën e pat shpallur Skënderbeu për herë të parë në 1443. Ndaj një skenar filmi që ia kushtoi shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912, shkrimtari Ismail Kadare e ka quajtur me të drejtë, "Nëntori i dytë".

Edhe çlirimi i Shqipërisë prej pushtimit nazifashist në vitin 1944, u projektua dhe u realizua nga luftëtarët e lirisë pikërisht me 28 Nëntor, kur qeveria demokratike hyri në Tiranë, që të ishte në unison me dy 28 nëntorët e parë. Por, me ndërhyrjet e shovinistëve serbë, udhëheqja politike e asaj kohe, në vitin 1946, e zhvendosi datën e çlirimit nga data 28 në datën 29 Nëntor, edhe pse dy vjet më radhë, më 1944 dhe 1945, po ajo udhëheqje e pat kremtuar ditën e çlirimit të Shqipërisë, më 28 Nëntor.

Në shenjë nderimi për figurën e Skënderbeut dhe të frymëzuar për të ruajtur dhe ndjekur traditën patriotike të tij, një grup intelektualësh nga Çidhna e Dibrës, vendi i origjinës së Skënderbeut, më 28 Nëntor 2011 themeluan në Tiranë shoqatën atdhetare etno-kulturore "Çidhna dhe Kastriotët", me një program të caktuar, për të ruajtur dhe edukuar në brezat e rinj traditat patriotike dhe etnokulturore të krahinës dhe mbarë kombëtare.

Edhe qeveria shqiptare aktuale, aktivitetin e parë të vitit të kaluar në kuadrin e kremtimeve për 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërsië, e zhvilloi më 17 janar 2012 në ditën e ndërrimit-jetë të heroit tonë, me një tubim mbarë kombëtar me përfaqësues mga të gjitha trevat shqiptare, me deputetë etj, nga Kuvendi i Shqipërisë, Kuvendi i Kosovës, Kuvendi i Maqedonisë e Kuvendi i Malit të Zi, pikërisht në nderim të heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut për veprën e tij të përjetshme në shërbin të atdheut e të lirisë së kombit shqiptar e më gjerë.

Për figurën e Skënderbeut, tash 600-vjet me radhë, shumë autorë, shqiptarë dhe të huaj, kanë shkruar shumë libra e studime të veçanta shkencore dhe artistike, shumë filma artistikë e dokumentarë janë bërë për të, shumë piktura e kompozime muzikore i janë kushtuar këtij kolosi, shumë përmendore janë ngritur për të, jo vetëm në trevat shqiptare, por edhe në sheshet qendore të shumë kryeqyteteve të shteteve të Europës dhe të Amerikës, pa u ndalur këtu në emrin e tij që u është vënë ndërmarrjeve dhe institucioneve të ndryshme si, shkollave, shesheve, rrugëve, skuadrave sportive, firmave ekonomike, prodhimeve industriale etj.

Nisur nga aspekte e qëllime të caktuara pragmatike, pse jo edhe politike, shumë autorë të ndryshëm, kryesisht të huaj, në shkrimet e tyre kanë bërë edhe spekulime të qëllimshme deri edhe në mohimin e origjinës shqiptare të Skënderbeut, deri në absurditet, duke e shpallur Skënderbeun dikush me origjinë serbe, apo dikush tjetër në grek. Por, ajo që duhet të theksojmë këtu, është fakti se kohët e fundit kanë dalë edhe disa autorë të huaj si Shmidt-i etj, apo edhe ndonjë vendas, nënshtetas shqiptar por me gjak (origjinë) të përzier, të cilët për qëllime të caktuara pragmatike apo ndoshta edhe të nxitur nga qarqe të caktuara politike, nga brenda apo nga jashtë vendit, që me ndonjë libër të tyre kanë tentuar të denigrojnë figurën e Skënderbeut (siç është, p.sh. libri i B.Blushit). Por ajo që dua të nënvizoj këtu është se si kjo kategori, ashtu edhe ndonjë autor tjetër i asaj kategorie, të cilët, duke mos pas kulturën e mjaftueshme historike, apo thjesht për të bërë emër, kërkon të sjellë origjinën e Skënderbeut nga fshati i vet, e pse jo, mundohet ta identifikojë edhe me fisin e vet, më e pakta që mund të themi për ato kategori autorësh, është se ato janë të atillë që, edhe pse shkojnë me ndërgjegje kundër rrymës, kundër së vërtetës, mjafton që me këtë mënyrë ata t'i bëjnë publicitet emrit të vet, për të hyrë në bibliografi si autor që kanë shkruar për Skënderbeun, pavarësisht se çfarë kanë thënë, dhe sa i shërbejnë së vërtetës ose jo, apo nëse i lexon ndokush apo jo.

Lidhur me sa më sipër se, për atë kategori autorësh që nuk kanë kulturën e mjaftueshme historike, përmend këtu, se Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ka botuar, qysh në vitin 1989, një përmbledhje studimesh nga autorë shqiptarë dhe të huaj, në tre vëllime, me titull "STUDIME PËR EPOKËN E SKËNDERBEUT", nga vëllimi i dytë i të cilit, theksoj këtu studimin e autorit nga Kosova, Flamur Hadri, me titull: "Historiografia shqiptare mbi personalitetin e Skënderbeut, origjinën dhe rininë e tij". Në të njëjtën kohë i kujtojmë lexuesit se lidhur me origjinën dhe jetën e Skënderbeut, materiale më të bollshme gjen në veprën e akademikut Kristo Frashëri, kushtuar jetës e veprës së Skënderbeut.

Për vlerësimin e figurës së Skënderbeut nga historianët dhe studiuesit e huaj, mjafton të përmendim këtu vetëm një fragment nga kërkesa e dy senatorëve amerikanë, Dona Rohbracher dhe Tom Lantos, të cilët paraqitën një rezolutë në Kongresin Amerikan të Sh.B.A-së në shenjë nderimi dhe përkujtimi për 600-vjetorin e lindjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Sipas gjeneralmajorit James Wolfe, komandant i ushtrisë britanike në Kuebek, "Skënderbeu ua kalon të gjithë oficerëve të lashtë dhe të kohëve moderne, në drejtimin e një ushtrie të vogël moderne". Dhe sipas historianit britanik Edward Gibon, "Entusiazmi i kalorësisë dhe religjionit e kanë renditur princin shqiptar përkrah Aleksandrit të Madh dhe Pirros".

Nuk mund të lë pa përmendur këtu edhe vlerësimin që i bën Skënderbeut ish-ambasadori i Sh.B.A-së në Shqipëri, z.Withers, në intervistën e tij në Janar të vitit 2012, kur flet për zhvillimet e politikës aktuale në Shqipëri, ku, veç të tjerash, thekson se shembulli i Skënderbeut duhet të shërbejë si model për klasën drejtuese dhe politike të Shqipërisë, edhe në aspektin e politikës së brendshme, sidomos në drejtim të forcimit të unitetit kombëtar, duke nënkuptuar se Skënderbeu nuk ka qenë vetëm strateg ushtarak, por edhe një burrë shteti i përkryer, shembulli dhe përvoja e të cilit duhet përdorur edhe sot. Për këtë çështje ai, ndër të tjera thotë:

". . . Shqipëria ka një nga shembujt më të mëdhenj të udhëheqjes në të gjithë historinë, që ishte Skënderbeu. Mjafton t'i hedhësh një sy modelit që ai ka lënë, pasi ishte një udhëheqës që solli bashkimin në Besëlidhjen e Lezhës në vitin 1444. Ai i bashkoi të gjitha palët rivale për interesin kombëtar. Udhëheqësit e sotëm nuk janë bashkues, janë përçarës . . . Shqipërisë i duhet një Skënderbe sot, më shumë se kurrë ndonjëherë më parë. Por në Shqipërinë e sotme nuk ka Skënderbegë dhe mua më vjen keq për një gjë të tillë". *(Gazeta "Sot", e enjte, 19 janar 2012, fq.2)*

Pra Skënderbeu jo vetëm dje, kur ishte gjallë, por edhe sot na shërben jo vetëm për luftë, por edhe për paqë, prandaj emri dhe vepra e tij do të jetë e përjetshme në shërbim të popullit shqiptar dhe më gjerë, aq sa të ekzistojë kombi shqiptar dhe të ketë shqiptar mbi dhé. Skënderbeu nuk ka vdekur, por ka ndërruar jetë. Ashtu si shpirti i tij, edhe emri dhe vepra e tij janë të pavdekshme. Ai ka zënë vend të nderuar në fondin e historisë europiane e botërore.

** Autori i këtij shkrimi është Kryetari i Shoqatës Etno-Kulturore "Çidhna dhe Kastriotët"*

ese&botime

Krenaria jonë kombëtare

Nga **BEDRI TAHIRI**

Njëzet e katër luftëra bëri
Njëzet e katër vdekje theu
Çka mangut linte Gjergji
Plotësonte natën Skënderbeu.
(Ismail Kadare)

...Janari i egër i vitit 1468, krahas dëborës së madhe, solli edhe shumë të zeza, që rënduan ashpër mbi supet e Arbërisë së molisur nga betejat e pareshtura. Rrethimi i tretë i otomanëve e kishte sfilitur fare, sa e kishte vënë buzë varrit. Kryezoti po lëngonte në shtrat nga ca ethe cfilitëse. Çdo lajm i hidhur nga fushëbetejat ia çante zemrën në dysh, por kot. Shtati prej vigani, që kurrë nuk njohu përkulje, kishte ngecur pa fuqi dhe s'ngrihej dot. Fare pranë, Donika sypërlotur, dhe i biri trembëdhjetëvjeçar, Gjoni i padjallëzuar. Tutje, ulur nëpër frone të mëdha druri, princër e kapedanë flokëthinjur e mustaqedredhur që nuk bëzanin. Heshtje e rëndë, plumb. Vetëm kur ia sollën lajmin e fitorës përfundimtare, mori frymë lirshëm. U ngrit cazë në bërryla, ua hodhi një sy të gjithëve, sa ishin aty, dhe me zë të ngjizur tha:

-O bashkëluftëtarët e mi besnikë, o princër e kapedanë trima! Unë po ua lë shëndenë. Amanet Atdheun dhe birin tim të njomë. Po u lë të rrethuar nga armiqtë, por, nëse bashkoheni dhe lidheni tok, siç kemi qenë deri sot, do t'ia dilni mbanë. Përndryshe, po u përçatë, do t'u marrë lumi. Lirinë, që nuk ua solla unë, por e gjeta midis jush, ruane më shumë se jetën! Kujdes dredhitë...pusitë...pabesitë... xhelozitë...ndasitë...

Dhe, ditë e zezë agoi. Me shtatëmbëdhjetë janar Lezha u gdhi në zi. Dielli ngatërroi rrugën. Lumenjtë ndaluan gurgullimën. Zogjtë harruan këngën. Gratë u veshen me të zeza, ndërkaq burrat shkurtuan gunat mbi bërryla. Kali, ngelur jetim, kalëroi e kalëroi derisa mbeti pa frymë. Lekë Dukagjini, flokëshprishur e mjekërrshkulur, me zë hakërrues dha kumtin e kobshëm:

-Mblidhuni, mblidhuni me vrap, o princër e sundimtarë arbërorë. Sot u bën copë e grimë dyert e Epirit dhe të Maqedonisë, sot u rëxuan muret dhe fortesat tona, sot fluturoi tërë forca dhe fuqia jonë, sot u përmbysen forcat e pushtetet tona, sot u shuan së bashku me këtë njeri çdo shpresë jona...

Vërtet, dhjetë vjet më vonë, gjërat morën tatëpjetën. Çdo gjë u rrokullis në greminë. Barbarët e përtej Dardaneleve i përmbysen të gjitha. Etnosi ynë zu të nëpërkëmbej. U sulmuan gjuha, tradita, kultura, besa, nderi. E gjurmuan dhe e gjetën edhe varrin e kryetrimit. Tërë mllef, urrejtje e frikë u vërsulen mbi të, si bishat e tërbura, dhe e zhvarrosen. O tokë, lëshona! Copë e grimë e bënë skeletin e tij. Për çudi, nga frika se po ringjallej a nga dëshira që të bëheshin trima si ai, eshtrat ia thërrmuan dhe i bënë nuska për t'i bartur me vete. Kështu, trimi, që lavdinë dhe trimërinë nuk ia zuri një varr i vetëm, u shtri gjithandej nëpër Evropë e deri në Azi.

Shpirti i tij i ndritur edhe më vonë, si gur sinori, u trazua nga të tjerët, që përpiqeshin me çdo kusht ta përvetësonin. I provuan të gjitha mënyrat, por pa sukses. Pema s'njihet nga gjethet, por nga rrënjët. E ato ishin thellë- thellë nën shkrepat e thepisur të Arbërisë së lashtë, ku nuk arrinte dot dorë e huaj. Prej andej buronin dhe kujtimet e pashterrura për këtë kryehero. I përjetësuar në këngë, në legjenda, në tregime e në monumente të ndryshme na përcolli denbabaden, duke na e mbajtur ndezur flakadanin e lirisë nëpër shekujt e errësuar e të mpleksur me gjak, ndërskamca, heroizma e ringjallje.

Emri i legjendarit frymoi përherë edhe në tokën e lashtë dardane. Më gjallërues ishte gjatë luftës së ndritshme të UÇK-së. Një ditë nuk u durua më, edhe vetë ia mësye këtej...

28 Nëntor 2001. Kudo që bukës i thonë bukë e ujit ujë kishte festë. Qafë- Morini kishte gdhirë pa shtirë gjumë në sy. Ishte dehur fare nga gëzimi. Fati i rastisi t'i bashkojë shqiptarët. Aty po takoheshin legjendarët: Gjergj Kastrioti nga Kruja dhe Adem Jashari nga Prekazi. E madhërishme. Fascionuese. Mrekullia vetë. Një kurorëzim i rrugës sonë të gjatë mbi pesëqindvjeçare.

-Mirë së vjen, o Gjergj vëllai, o princi ynë i madh, që për shumë vjet nderove Arbërinë dhe mbarë Evropën!

-Mirë së ju gjëj, vëlla Adem, o komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që me gjakun Tuaj të shtrenjtë më hapet rrugë për në Kosovën trime, që për të gjallë vetëm njëherë shkela nëpër këto troje të begata dhe shova etjën në krojet e bilurta!

Malet përreth mbanin vesh e dëgjonin në heshtje. Flamujt kuqezi valviteshin hareshëm e përplot krenari. Ballë për ballë edhe dy gjeneralët: Pëllumb Qazimi e Agim Çeku.

Dhe, shpata e Gjergjit vringëllinte.

Dhe, mitralozi i Adem Jasharit bubullinte.

Dhe, kënga e vallja s'kishin të ndalur. Po bëheshin tok edhe tre nëntorët:

KRUJA
VLORA
PREKAZI.

Emëruesi i përbashkët: LIRIA.

Sot edhe më mirë. Krenar e fytyrëqeshur nëpër mësonjëtorët tona të shenjëta prore rrezaton bashkim, urtësi, trimëri, bujari e mbi të gjitha atdhedashuri. Ai, për çdo ditë sikur u flet njomëzakëve:

Pa më shihni se ç'kam veshur,
Koha donte shpatë e trimëri,
Sot, o bukurosha, lypset ndryshe,
Libra, mësime dhe dituri!

Ç'porosi e mbarë e ç'mësime të mira për dritat e ardhmërisë. I tillë ka qenë gjithmonë Gjergji ynë, simboli i krenarisë sonë kombëtare. Ai nuk qe vetëm yni. Jo, jo. Vite me radhë mbrojti mbarë civilizimin dhe krishterimin evropian. Papati e çmoi shumë, ia dha titullin Kapiten i Përgjithshëm i Selisë së Shenjtë, por i mbeti borxh, nuk e shenjtëroi. Thonë koha shëron plagët. Të shohim sa do të ndreqen padrejtësitë që na i bëri mësuesja e jetës- Historia.



"Katër ditë vizitë në Kosovë"

PROMOVIMI

Mardhëniet e Shqipërisë me Kosovën në vitet 80 sipas kujtimeve dhe dokumenteve nga vizitat e ish ministres së arsimit Tefta Cami në Kosovë
Veprimtari të shumta të përbashkëta në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, sportit, bashkëpunim i shkëlqyer që kulmon me lëvizjen studentore të vitit 1981.

Ky libër u promovua në fillim në Prishtinë dhe më pas në Tiranë. Në sallën "Aleks Buda " të Akademisë së Shkencave me datën 23 janar 2013 në orën 17.00 në prani të qindra pjesëmarrësve, nën kujdesin e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Tiranë , u zhvillua diskutimi për këtë libër historik me vlera të mëdha për të gjithë shqiptarët, sidomos për brezin e ri.

Për strukturën e librit foli vetë autorja, ish ministrja e Arsimit në vitet 70-80, Tefta Cami. Vlerësime dhe opinione nga promovimi i librit në Kosovë me 26 dhjetor 2012 dha studiuesi, Kolonel Ndue Doda.

Për bashkëpunimin e Universitetit të Tiranës me Universitetin e Prishtinës gjatë viteve 1968-1981 foli ish-rektori i UT. Prof. Osman Kraja.

Për bashkëpunimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me Akademinë e Shkencave dhe të arteve të Kosovës gjatë viteve 1970-1981 foli ish-sekretari shkencor i Akademisë së Shkencave Prof. Luan Omari.

Për bashkëpunimin e RTV të Shqipërisë me RTV e Kosovës gjatë viteve 1970-1981 foli ish-drejtori i Përgjithshëm i RTVSh, z. Marash Hajati.

Folën gjithashtu ish zv. Kryeministri i Krahinës Autonome të Kosovës në vitin 1980 Pajazit Nushi, tani akademik në Akademinë e Shkencave dhe të arteve të Kosovës, bashkëshortja e ish sekretarit krahinor të arsimit për Kosovën Ymer Jaka , zonja Meliha Jaka

Për bashkëpunimin e Komitetit Shtetëror të Kulturës Fizike dhe të Sporteve të Shqipërisë me Shoqatat përkatëse të Kosovës gjatë viteve 1970-1981 foli ish-kryetari i Komitetit Shtetëror të Kulturës Fizike e të Sporteve z. Mehdi Bushati.

Mbi rolin e vlerat e Ymer Jakës, ish-sekretarit për Arsimin, Shkencën e Kulturën të Kosovës në bashkëpunimin në fushat e arsimit, kulturës, shkencës dhe sporteve midis Kosovës dhe Shqipërisë kumtoi z. Thoma Qirjazi.

Zv.Ambasadori i Republikës së Kosovës Z. Gani Vejseli rikujtoi ato vite të vështira, por edhe vite të paharruara bashkëpunimi në të mirë të kombit shqiptar.

REFLEKSIONE DHE KRONIKA

Kur lexon këtë libër me kujtime dhe dokumente të periudhës 1970-1980, nëqoftëse je bashkëkohës, natyrshëm sjell ndërmend edhe sa e sa veprimtari të tjera të pa shkruara në libër, sepse në këtë libër autorja dhe aktorja e këtyre veprimtarive ministrja e arsimit dhe kulturës së Republikës së Shqipërisë në vitet 70-80, Tefta Cami ka rrokur në libër vetëm kujtimet dhe dokumentet e saj. Të tjerë ndoshta do të sjellin kujtime dhe faktet e tyre jetësore për këtë periudhë të errësuar qëllimisht nga faktorë të politikës shqiptare, që luftën dhe pavarësinë e Kosovës duan t'ja veshin vehtes, ndërkohë kur lufta për çështjen e Kosovës herë herë është zbehur, por kurrë nuk është ndalur deri në triumfin e saj. Zonja Tefta Cami është nga ato shqiptare, nga ato dibrane, që gjysmën e gjakut të saj e ka në viset shqiptare të Maqedonisë dhe në Kosovë, ndaj jo rastësisht bashkëpunimi në fushën e arsimit, kultuës, shkencës, sportit midis vendeve buronte si një gurrë njerëzore, para detyrës shtetërore. Është abuzuar shumë në këto 23 vjet demokraci, me dashje nga disa bashkëkohës dhe për injorancë nga disa lider të rinj dhe është spekulluar duke i mëshuar faktit se Kosova është harruar me dashje nga udhëheqja e viteve të pasluftës. Por faktet janë kokëshkreta.

Në vitin 1968 është festuar me madhështi 500 vjetori i vdekjes së Skënderbeut dhe vendosja e bustit madhështor të heroit tonë kombëtar në mes të Tiranës. Me këtë rast u zhvillua edhe Konferenca e II Albanologjike me temë "Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe epoka e tij ku morën pjesë mbi 220 studiues nga të gjitha trevat shqiptare, ndërmjet tyre nga Kosova, prof. Mark Krasniqi, prof. Fehmi Agani, prof. Idriz Ajeti, prof. Anton Çeta, prof. Zef Mirdita etj. Dhe kjo nuk është bërë më në vitet e demokracisë në vitin 1998, 2008, përkatësisht në 530 dhe 540 vjetorin e Skënderbeut.

Në vitin 1978 është festuar me madhështi si në Shqipëri dhe në Kosovë 100 vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe kjo nuk ka ndodhur më pas në vitet 1998 dhe 2008, përkatësisht 120 dhe 130 vjetori i kësaj ngjarje më të madhes në historinë e popullit tonë pas vdekjes së Skënderbeut.

Në vitin 1972 është zhvilluar Kongresi i drejtshkrimit dhe njehësimit të gjuhës shqipe me pjesëmarrjen e gjuhëtarëve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe diaspora si dhe albanologë nga shumë vende të Europës. Ky kongres u shoqërua me botime të rëndësishme shkencore për drejtshkrimin e gjuhës shqipe. Në ditët e sotme jo vetëm nuk është ecur përpara për çështjen e gjuhës , por ka patur përpjekje gjoja në emër të shkencës për ndarjen e gjuhës shqipe në gegërishte dhe toskërishte thua se nuk janë dy dialektetet kryesore të shqipes, por dy gjuhë të ndryshme. Kombi shqiptar ka një gjuhë , gjuhën shqipe. Është ajo që i bashkon shqiptarët në Shqipëri, në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni, Çamëri e kudo.

Po në vitin 1972 zhvillohet në Tiranë Kuvendi i studimeve ilire me pjesëmarrjen e shkencëtarëve nga gjithë viset shqiptare dhe nga albanologë nga e gjithë bota ku u vërtetua shkencërisht se ilirët janë parasrdhësit e shqiptarëve.

Në dhjetor të vitit 1979 me ftesë të qeverisë shqiptare vjen për vizitë 6 ditore sekretari krahinor për arsimin të Kosovës Dr. Ymer Jaka me një delegacion shoqërues me figura të shquara të shkencës dhe të kulturës në Kosovë, vizitë që u shoqërua me protokolle bashkëpunimi në fushën e arsimit, shkencës, kulturës , sporteve etj.

Në këtë kohë kemi intensifikim të veprimtarisë së arsimit shqiptar në Kosovë. Universiteti i Prishtinës rriti bashkëpunimin me Universitetin e Tiranës. Profesorët e shqiptarë dhanë leksione të rregullta në Universitetin e Prishtinës. Akademia e Shkencave e Shqipërisë rriti bashkëpunimin me Akademinë e Shkencave të Kosovës. Grupe artistike të Shqipërisë dhanë shfaje artistike ne shumë qytete të Kosovës dhe anasjelltas grupe artistike të Kosovës dhanë shfaqje në Shqipëri.


Libri është i pajisur me dokumente autentike të Arkivit të Shtetit si dhe me fotot e takimeve të Sekretarit krahinor të arsimit dhe shkencës të Kosovës Dr. Ymer Jaka në Shqipëri si dhe të Ministres së Arsimit dhe të Kulturës të Shqipërisë Tefta Cami gjatë vizitës në Kosovë.

Ky libër është një memorje historike që për hir të së vërtetës është vlerësuar më shumë në Kosovë dhe më pak në Shqipëri. Është koha që për bashkimin kombëtar të punojmë me vepra, me shpirt e me zemër dhe jo me demagogji politike.

SAKIP CAMI

Rruga e Arbërit nr. 81

botime



“Zemër e lënduar” e poetes Hatixhe Erebara

Nga **FAIK XHANI**

Poetja Hatixhe Erebara vjen para lexuesit me një vëllim poetik të titulluar: “Zemër e lënduar”. Është një poezi e thjeshtë, e qartë, e ngrohtë dhe e veçantë. Shumë poezi të këtij vëllimi poetik janë shkruar shumë kohë përpara dhe janë ruajtur me shumë kujdes, me shpresën se një ditë do të shohin dritën e botimit. Ky vëllim poetik është një ëndërr e kaherëshme e autores që arriti të bëhet ralitet vetëm tash në demokraci. Autorja ka botën e pasur shpirtërore, humanizmin, atdhetarizmin, pjekurinë e plotë, konsideratat e larta, respektin dhe dinjitetin e duhur njerëzor.

Në këtë vëllim poetik autoria vë zemrën dhe shpirtin e saj , gëzimet dhe hidhërimet , arritjet, pengesat , ndrydhjen dhe dlirësinë e tyre, dëshirat dhe pengjet e saj, dashurinë, urrejtjen, dhembshurinë dhe magjinë e feminilitetit, impenjimin e saj si mësuese, si bashkëshorte, si nënë dhe qytetare. Gjithmonë ka synuar të bëhet krijuese, por sistemi monist ia ndrydhte këtë dëshirë, pasi babai i saj kishte emigruar qysh para çlirimit jashtë shtetit. Në libër me shumë emocion përcillen dedikimet e saj për nënën, gjyshet dhe babain, për nxënësit, për profesionin e bukur të mësuesit, për vendlindjen Dibrën, por edhe për Shkodrën ku ajo u arsimua e u diplomua si mësuese, për Venecien, Meranon e Italisë etj.

Persekutimi, censura, kurbeti, ndrydhja e lirive dhe cënimi i të drejtave njerëzore përshkruajn gjithë vëllimin poetik. E rëndësishme është se gjithë kjo botë e pasur shpirtërore, jeta e saj e trazuar, aktiviteti dhe veprimtaria e saj vijnë natyrshëm pa sforcime. Ata ku më shumë e ku më pak përqasen me jetën e lexuesit, i japin atij momente prekëse, tablo rënqethëse, fragmente jete me gjithë koloritin e ngjyrave, përjetime e reagime, pengje, dëshira dhe mesazhe që emocionojnë, rrezatojnë për të ardhmen me plot dëshirë, dritë e shpresë. Ajo nuk mbetet robe e gjendjeve, momenteve e situatave, përkundrazi i sjell me realizëm, i pasqyron me imtësi, i shoshit në sitën e mëndafshtë me besim që të çajë në jetë me vendosmëri e krenari.

Interesant është fakti se kjo autore në gjithë vëllimin poetik mundohet të jetë vetja, të jetë Hatixhe Erebara me pluset dhe minuset e saja. Ajo vjen me një status original poeteje e jo si imituese e dikujt tjetër. Edhe në se ka raste, ku poezia e saj nuk ka figuracionin e duhur artistik, gjë të cilën e mbush me tematikën e pasur e me përshkrimin real të dukurive e momenteve, ç’ka e tërheqin lexuesin.

Ajo flet në poezinë e saj si nënë, si mësuese, si bashkëshorte, si grua dhe si kuadër. Poezia e saj e thjeshtë përtypet shpejt nga lexuesi. Jo në pak raste mer pamjen e plotë dhe fiton statusin e poezisë së vërtetë, sepse rrezaton jo vetëm ide e mesazhe, por edhe është ndërthurur me frymëzim dhe është vesh me koloritin figurativ, çka e bën më prezentabël, më të pranueshme, më tërheqëse e më të pëlqyer për lexuesin.

Në tërësi ky vëllim poetik për nga idetë që shtjellon, mesazhet që jep dhe në mënyrën e kompozimit paraqet interes dhe justifikon sipërmarjen e autores duke e klasifikuar atë në radhët e plejadës së kohës të poetëve shqiptar.

Shënime rreth librit: “Turizmi Shqiptar” të publicistit Xhelal Marku

Një triologji me vlera për Turizmin Shqiptar

Nga **MEVLUD BUCI**



Xhelal Marku shpalos me artin e bukur të fjalës e të figurës gjithë bukuritë tona natyrore, klimën e preferuar dhe pasuritë e mëdha të trashëgimisë kulturore të këtij vendi, historinë, kulturën, artin, kinematografinë, letërsinë, arkeologjinë e arkitekturën, traditën e lashtë të bujarisë e të mikpritjes shqiptare, si dhe bashkëjetesën e harmoninë historike fetare të shqiptarëve, që ka mahnitur botën me realitetin e saj unikal

Duke lexuar librin e ri “Turizmi Shqiptar” të studjuesit dhe publicistit të njohur Xhelal Marku, të duket sikur ke prekur dhe shijuar resurset e shumta turistike të Shqipërisë përgjat gjithë hapsirave të saj, nga bregdeti e deri në lartësitë e Alpeve. Ai shpalos me artin e bukur të fjalës e të figurës gjithë bukuritë tona natyrore, klimën e preferuar dhe pasuritë e mëdha të trashëgimisë kulturore të këtij vendi, historinë, kulturën, artin, kinematografinë, letërsinë, arkeologjinë e arkitekturën, traditën e lashtë të bujarisë e të mikpritjes shqiptare, si dhe bashkëjetesën e harmoninë historike fetare të shqiptarëve, që ka mahnitur botën me realitetin e saj unikal. Lexon këtë libër dhe frymëzohesh për vlerat turistike të vendit tënd, që padyshim janë e ardhmja e ekonomisë së Shqipërisë. Krenohesh me konkurencën e vendit tonë në tregun turistik botëror. Dhe thua me vete: “Ej sa shpejt i ngjiti shkallët Shqipëria jonë Turistike, që sot mediat më prestigjioze e rekomandojnë si të parin vend në botë, që duhet vizituar...”. Kënaqësi e krenari për të gjithë ne shqiptarët për këtë realitet të ri të Shqipërisë, për këtë imazh të ri të saj, kudo në Botë. Lexon faqet e librit “Turizmi Shqiptar” të autorit Xhelal Marku dhe përnjëherësh e ndjen përkushtimin e tij për të sjellë nëpërmjet këtij botimi, një risi promocionale të zhvillimeve turistike në vend. Këtë fakt e thekson edhe redaktori i librit, shkrimtari dhe publicisti Albert Zholi në komentin e tij tek “Hyrja” e librit të autorit Xhelal Marku: “... Them me bindje të plotë, thotë ai, se libri, “Turizmi Shqiptar” i Xhelal A. Markut, sjell një promocion të ri e të fuqishëm për Shqipërinë Turistike, për imazhin e saj të ri e të mrekullueshëm, që tashmë është bërë pjesë e përvitshme e promocioneve të mediave e të shtypit të huaj më prestigjioz të turizmit botëror...”. Ky libër simpatik, të lë mbresa me faktet dhe argumentet, që sjell nëpërmjet fotografive të shumta e cilësore, të gjitha me ngjyra, duke ilustruar mjaft mirë gjithshka që thuhet në tekst. Në këtë drejtim vlen të përgëzohet për punën plot art e profesionalizëm edhe autori i paraqitjes grafike të librit, specialisti i njohur i Agjensisë Kombëtare të Turizmit, Ergys Faja, i cili me përvojën e tij ka ditur të përzgjedh fotot dhe t`i përdor ato për ilustrim e argumentim në masëm dhe në vendin e duhur. Kështu, libri paraqet një pasqyrim konkret të resurseve turistike të Shqipërisë, por dhe të zhvillimeve bum të tij në fillimet e këtij shekulli. Por, vlerat e librit “Turizmi Shqiptar”, qëndrojnë edhe në gamën e gjërë të informacionit që sjellë për lexuesit, në gjurmimin dhe përzgjedhjen e fakteve, ku autori Xhelal Marku, ka rendur pas tyre me pasionin e bletës. Është një punë e përkushtuar kjo e një krijuesi të talentuar, i cili përvojën e tij të gazetarit e ka gërshetuar bukur me atë të profesionit të hershëm të mësuesit të letërsisë në gjimnaz, duke na dhënë një produkt mjaft cilësor e të realizuar me mjeshtëri edhe nga ana gjuhësore. Në këtë mënyrë, autori ka ditur të ndërtojë me talentin e tij letrar e krijues, një vepër letraro-publicistike interesante e tërheqëse për të gjithë lexuesit, vendas apo të huaj qofshin ata. Libri është një botim cilësor dhe i kompletuar, i cili shënon një nivel të ri promocional në publikimin e vlerave turistike të Shqipërisë, si dhe në rritjen e imazhit të saj turistik në tregun botëror. Duke iu referuar arritjeve që ka shënuar zhvillimi i industrisë turistike në vend, autori thekson, se Turizmi Shqiptar nuk është më ai i dikurshmi, që konceptohej vetëm në rërë e det, por shumë e shumë më tepër se kaq. Ai sot shtrihet në të gjithë territorin shqiptar, në fushë, mal, bregdet e kudo, është i shumëllojshëm, por edhe gjithëvjetor. Me një pasion të veçantë, autori i librit Xhelal Marku analizon e argumenton historinë e veçantë e unikale të bashkëjetesës e harmonisë fetare në Shqipëri. Një foto e përbashkët e përfaqësuesëve të katër feve, që ekzistojnë sot në vend, është një domethënie e madhe, një atraksion i fuqishëm turistik për vizitorët e huaj, që ky relitet i ka befasuar. Ata kanë lexuar e prekur tek historia fetare e shqiptarëve edhe sekretin e kësaj bashkëjetese e harmonie të madhe, moton që i mban fetë të lidhura bashkë në Shqipëri. Ajo moto buron nga fjala e urtë popullore: “Pa atdhe, nuk ka fe!”, që do të thotë se të gjitha fetë, janë në shërbim të Shqipërisë. Ky është dhe lejtmotivi shqiptar i zhvillimeve fetare në vendin tonë përgjat gjithë kohërave, që nga lashtësia e deri në ditët e sotme. Edhe pse shteti i diktaturës komuniste e ndaloi me ligj fenë në Shqipëri në vitin 1967, ai nuk arriti dot t`i shuante besimet fetare tek njerëzit, të cilët pas viteve `90, me besimin e madh tek Zoti, iu rikthyen institucioneve fetare si rrallë ndonjë herë në historinë e tyre shumëshekullore të këtij vendi me tradita të shumta kulturore në Ballkan.

Duke përshkruar vlerat e shumta të trashëgimisë tonë kulturore, si një atraksion i veçantë turistik i vendit, autori i librit, ndalet në paraqitjen e kalave të Shqipërisë, që nga Shkodra e deri në Butrint, si kështjella të fortifikimit ilir, që dëshmojnë për historinë qëndrestare të shqiptarëve në shekuj, si dhe për lashtësinë e Trojeve tona autoktone. Me pasion e dashuri përshkruhet në libër edhe vija jonë bregdetare me plazhet e mrekullueshëm, që nisin nga Velipoja, Shëngjini, Gjiri i Lalëzit, Durrësi, Golemi, Mali i Robit, Divjaka, Gjiri i Vlorës, Dhraleo në Palasë, Dhërmiu, Himara, Spillea, Potomi, Llamani, Livadhjaja, Qeparoi e Porto Palermo, ku gjëndet dhe njëra nga kalatë, ajo e Ali Pashës, duke vazhduar më pas me Plazhet e tjerë të Rivierës, si: Buneci, Kakomea, Krorëzi, etj. Të ilustruara dhe me fotot përkatëse, plazhet tona pasqyrohen në libër si plazhet me bukuri të rrallë në rajon, të cilët shquhen për cilësinë e ujrave të pastra të detit. Por, duke argumentuar idenë se Turizmi Shqiptar nuk është më ai i traditës së hershme, ku frekuentohej vetëm deti dhe rëra, autori Xhelal Marku sjell në librin e tij edhe peizazhin e bukur të natyrës tonë malore, si një tjetër atraksion turistik i kërkuar dhe i frekuentuar nga vizitorët e huaj dhe vendas. Parqet tona kombëtare, si: Dajti, Thethi, Lura, Llogaraja, Drenova, Valbona, Mali i Tomorrit, Hotova, Qafë – Shtama, etj, me bukuritë e rralla natyrore, burimet kurative dhe klimën e mrekullueshme që kanë, janë destinacionet tona malore më të vizituara nga turistët jo vetëm në verë, por edhe në dimër, ku frekuentohen sportet dimrore të aventurës, si: skitë, alpinizmi, aeronatika, etj. Në libër, lexuesi gjen një pasqyrim të gjërë edhe të turizmit shëndetësor, i cili përfaqësohet me pushimet në Llixha (ujërat termale), ku paraqiten vlerat kurative të burimeve të njohura termale të Peshkopisë, Elbasanit, Fushë - Krujës, Bënjës, etj. Libri është i kompletuar me informacione të reja dhe profesionale për gjihthshka, që i nevojitet një turisti, që preferon të vizitojë vendin tonë. Aty jepen jo vetëm rrugët hyrëse në Shqipëri, me tokë, ajër e det, por dhe harta e plotë e rrjetit të ri rrugor të vendit, distancat e të gjithë qyteteve tona nga Tirana, si dhe harta turistike e Shqipërisë. Autori e ka ndërtuar librin mbi tre kapituj, të cilët duket se plotësojnë njëri tjetrin, për t`i bërë më bindëse faktet dhe argumentet, që thuhen. Kapitulli i parë jep resurset turistike të Shqipërisë dhe gjithçka që ofron ajo për pushuesit e huaj e vendas, kapitulli i dytë sjell opinionet dhe mbresat e vizitorëve të huaj vipa, gjatë më shumë se një shekulli, ndërsa kapitulli i tretë është një pasqyrim artistik i realitetit turistik të vendit në ditët e sotme. Ndaj, unë e kam vlerësuar librin “Turizmi Shqiptar” të autorit Xhelal Marku, si një triologji me vlera të veçanta promocionale për publikimin e imazhit të ri turistik të Shqipërisë. Ai është i pari libër gjithëpërfshirës dhe gjithhapsinor për Turizmin Shqiptar, që vjen nga një mjeshtër i gazetarisë, por dhe specialist i turizmit, i cili ka derdhur mbi të, gjithë talentin e tij krijues të mbledhur në vite. Kësisoj, libri “Turizmi Shqiptar” i autorit Xhelal Marku, ka hyrë në fondin e botimeve shqiptare, si një nga botimet e rëndësishme të realizuara në kuadrin e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, i cili mori vlerësimet më të mira edhe në promovimin, që iu bë nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe nga Agjensia Kombëtare e Turizmit, ku ai punon. Me këtë rast, unë i uroj autorit, suksese në punën e tij krijuese, për të na dhënë të tjera botime me vlerë në të ardhmen!

recensë

Refleksione mbi poetikën e poetes ndërkombëtare më të mirë të viteve 2005, 2007

Panajota Zalloni, margaritari i lirikës së sotme greke

Nga **MENTOR HOXHA**

Panajota Hristopullu-Zalloni, njihet si poete, gazetare, tregimtare, piktore, ikonografe dhe botuese. Ka publikuar mbi 62 libra me poezi, poema, tregime e publicistikë. Përfshirë në 30 antologji poetike. Ka fituar 150 çmime në Greqi, Gjermani, Itali, Shqipëri, SHBA, Brazil, Meksikë, Indi, Kinë etj. E nderuar nga "UNESKO "Për Qytetërimin dhe Paqen", nga Lidhja e Shkrimtarëve të Greqisë, Shoqata Letrare e Mynihut, Lidhja e Shkrimtarëve e Artistëve Ndërkombëtarë, Lidhja e Poetëve Ndërkombëtarë, Shoqata e Shkrimtarëve Meksikanë, Lidhja e Krijuesve "Pegasi" -Albania, Akademia Vezuviana-Napoli, nga Bashkia e Ilios në Athinë. Më 28 dhjetor 2005 u shpall nga "The International Poetry Translation and Researth Centre" dhe nga revista "The World Poets Quarterly" China si "Poetja më e mirë e vitit 2005". Këtë Çmim e mori edhe më më 2007. Është anëtare nderi e Akademisë Ferdinandea-Catania e Italisë e Shoqërisë Historike të Katanës, Itali, e Word Academy Of Arts And Culture-USA, e Shoqërisë UNESCO-s (si kryeredaktore e edukimit), anëtare e e Lidhjeve Ndërkombëtare UPLI (USA) dhe W. L.S India, e Akademisë Vezuviane, Napoli, e Lidhjes së e Bashkimit të Shkrimtarëve Grekë dhe e Bashkimit Panelenik të Shkrimtarëve. Librat e saj janë publikuar në 13 gjuhë të botës; frëngjisht, italisht, gjermanisht, arabisht, turqisht, rusisht, rumanisht, serbisht, spanjisht, shqip, etj. Ka marrë pjesë në shumë simpoziume dhe kongrese letrare kombëtare e ndërkombëtare. Është "Docente Nderi" e Filozofisë në Universitetin e NEY-YORK. Boton për çdo vit përmbledhjen poetike "Flakën e krijimtarisë" me poetët e rinj. Ka përfaqësuar talentët grekë në simpozium "Poezia Bashkëkohore". Ka dhënë kontribut të madh në përkthimin në anglisht, italisht, frëngjisht e greqisht të poetëve nga vende të ndryshme në rubrikën "Poetë internacionalë". Organizon Kongresin Ndërkombëtar të Letërsisë me 20 takime në qytete të ndryshme të Greqisë dhe të Qipros dhe një kongres 4 ditor me pjesëmarrje të poetëve nga e gjithë Bota. Ka pikturuar qindra ikona dhe ka marrë pjesë në shumë ekspozita. Pikturat dhe ikonat e saj ndodhen në ballina librash, në çmime letrare, ftesa e revista dhe janë pronë e ekspozitave private në SHBA, Itali, Serbi, etj. U lind në Shën Gjeorgjio-Istieas në Eube të Greqisë. Ka kryer studimet e larta për ekonomi në Universitetin e Pireut. Në shqip ka botuar 4 përmbledhje poetike; "Galopimi i kalit bojë blu", "Pikturoj në det të bardhë", përkthyer nga Kristaq F. Shabani e Kosta Gaxhoni, "Në detin e bukurisë" dhe "Etje për qiell". Është përfshirë në antologjitë poetike në shqip "Korsi e hapur" dhe "Poezitë e fqinjëve të jugut". Është presidente e Shoqatës së Shkrimtarëve "Xasteron" me qendër në Athinë. Përgatit e boton revistën letrare "Keleno", "Kritovulos" dhe "Rruga e Trevës" me poetë nga e gjithë bota. Organizon çdo vit në Athinë konkursin poetik "Keleno".



NË PENDOLIRËN E POEZISË ZALLONIANE

...Atdheu i Homerit, Eskilit, Europidit, Aristofanit, Safos, Seferisit, Elitisit, Pallamasit, Kavafit, Solomosit, Varnalit, Siqeljanos, Vretakosit, Porfirit, Livadhitis, etj., vazhdon të na magjeps sërish me megaveprat letrare që na ka dhuruar dhe vazhdon të na dhurojë. Greqia, ky vend antik, plot mite dhe lavdi, plot heronj, nobelistë dhe shkrimtarë të mëdhenj, ky vend ku lindi demokracia, letërsia dhe civilizimi botëror, është si ai burimi i kristaltë që sa më shumë ujë nxjerr, aq më i kristaltë dhe i pashterim bëhet ai. Në thellësi të pafundësisë së këtij burimi të lashtë sa vetë historia njerëzore, ku u shuan dhe vazhdojnë të shuhen buzët e shkrumbuara të miliona e miliona njerëzve nga mbarë bota, jam edhe unë shqiptari i epokës moderne. Unë, vogëlushi i djeshëm i magjepsur nga aventurat dhe bukuria marramendëse e Helës së bukur greke dhe nga trimëria dhe atdhedashuria e Odiseut të zgjuar nga ishulli grek i Itakës, dhe sot, gazetari dhe letrari i burrëruar, që magjepsem sërish teksa lexoj e rilexoj veprat brilante të shkrimtarëve të mëdhenj grekë që nga antikiteti e deri në kohët e sotme moderne. Magjia e këtij vendi megahistorik, ku heronjtë, historia, letërsia, kultura dhe natyra me ishujt, parqet, pallatet dhe vilat shumëngjyrëshe gërshetohen me njëra-tjetën, duke na dhënë panoramën dhe portretin impresionues e madhështor të këtij vendi perlë që krijoi Perëndia dhe njerëzimi, jo vetëm për banorët e Greqisë, por për mbarë banorë e botës, që e kanë parë e riparë, apo janë në radhë për ta vizituar. Por, megjithë lavdinë dhe madhështinë e ngritur me mund e gjak ndër shekuj e mijëvjeçarë, sot, ky vend, mikpritës e bujar, ashtu si Odeseu antik dhe "Titaniku" modern që përpëliteshin midis dallgëve të shkumëzuara të detrave të paanë, ashtu edhe ky vend, që ka pritur, ushqyer e përcjellë miliona e miliona turistë dhe refugjatë nga mbarë kontinentet, sot, përpëlitet në ujërat e dallgëzuara për mbijetesë. Në bordin e kësaj anijeje është edhe bardi i lirikës moderne greke, shkrimtarja e shquar 70 vjeçare Panajota Hristopollu-Zalloni. Dhimbja për vendin e saj shprehet figurativisht në vargjet: "Gladiola të bardha/ Të stivosura në platformën e stacionit/ u mbuluan nga gri-ja e mërzitshme e qiellit". Këto poezi të saj mbështillen nga një pendolirë trishtimi, ku aurola e dhimbjes mbisundon në çdo rrokje. Si natyrë e ndjeshme dhe impulsive ajo shpërthen sërish me vargjet: "Bota e zhveshur, kurse ti mundohesh/ T'i veshësh asaj diellin tënd". Saga e dhimbjes së saj nuk ka shterim, ndaj tingulli dëshpërues rishfaqet edhe në vargjet: "I plakur tashmë qeni në



Panajota Zalloni midis poetëve shqiptarë

oborrin e Odisesë/ Jetoj me ca thërrime që gjeta në Itakën time të varfër". Por, megjithë trishtimësinë, ajo nuk dorëzohet në metastazat e dhimbjes, përkundrazi, rigjeneron forca dhe shpresë për veten dhe për bashkëkombasit e saj, të cilat i shpërfaq në vargjet: "Troja jonë u rrafshua/ E çfarë pastaj?/ Do të ringremë një Trojë tjetër". Pra, edhe në vargjet e mavijosura nga dhimbja ajo lë të hapur një dritare shprese. Poezitë e saj shquhen për elokuencën e vargut, për sharmin estetik, për fugurshmërinë dhe përftesat brilante stilistike të krijuara prej saj. Në 36 përmbledhjet poetike në Greqi dhe jashtë saj, përcillet poetika e një realiteti të transfiguruar në metrikën e vargut dhe në korrelacionin artistik, ngjyrosur në pigmentin e emocionues, shpërthyes dhe determinues. Poezia e saj ngjason me një oqean të pafund që sa më shumë zhytesh, aq më shumë zbulon përmbrenda perla dhe thesare. Çdo detaj ndijimësor i pigmentëzuar në varg, ka emocionin shpërthyes dhe shpërfaqjen stilistike, të cilat përçojnë tek lexuesi ndjesi intuitive dhe estetike. Si shkrimtare me përvojë të gjatë në skenën letrare kombëtare e ndërkombëtare, ajo ka aktruar me sukses për 50 vite me radhë duke u shquar gjithmonë për shumëllojshmërinë metriko- tematiko-figurative ku janë janë ngjyrosur dhe stampuar këto detaje. Tashmë, ajo krijuar universin e saj poetiko-filozofik, si në mënyrën e konceptimit dhe të vëzhgimit të jetës, ashtu dhe në përdorimin e regjistrit ideoemocional dhe figurativ. Konsiderohet si poete e detajeve të holla, ku në çdo strofë apo varg, flet gjuha e emocionit poetik dhe korrelacionit estetik. Mbisundojnë shfrimet shpirtërore dhe artistike me një nerv lirik, sarkastik, ironik, simbolik dhe metaforik. Zalloni është përkujdesur që çdo detaj të transfiguruar në poezi ta jap me një gjuhë sa më të përgjedhur poetike si në metrikë, stilistikë dhe korrelacion estetik, si në poezinë dyvargëshe, trivargëshe, apo në ato me rimë a varg të thyer. Me një fuqi sugjestive stilistike ajo e deshifron detajin në qindra mesazhe artistike dhe ndijimësore, duke i dhënë poezinë së saj adrenalinën emocionale. Pikërisht kjo e afron poezinë e saj shumë pranë lexuesit, duke ndezur brenda shpirtrave të tyre llavën meditiative. Në themel të poetikës së saj qëndron bota njerëzore, me gëzimet dhe shqetësimet e përditshmërisë së sotme. Meritë e veçantë e saj është se në pak vargje, rrokëzon një mendim të qartë filozifik. Vargu i përzgjedhur dhe figuracioni mbreslënës plot metafora, krahasime, epitete, kontraste, antiteza, paralelizma figurativë, qëndon në çdo fjalë të poezive të saj, ndërkohë që poezia e saj lëviz midis përditshmërisë dhe fiktionit. Poezia e saj është një mozaik i vargëzuar, ku çdo gur poetik i këtij mozaiku është përzgjedhur me shumë finesë nga autorja dhe ka përbrenda botën e gjithësecilit prej nesh. Me një figurshmëri të përzgjedhur dhe një trill magjik impresionues, Zalloni zbulon nga bota e saj shpirtërore, dëshira, iluzione, pasione, tradhëti, zhgënjime, të cilat shërbejnë si prognozë për të zbuluar realitetin e kohës dhe të shoqërisë helene. Bën autopsinë e përditshmërisë së saj poetike. Janë vjersha të thella në mendime dhe të zjarrta në ndijime. Gjithë poetikën e saj, Zalloni e kërkon tek harmonia, ndijimshmëria dhe magjia e fjalës. Si e tillë ajo ka punuar shumë për t'i shkruar këtë vjersha. Për t'i bërë sa më të bukura ajo i kushtuar rëndësi të veçantë gjuhës emotive dhe asaj referenciale. Ka përzgjedhur nga arkivi gjuhësor fjalët më pikante me ngjyresa stilistike, për ta dhënë sa më qartë dhe sa më bukur vargun, kuptimin dhe mesazhin. Ka punuar jashtëzakonisht edhe për formës dhe përshkrimin e detajeve. Poezitë e saj janë pjellë e përvojës së saj vetjake dhe vëzhgimeve që ka bërë. Nga forma, stili dhe rrëfimi interesant, ajo krijojn tek lexuesi i çdo kohe një gjendje të theksuar përjetimi dhe reflektimi, duke ngjallur shije e gjykime të ndryshme morale dhe estetike. Në poezitë e saj, nga njëra anë kemi shpirtin romantik dhe sentimental të autores, me idilet romantike dhe pasionante të femrës-poete, nga ana tjetër kemi shqetësimet dhe revoltën e saj për gjithçka që turbullon paqen, lumturinë dhe lirinë njerëzore. Vënien përballë të këtyre dy gjendjeve, ajo e bën duke përdorur ironinë, kontrastin, simbolin, metaforën dhe paralelizmin figurativ. Shiko sa bukur e jep kontrastin midis poezisë dhe parasë: "Flemë me poezi/ Dhe me dritare të hapura/ Nuk kyçemi bashkë me monedha të arta". Pra, poezinë, ajo e sheh si një mjet që sjell lumturi dhe paqe në shpirt, ndërsa paranë si diçka që të mbyll përbrenda frikës dhe vetmisë. Si shkrimtare lirike, ajo u dha ka dhënë poezive të saj një formë epopeje të harmonishme, me një përmbajtje njerëzore, morale dhe shpirtërore duke i ngritur në një rrafsh shumë më të lartë estetik me gjinitë lirike të së kaluarës. Poetikën e kërkon tek harmonia, kurse mesazhin tek ndërthurja e vargjeve dhe përzgjedhja e tekstit si "dokument historik" dhe si vëzhgim realiteti. Mesazhi tjetër që përçon, është, se veprimet tona shpeshherë na çojnë drejt fatalitetit të jetës. P.sh. "Mos fluturo sërish kaq lart/ Do të thyhen krahët nga ikja". Poezitë e saj, janë poezi të përjetimit shpirtëror dhe të forcës së fantazisë, sepse edhe vetë krijuesja e tyre është një fantazi e gjallë, dëshirë në vlim, një shpirt e zemër që shpërthen në çdo rrahje. Ajo e di se e vetmja rrugë shpëtimi larg jetës monotone dhe larg botës tragjike të njerëzve është vetëm pasqyrimi i jetës përmjes artit. Këtë sentencë historike, ajo e ka bërë pjesë të botës së saj poetike për afro 50 vite me radhë, ndaj dëshiron t'ua përcjellë edhe të tjerëve përmes vargjeve: "Këndoje këngën tënde në violinçelin e poezisë/ Mos e lejo kaosin të të përpijë". Poezia i saj rrjedh si vetë bota shpirtërore e saj. Një shpirt i sunduar nga ndjenja e së mirës dhe preokopimet njerëzore. Tek vargu, ajo ka gjetur burimin e pashtershëm, ku ndez pasionin, por edhe shkrin akujt e dëshpërimit dhe të dhimbjes, prandaj ajo thotë: "Dëshira ime ta shoh botën/ Më lart se dielli/ Dhe të rrethuar prej dritës së poetëve".

KUSHTON SHTRENJTË TË DASHUROSH!

Pothuajse të gjitha pozitë e saj, kanë udhërrëfyes dashurinë për jetën, për njëri-tjetrin. Ky lejtomotiv shoqëron pothuajse të gjithë veprat e saj. Këtë mesazh ua jep edhe të tjerëve me figura të zgjedhura artistike, plot epitete, krahasime dhe metafora. "Vargjet e mi,/ xixëllonja në udhëtimin tim,/Kurse pamja jote,/ Karficë në ylberin tim". Dashuria, për të nuk është një ndjenjë që fitohet dhe ruhet lehtësisht. "Kushton shtrenjtë të dashurosh, shtrenjtë/ Harxhon më kot gjërat e tua të shtrenjta", -shkruan Zalloni. Në këto pak rreshta është një filozofi e tërë amendimi, ku në sentencë figurative, qëndron testamenti i vargjeve të saj: "E pafund kënga e dashurisë/ Dhimbja gjithashtu". Shiko se me ç'forcë sintetike dhe filozofike e përshkruan ajo dashurinë në vargjet "Ka përherë vend në reanimacion/ Pë ata që i përvëlon dashuria". Efektin dhe forcën madhe të dashurisë e gjejmë edhe në vargjet ladidare të saj: "Dashururuam!/Jetën dhe vdekjen nështruam./ O! Mrekulli e paarritshme! Në saj të kësaj force "E pamundura është e mundur/ Falë ëndrrave të natës". Si përfundim, Panajota Zallonit, vjen në trojet shqiptare, si një dallëndyshe, duke ngritur strehëzën e saj në shpirtrat e qindra lexuesve shqiptarë, për të mos u shkëputur më kurrë prej tyre. Tashmë, listës së gjatë shkrimtarëve të shquar në Shqipëri, u është bashkangjitur edhe emri dhe vepra e saj poetike falë përkthimit mjeshtror të z. Iliaz Bobaj.

** Master Shkencor në "Studime Letrare"*

Rruga e Arbërit nr. 81

përkthim

Ramiz Gjini vizitoi këtë muaj Shqipërinë, dhe për herë të parë, prezantohet në gazetën tonë me një përkthim nga shkrimtarja bashkëkohore ***Ursula Wills-Jones.***



Vusi Makusi

Tregim nga ***URSULA WILLS-JONES***

Vusi Makusi edhe pse jetonte ne vendin më të varfër të botës dhe kishte si pasuri vetëm një kostum me pantallonat që nuk i mbërrinin as tek kërci i këmbës, ishte optimist i madh.

Pasi u edukua në shkollë, Vusi Makusi mendoi që po të punonte në shërbimin civil do të bënte karrierë të madhe.

Por sapo zyrtari i lartë, i hodhi Vusit vështrimin e parë, e kuptoi menjëherë që kurrë nuk do të mbërrinte të bënte ndonjë gjë për të qenë.

- E di çfarë, - i tha ai Vusit, - Hë për hë, unë kam vetëm një punë për një njeri me ambicie të madhe, kështu që po ta jap ty ta bësh.

Menjëherë pas kësaj, Vusi e pa veten në një autobus që kërkëllinte, luhatej e kërcente nëpër gropat e rrugës duke hyrë thellë e më thellë në xhungël derisa mbërriti në destinacion, një vend – kënetë, i rrethuar nga një pyll i madh kodrinor.

- E marr vesh që mbërrita, por nuk po shikoj dot ku është fshati, - tha Vusi.

Shoferi i autobuzit bëri me gisht në drejtim të vendit ku gjendej fshati.

- Çfarë dite do kthehet sërish autobuzi? -pyeti Vusi.

- Të shtunën, - ia futi kot shoferi.

Vusi kishte njëzetë orë që u fliste pasagjerëve për detyrën e tij të re dhe shoferi, pikërisht për këtë qe mërzitur.

Hyp e zbrit Vusi nëpër kodrat e fshatit dhe më në fund e mbajti frymën tek kasollja e kryeplakut. Si trokiti në derë u ul të priste. Në fare pak kohë, gjithë katundarët ia behën aty e nisën ta shqirnin me sy. Kur kryeplaku doli jashtë, Vusi u ngrit menjëherë në këmbë.

- Zotëri i mirë, - nisi të fliste Vusi, - Unë jam drejtuesi i ri i kësaj krahine i emëruar nga qeveria demokratike. Kam ardhur t'ju sjell paqe, prosperitet, unitet, zhvillim dhe edukim për njerëzit. Kam ardhur t'ju tregoj dashamirësinë dhe zemërgjerësinë time të madhe, që nënkupton rrugë të asfaltuara, shkolla të bukura, drithëra të bollshme, ujë me bollëk, traktora, mësues dhe doktorë. Shkurt muhabeti, mjafton që unë të bëj gati një listë me gjithshka ju duhet, dhe kjo punë merr fund.

I pari i katundit i nguli njëherë sytë Vusit, pastaj përnjëherësh ia dha gazit me të madhe; ha-ha-ha-ha… Ahhhhhh-ha-ha-ha-ha… Edhe të pranishmit aty rrotull, aq shumë u gajasën sa për të mos u plandosur përtokë, filluan të mbaheshin tek njëri-tjetri.

- Or çun, - tha së fundi i pari i katundit. - Për besë, na kënaqe! Që kur pati kaluar këtejpari një trupë estrade, asht' ba bajagi kohë pa qeshur kësisoj…

- Por unë e kam krejt seriozisht, zotëri! -tha Vusi.

Kësaj here, kryeplaku, qeshi aq shumë sa u rrëzua e ra në kokërr të shpinës.

- Or ti çun! - tha ai ndërsa fshinte lotët e përpiqej të ngrihej, - A nuk shikon që të respektueshmen nënën time, në moshën 83 vjeçare e kapën dhimbjet prej gazit. Mos do që kjo grua e vjetër, larg qoftë, të thyejë edhe brinjët?

Atë natë Vusi hëngri një darkë speciale dhe e mbushi mirë barkun. Ditën tjetër, nisi t'i binte rrotull katundit me një bllok në dorë duke pyetur e shënuar aty kërkesat që bënin banorët, të cilët, ç'është e vërteta, filluan të mërziteshin.

- Ai është padyshim një i shkalluar, që e kanë përzënë prej qytetit, - tha prifti.

- Është spiun dhe mos e diskuto. Po fut në listë gjithshka duan të na vjedhin, - tha gruaja e kryeplakut.

- Unë mendoj që ai do ketë ngrënë ndonjë goditje me çekiç pas koke, prandaj dhe është pak si i marrun mendsh, - tha farkëtari.

Kur njëzetë e tetë ditë kishin kaluar, Vusi i bëri një vizitë kryeplakut. I shpjegoi, që kishte punuar katër javë rresht, ndaj i duheshin tetë ditë pushim për të shkuar e për të parë nënën e tij të vjetër. Gjithashtu ai iu lut t'i huazonte çadrën dhe i premtoi që sapo të merrte pagesën e parë nga qeveria e sapoardhur në pushtet, në vend të së vjetrës, do t'i blinte një çadër fringo të re.

Kryeplaku i shtrëngoi dorën dhe pranoi t'ia jepte çadrën. Vusi iu lut gruas së kryeplakut që t'i huazonte edhe një batanije dhe ajo ia dha. Ngase do t'i duhej të bënte rrugë të gjatë e plot rreziqe mes shkurrnajave për të mbërritur deri tek stacioni i autobuzit, Vusi vajti tek farkëtari dhe iu lut për një thikë. Kështu, ai u nis për udhë duke mbajtur në dorë një valixhe shkatërraqe.

- Nuk bën kështu, - tha kryeplaku, - Dikush duhet t'i thotë, që autobuzi nuk vjen kësaj ane.

Pritën sa pritën dhe më në fund qe farkëtari ai që mori i pari rrugën poshtë luginës për ta bindur Vusin, që autobuzi nuk do të vinte. E gjeti Vusin teksa priste në stacionin e pluhurosur.

- Jam i sigurtë, që autobuzi do të vijë shumë shpejt, - i tha Vusi farkëtarit.

Si kaluan dy ditë, vajti vetë kryeplaku ta bindëte Vusin, që autobuzi nuk vinte, por teksa u kthye, ai hapi krahët për të lënë të kuptohej se nuk kishte pas ç'ti bënte.

E provoi edhe prifti, por edhe ai pa sukses.

- Kaplloqja e tij ka imunitetin e budallait, nuk i ban asgja logjika, - tha gruaja e kryeplakut. - Unë them më mirë ta prekim në zemër, ose, si të thuash, ta qorrollepsim. T'i dërgojmë vajzën e poçarit, sepse ajo është më e bukura e kësaj nahije dhe ndoshta do ta bindë.

Vajza e poçarit vajti, por edhe ajo, me t'u kthyer ngriti supet e tha se nuk shpresonte se do ia dilnin për ta bindur Vusin të largohej nga stacioni.

- Të dërgojmë mbesën e priftit, - propozoi farkëtari. - Ajo vërtet nuk është dhe aq e bukur, por është e zgjuar ama, ka mprehtësi në mendime dhe është shumë e zonja në fjalët që përdor.

Kësisoj, fshatarët nisën drejt Vusit njërën pas tjetrës të gjitha gratë e reja e të bukura derisa mbeti vetëm një e fundit, as e bukur, as e shëmtuar.

- Në rregull. Le ta provojë njëherë edhe ajo, - tha kryeplaku teksa i hapej goja. Dhe vajti të shtrihej, të merrte një sy gjumë.

Vajza u derdh rrugës tatëpjetë luginës shumë e zemëruar për faktin pse e kishin konsideruar budallaqe duke e nisur të fundit në drejtim të Vusit, prandaj me ta parë, e gjuajti gjithë urrejtje me një farë nga fruti i mangos.

- O Idjot! - briti ajo. - O i dalun mensh! Ta dish që çfarëdo të bësh, nuk do më bëhet hiç vonë. A mendon se njerëzit do e kenë mendjen tek ti po të rrish këtu derisa të bëhesh gur?

Ngase qe dëshpëruar shumë, ajo u shkreh menjëherë në lot.

Vusi e pa njëherë drejt në sy, pastaj shumë i prekur vajti e ra në gjunjë para saj.

- E dashur zonjushë! - nisi të fliste ai. - Ky shpërthim emocionesh nga ana jote, vjen ngase i ke ndrydhur brenda shpirtit tënd për një kohë të gjatë. Nëse unë të jam dukur i pavëmendshëm, kjo ka ndodhur sepse ti, nuk më ke dhënë asnjë shkas për të më treguar se më do. Po ta dija që ndjen për mua, kurrë nuk do isha treguar indiferent. Por tani u lumturova, sepse për mua ky është një lajm fort i mirë. Kur autobuzi të vijë dhe unë të shkoj tek nëna, do t'i them se falë Zotit, kam gjetur gruan time të ardhshme. Deri atëherë, do të tregoheshe shumë e mirë nëse do rrije për pak kohë me mua.

Derisa kjo qe një ndodhi e përjetuar, më e mirë nga ato që rrëfehen me fjalë, vajza mendoi të qëndronte pak kohë me Vusin. Pas kësaj, Vusi nisi t'i tregonte për të ardhmen, sa e bukur do të ishte ajo. I foli për traktorë, klinika mjekësore e dentare, shkolla dhe pompa uji, lopë të shëndetshme e pulari për mish e vezë; i foli për stacione televizive, banjo të pastra, zyra, telefona, rrugë të gjera e të asfaltuara, aeroplanë që shkojnë e vijnë, ndërtesa të larta dhe autobuzë, që ndalojnë gjithandej nëpër stacione duke përshkuar vendin nga të katër anët. Dhe të gjitha këto, do të bëheshin të mundura prej Vusit.

Në mëngjes, filloi të binte shi. Vusi hapi çadrën e kryeplakut, ndërsa shiu binte e binte papushim. Një majmun i vogël me lesh të kuq, u shfaq matanë rrugës. Dukej i trishtuar dhe në vetmi të plotë.

- Shiko atje, - tha Vusi. - Edhe majmuni po pret të vijë autobuzi.

- Si është e mundur, sepse ai nuk ka ndonjë trastë apo valixhe, - tha vajza.

- Ke të drejtë, - pranoi Vusi, - Ndoshta pret të afërmit që t'i vijnë me autobus.

Pas pak majmuni filloi të dridhej.

- Vusi, - tha vajza, - Ose ftoje majmunin të vijë me ne nën çadër, ose përzije prej aty. Nuk e shikoj dot më gjatë atë fytyrën e tij kaq të trishtuar.

- Patjetër që mund të vijë të futet nën çadër, - tha Vusi. - Edhe ai është një qytetar i nderuar i vendit tonë të madh e të mrekullueshëm.

Kësisoj, majmuni, vajza dhe Vusi u mblodhën nën të njëjtën çadër. Ndërsa shiu vazhdonte të binte, një hurdhë e madhe u krijua para tyre në luginë.

- Natyrisht, që qytetarët e një vendi të madh, nuk mund ta presin autobuzin duke u lagur në shi. - tha vajza. - Përderisa ti je i dërguari i qeverisë, sa kohë që presim autobuzin, mund të shkosh të gjesh ca degë dhe të bësh me ta një kasolle në stacion. Ky do të ishte një shërbim në dobi të të gjithë njerëzve.

- E kuptoj që ti nuk qenke vetëm një bukuroshe, - tha Vusi duke miratuar me kokë. – Atëherë, do të bëjmë kështu: nëse autobuzi vjen ndërkohë që unë po pres ca degë për të ndërtuar kasollen, ma lësho një zë; sepse nuk dua të më ikë autobuzi dhe të humbas shansin për të parë sa më shpejt nënën time.

Kështu Vusi mori thikën, preu degë dhe ndërtoi kasollen.

Ata të dy rrinin në pritje të autobuzit brenda kasolles, kurse majmuni, qe ulur e rrinte mbi cati.

Një tjetër ditë kaloi, pastaj një tjetër e një tjetër…

Ndërkohë shiu kishte pushuar. Pastaj kaloi njëherë aty pari kryeplaku i katundit, i përshëndeti me kokë dhe iku në punë të vet. Hurdha para tyre nisi të bëhej më e madhe. Vusi kapi një peshk që ta hanin për darkë. Asnjë këmbë tjetër njeriu nuk kaloi në rrugë. Asnjë për be.

Vusi dhe vajza, prisnin në kasolle. Aq shumë pritën sa vajza lindi një fëmijë.

- Sa e lumtur do të jetë nëna ime kur të shikojë fëmijën, - tha fort i gëzuar Vusi.

- Sigurisht, i dashur bashkëshorti im, - tha gruaja. - Njerëzit do të presin autobuzin këtu bashkë me fëmijët e tyre. Unë mendoj se do të qe mirë sikur të kishim edhe një dhomë shtesë ku të shtriheshin për të fjetur të qetë.

Vusi mori thikën dhe preu degë të tjera. Kësisoj ai shtoi edhe një dhomë tjetër. Jashtë dere, farat e mangos mbinë dhe filluan të rrisnin gjethet e tyre. Një majmun i dytë iu bashkua të parit. Shumë shpejt ata u bënë me një këlysh të vogël. Ndërsa shiu binte e binte papushim, lumi u mbush e u fry si kurrë ndonjëherë.

- Vusi! - tha gruaja. - Një ditë ky vend do të jetë një

tregim

stacion i madh autobuzësh. Shumë udhëtarë do të shkojnë e vijnë, do të duan të hanë e pinë, prandaj kemi përpara një shans të madh për të bërë tregëti. Këtu rrotull gjendet mjaft tokë për të mbjellë misër, me të cilin, do të prodhojmë birrë. Atëherë, ti nuk do të jesh më vetëm një punonjës i shtetit, dhe unë gjithashtu, do të jem një tregtare e suksesshme.

Kështu ajo punoi tokë anash lumit dhe mbolli pemë e zarzavate, pra ndërtoi një kopësht. Pastaj vajti në kasolle ku lindi një tjetër fëmijë.

- Unë mendoj se e kam kuptuar gabim atë zotërinë e autobuzit, - tha Vusi një ditë. - Me siguri, nuk do jetë e shtuna dita që vjen autobuzi, por mund të jetë muaji janar i çdo viti. Dhe, ngase për tre vjet nuk ka mbërritur këtu asnjë autobuz, mendoj se ata do të vijnë që të tre njëherësh. Ky është një zakon i famshëm shoferësh autobuzi, një zakon, që e dinë të gjithë.

- Vusi, - tha Vajza. – Nëse vijnë tre autobuzë njëherësh plot me njerëz, unë nuk kam mjaft ushqim për t'u dhënë. Vec kësaj një restorant i mirë duhet të ketë shumë lloje pjatash. Shko në xhungël dhe kap nga ato shpendët e mëdha në ngjyrë hiri, që i kemi parë njëherë. Unë do t'i mbarshtoj dhe kështu do kemi mish për të gjithë.

- Kjo është vërtet një ide e mirë, ndaj po nisem menjëherë, - tha Vusi. – Por, nëse autobuzi vjen dhe unë vazhdoj të jemë në xhungël, u thuaj njerëzve të presin.

Vajza u ngul në pritje anës rrugës, por asnjë autobus nuk erdhi. Madje as banorët e fshatit nuk u dukën më asaj ane.

Pas pesë ditësh, Vusi u kthye te kasollja duke mbajtur në duar dy pula hini të egra.

- A nuk e kam humbur autobuzin? -pyeti i merakosur Vusi.

Gruaja e siguroi që nuk e kishte humbur.

- Koha po mban shumë e keqe, - tha Vusi, - prandaj kam frikë se asnjë autobuz nuk ka për të ardhur këtë vit. Megjithatë, do të qe e turpshme të mos prisnim edhe pak. Aq më tepër, nuk do të qe mirë ta linim këtë vend tani që kemi bërë rreth kasolles gjithë ato modifikime për hotel dhe restorant.

Edhe një vit tjetër kaloi.

- Vusi, - tha vajza. - Duhet të ndërtosh një gardh, që pulat e hinit t'i mbajmë brenda. Nuk do jetë mirë po na i shtypi autobuzi.

Sërish, iku dhe një tjetër vit.

- Vusi, - tha vajza, - Peshqit nuk jetojnë po nuk patën ujë. Çfarë do të ndodhë nëse autobuzi vjen dhe unë nuk kam as edhe një peshk të vetëm? Me çfarë do i ushqejmë pasagjerët? Duhet rrethuar me gardh një vend brenda lumit, që të kemi mundësi të mbajm aty peshq të gjallë.

Një tjetër vit kaloi dhe e shoqja lindi edhe një tjetër fëmijë.

- Sigurisht, ky shërbim urbanistik është i papranueshëm, - tha Vusi një ditë. - Kur autobuzi të vijë, të na marrë e të na dërgojë në qytet, do kem shkruar një letër për ministrin e transportit. E vetmja gjë e mirë, grua e dashur, është se paratë e rrogës time që si kam marrë asnjëherë sa vijnë e shtohen në bangë.

Një tjetër vit kaloi dhe autobuzi sërish nuk erdhi. Ndërkohë mangot qenë rritur e dhanë prodhim të bollshëm. Ata kishin pritur shumë gjatë. Vusi nisi të merakosej sepse djali i tij i madh qe në moshë për t'u martuar. Pastaj, erdhi një ditë kur një zhurmë e panjohur nisi të dëgjohej nëpër xhungël. Jehona e kësaj zhurme përplasej gjithandej.

- Autobuzi! Autobuzi! - thirrën fort përnjëherësh fëmijët e vegjël të Vusit, të cilët, e kishin përfytyruar autobuzin mu si një përbindësh.

Rreth majës së kodrës, u shfaq një helikopter me shkronjat "UN" anash tij. Pastaj helikopteri u ul mu në mes të rrugës dhe që brenda tij dolën jashtë katër ushtarë të nervozuar që nisën të kontrollonin zonën me shumë kujdes. U panë edhe dy të tjerë si punë shkencëtarësh, sepse qenë veshur me pardesy të bardha, mbanin letra nëpër duar, kurse turinjtë, ata i kishin mbuluar me maska higjenike. Në fund fare, ia behu një politikan i veshur me kostum e duke mbajtur me dorë një shami tek hundët. Të gjithë ia ngulën sytë Vusit, gruas së tij dhe shtatë fëmijëve.

- E shikoj, - tha Vusi. – Ata kanë përmirësuar shërbimin. Në mungesë të autobuzëve, kanë sjellë helikopterë. Prandaj dhe na u desh që të prisnim kaq gjatë.

- Çfarë dreqin bëni ju këtu?! - pyeti politikani.

- Po presim për autobuzin që të vijë, - tha qetë-qetë Vusi.

- Por, si arritët t'i shpëtonit luftës civile? - pyeti një gjeneral.

- Luftë civile?! - pyeti i habitur Vusi.

- Po, luftë civile. Lufta që fshiu nga faqja e dheut gjysmën e popullsisë, - tha politikani.

- Por ne, as që kemi parë me sy ndonjë ushtar! – tha Vusi duke luajtur edhe kryet.

- Edhe nëse keni mundur t'i ikni luftës civile, - tha gjenerali, - si keni mundur t'i shpëtoni krizës për bukë, që bëri të vdisnin gjysma e atyre që mbijetuan nga lufta?

- Krizës? Çfarë krize?! - ia bëri gjithë habi edhe gruaja e Vusit, ndërsa hodhi vështrimin mbi pemët plot me kokrra të mangos dhe mbi kotecin e madh ku mbante pulat e hinit.

- Në rregull, - foli njëri nga shkencëtarët. - Edhe nëse i keni mbijetuar luftës dhe krizës së bukës, si është e mundur t'i keni mbijetuar virusit?

- Virus?! - pyeti i habitur Vusi. – Për çfarë virusi e keni fjalën, zotëri?!

- Virusit vdekjeprurës, që dërgoi në botën tjetër të gjithë ata që mbijetuan nga lufta dhe kriza e bukës, - tha shkencëtari i dytë. - Virusit, të cilit, askush nuk mund t'i shpëtojë, përveç ndonjë rasti të rrallë e të jashtëzakonshëm mbijetese në prag të zhdukjes të ndonjë majmuni qimekuq.

Ato çaste, majmuni i vogël qimekuq, u ngjit me një kërcim mbi supin e Vusit, ngriti veshët dhe nisi të shikonte e dëgjonte me shumë familjaritet. Por Vusi e largoi me një lëvizje instiktive të dorës, pa e patur fare vëmendjen tek kafsha.

- Ju thatë se ky është një virus i tmerrshëm? – pyeti Vusi. – Për zotin, o zotëri, unë nuk mbaj mend të ketë qenë sëmurë ndonjëri prej nesh.

- Vusi! - i thirri gruaja ndërsa e preku në sup, - Ftoi të rrinë për darkë. Çfarë pret? Do të jenë klientët tanë të parë.

- Natyrisht, - tha Vusi. Dhe duke u kthyer nga të ardhurit tha: - - Epo, urdhëroni…! Mirë se na erdhët zotërinj! Çfarë dëshironi? Doni t'ju servirim peshk, apo pula hini?

Politikanët, shkencëtarët dhe ushtarët dukeshin shumë të frikësuar, ndaj deshën të sprapseshin drejt helikopterit.

- Ne do largohemi prej këtu, - tha prerë gjenerali.

- Do ju marrim edhe ju me vete, - tha politikani. - Do të keni ndihmë mjekësore, asistencë, përkujdesje, rroba të pastra, shtëpi, dritë elektrike, - gjithshka ju duhet. Veç kësaj, do të bëheni të famshëm sepse gazetarët do ju marrin në intervistë.

- Përse të gjitha këto, zotëri? - pyeti Vusi me shumë edukatë. – Ne ju falënderojmë shumë, që dashkeni të na bëni gjithë këto të mira, por nuk mund të largohemi prej këtu. Na duhet të presim autobuzin. Megjithatë, do ju lutesha vetëm për një favor, nëse mund të na e bëni. A keni një letër dhe një laps?

Ata ia dhanë, edhe letrën edhe lapsin.

Vusi u ul kacipup dhe shkruajti një letër të vogël në adresë të ministrit të transportit, ku ankohej për nivelin e ulët të shërbimit të autobuzëve në zonat me fshatra dhe ia la atë në dorë politikanit.

Pasi helikopteri qe larguar, Vusi u duk paksa i mërzitur.

- Uri, luftë, sëmundje… - tha ai. - Jam i sigurt që të gjitha këto nuk mund të ndodhin në vendin tonë të bukur.

- Zakonisht, ato gënjejnë, - tha gruaja. - prandaj, hajde të ngjitemi në majë të kodrës dhe të shikojmë me sytë tanë çfarë po ndodh në të vërtetë.

Vusi me të shoqen morën përpjetë duke ecur në një rrugë të vjetër, që nuk ishte shkelur për shumë vite. Një rrugë copë-copë, gjithë gurë dhe vende-vende e plasaritur. Në fund, kur ata kishin mbërritën në majë të kodrës, panë në distancë një tokë të shkretuar me pemë të rrëzuara, tanke të djegur, fshatra të rrënuar dhe të mbjella të braktisura.

U kthyen në shtëpi që të dy, të zënë dorë për dore. Gruaja nisi të përgatiste ushqimin e darkës, kurse Vusi, zuri vend ulur rrafsh në dyshemenë e kasolles me fëmijët rreth tij. Dukej i qetë, por i zhytur në mendime të thella. Në fund ai foli:

- Moj grua, - tha ai. - e di që ka ndodhur, që disa njerëz, më kanë konsideruar si budalla. Ama kur e mendoj, të betohem në zot, që gjithshka kam bërë, më ka dalë për mirë.

Dhe u shtrua të hante me shumë oreks një pjatë të madhe me mish të pjekur pule.

Përktheu nga anglishtja:
Ramiz GJINI

DUART

Kujtimit të paharruem të Vexhi Hoxhës

Nga **ILIR SPATA**

Më plakën vitet, dekadat kaluar;
Jetoj të sotmen, me t'shkuarën flè.
Në mendje më rrinë, s'harroj ato duar,
Pëllambën e kthyer e gishtat me dhè!

Sa herë në fund rruge i lodhun, këputun,
I mora lart Bokat me hypë në krye!
E gjeja Vexhiun tek gropa i futun
Tek dheun e zgjidhte për tjegulla çatie!

Pa zija në anë e flisnim për hallet;
Shkërmoqte me duar Ai dheun e butë.
A bante, a s'bante i vrisnim rradaket?
Mua sytë e mbetun n' pëllambët kthye krrutë!

Gishtërinjtë tanë kallo nga prapa përthyer!
Pëllamba e ashpër nga puna e ngranë!
Unë flisja me të me sytë mbërthyer
Mbi dheun e shkrifët që derdhej mbi pëllamë!

Sa herë me të e hapëm, liruam,
Kanalin e krojeve bllokue me rranjë?!
Me të e me Zitin së bashku punuam
Me ditë e me javë, sa t' rejat u banë!

Me të në natën e fundit u ndava;
Mendova ja hodhi se fliste açik?
Pëllambët në dorë ja mora, qetova,
Pa ditun se ndarja kish qanë ai dekik?!

Sa herë e kujtoj fytyrën e rrudhun
Më dalin dy duar gjithë kallo, përthyer!
Pa to portreti i plotë nuk do dilte
Qëllimi i jetës do ngelej pa kryer!

Unë larg nëpër Botë Ai tretet ndën dhé!
I miri, i drejti, kushërini Vexhi!
Një mall më ngërthen, ca lotë rrëkè
Simbol sakrifice, mundimi, NJERI!

JEPET ME QIRA
mjedis **300 m2,**
pranë Kombinatit të
Autotraktorëve.
E përshtatshme për çdo
lloj aktiviteti.
Lartësia e katit 5 m.
Mjedis edhe për zyra!
Linjë trefazore elektrike
në dispozicion!
Rruga e shtruar
me asfalt!
Të interesuarit të
komunikojnë me tel:
069 20 68 603

Homazh për një nga korifenjtë e vërtetë të kulturës
dhe arsimit kombëtar në Dibër


Xhemal Berisha, dishepull i dijes

Nga **HALIL RAMA, NAIM BERISHA**

Rallëherë ndodh që në ceremoninë lamtumirës të një intelektuali të ketë aq shumë njerëz sa ç'pati në përcjelljen e mësuesit të merituar, Xhemal Berisha. Kortezhi i gjatë në 10 km rrugën nga Muhurri në Peshkopi përmbante qindra autobusë e furgona me mijëra qytetarë dibranë. Një përcjellje siç e meritonte një nga korifenjtë e vërtetë të kulturës dhe arsimit kombëtar në Dibër. Zakonisht, në të tilla ceremoni, gjithkush për të ndjerin flet fjalë të mira, por rrallë ndodh që gjithkush të përjetojë vlera dhe mirë si nga vetë ceremonia. Natyrisht, është vlerë numri aq i madh i njerëzve që erdhën për ngushëllim, shumicë që nuk u pakësua as në varrimin e tij. Kjo për faktin se personaliteti i Xhemal Berishës, kudo dhe në çdo rrethanë reflektonte vlera, për të cilat ishte e etur shoqëria jonë. Qe një njeri me nivel të lartë në të gjitha dijet, një filozof dhe psikolog, mësues dhe edukator shembullor, që, gjithkujt i duhet në ditë të vështira. Xhemal Berisha, njëri nga veteranët më të vjetër të kulturës dhe arsimit kombëtar u nda nga jeta pak kohë më parë, me 15 nëntor 2012, në moshën 84-vjeçare. Tregimi i plotë për Xhemal Berishën nuk ezaurohet, ndoshta, as dhe me një libër të tërë, ndërsa sot ne po bëjmë vetëm një paraqitje të shkurtër, për të krijuar një përshtypje rreth tij tek të gjithë ata që nuk e kanë njohur nga afër. Megjithëse jetim, për nënë, qysh në moshën foshnjore, me gjithë vështirësitë e panumërta ekonomike të familjes, tek ai spikati që në fëmijëri zelli dhe vullneti i madh për shkollën, për librat dhe dituritë. Shokët e tij të shkollës së fillores, (në Thanxë, Fushë–Muhurr) e tregojnë atë si një fenomen, që i kalonte shkëlqyeshëm dy klasa ose, më saktë, dy vite për një vit, (atëherë lejohej). Si kreu klasat më të larta, ai vazhdon të mermen pedagogjike, Normalen e Elbasanit, të cilën e përfundon shkëlqyeshëm, me të gjitha pesa, sepse pesa ishte nota maksimale. Pas disa roleve të ndryshme si nëpunës, vrik dolën dukshëm në pah tek ai, aftësi të drejtuese në fushën e kulturës dhe të arsimit.

Në vitet pesëdhjetë, Xhemal Berishën e shohim si drejtorin e parë të shtëpisë së kulturës "Haki Stermilli", në qytetin e Peshkopisë për qarkun Dibër e Mat.

Në vitin 1957, mbaron shkëlqyeshëm shkollën e lartë ushtarake, të Bashkuar në Tiranë, ku ish i vetmi kursant që u diplomua "nëntoger", kur gjithë të tjerët diplomoheshin si aspirantë. Edhe këtë, përveç diplomës e dëshmojnë dhe sot e kësaj dite ish-bashkëstudentë, bashkëfshatarë të tij, si Rushit Çiku e të tjerë. Por Xhemal Berishës iu desh të ankohej deri te ministri i Mbrojtjes



Xhemal Berisha

për ta braktisur ushtrinë dhe për t'iu vënë seriozisht studimeve të tjera. Kështu, në vitin 1959, Xhemal Berisha vazhdon studimet filologjike në degën e Historisë në Universitetin Shtetëror të Tiranës.

Në vitin 1963 përfundon studimet me rezultatet maksimale, shkëlqyeshëm, ku në librezën e tij të notave, gjithkush mund të shohë edhe sot, se nuk figuron as edhe një notë më poshtë, përveçse të gjitha notave maksimale.

Rrallë dëgjojmë për ndonjë intelektual të njohur se ka mbaruar me të gjitha notat maksimale dhe nuk e vënë aspak në dyshim, por të jemi të sinqertë, me të dëgjuara i kemi, ndërsa për njeriun në fjalë, për të gjitha rezultatet e tij dhe në të gjitha shkollat, për aq sa thamë më lart, ne jemi dëshmitarë dhe flasim me përgjegjësi, sepse të gjitha dokumentet e tij ne i kemi parë me sytë tanë, madje jo vetëm një herë.

Me të mbaruar Universitetin, shkolla dhe institucione të tjera në kryeqytet i ofruan menjëherë vende pune, por as ai vetë dhe as rrethi nuk pranuan.

Në Dibër, emërohet kryeinspektor i arsimit dhe kulturës, ku u shqua për një punë model, për një figurë dhe sjellje shembullore. Mirëpo më të aftët, pothuajse si kudo në botë, bëjnë shpejt reaksion tek karrieristët dhe ziliqarët dhe Xhemal Berisha me iniciativën e tij, ndonëse i zhgënjyer, e braktis atë detyrë, në mes të qytetit të bukur të Peshkopisë dhe, përgjithmonshëm, i drejtohet fshatit.

Ai shkon si drejtor shkolle në një nga zonat më të vështira, por, njëherësh, më kulturëdashëse dhe më prestigjioze, në Fushë-Çidhën, ku ishte edhe dhëndër. Pastaj e shohim si drejtor shkolle në Vakuf, në trevën e Kastriotit, më pas sërish si drejtor i shkollës së parë të mesme në vendlindjen e tij, në Fushë-Muhurr dhe më pastaj, megjithëse në prag të moshës së pensionit, ai, çuditërisht, me dëshirën e tij, ngjitet dhe punon si drejtor i shkollës në zonën më malore, në Hurdhë-Muhurr, ku dhe e mbyll karrierën e tij të gjatë 45-vjeçare në arsim, duke dalë në pension faqebardhë e suksesshëm si rrallëkush më parë.

Personaliteti i tij, kudo dhe në çdo rrethanë reflektonte vlera

Intelektualë më në zë, jo vetëm të Dibrës, por nga i gjithë vendi e vlerësojnë Xhemal Berishën si një dishepull të dijes dhe simbol të filozofisë dibrane. " ...Për Xhemal Berishën jemi krenarë edhe ne që nuk patëm fatin të punojmë me të",- shprehet Gezim Alpion, pedagog ne Universitetin e Birmingemit, Angli.

Ndërsa publicisti i njohur Abdurrahim Ashiku vlerëson se "Xhemal Berisha ishte dhe një studiues i zoti. Sa e sa herë ka kumtuar në sesione shkencore! Motra e tij, Sania, ishte njëra nga pesë vajzat e para, që theu akullin e zi shekullor për gratë dhe vajzat dhe mbaroi pedagogjiken e Peshkopisë në vitin 1959. Xhemali ishte një njeri shumë më i përparuar se koha që jetoi".

Murat Koltraka thotë se "Prej tij mësonin shumë të gjithë, jo vetëm nxënësit dhe ne, kolegët e tij, që patëm fatin të punonim me të. Burra të tillë kanë pse me lindur. Vepra e tyre nuk vdes kurrë".

Për Z. Fadil Meha, një tjetër publicist i njohur dibran "Xhemal Berisha ka qenë burrë burrash. Ai ka shfaqur gjithmonë vlera të mëdha intelektuale ....".

Vlerësime vijnë dhe nga ish-nxënësit e tij. Kështu Shemsi Prençi shprehet se"...Mësuesi ynë i dashur, do mbetet për te gjithë brezat model i ndershmërisë dhe përkushtimit ..." . Ndërsa Agim Deva vlerëson se "Xhemal Berisha, ky kolos i arsimit ne Diber, ishte i pamberritshem si për nivelin kulturor edhe për mirësjelljen dhe dhimbjen për njerëzit ..." Ai ka qene mësuesi ynë i madhi te gjithë neve qe vijmë nga ajo ane ..."

Njëri nga bashkëkohësit e Xhemalit, Ramadan Ndreka thotë se fëmijët, nipat dhe mbesat e tij, me punën e tyre duhet të lartësojnë këtë burrë të lartë dibran ...".

Në vlerësimet e Haki Përnezhës, "Xhemal Berisha do mbahet mend për mprehtësinë e mendimit dhe forcën e argumentit. Ai erdhi ne Çidhën me vrull dhe iku plot lavdi dhe respekt ..."

Kujtimet më të mira për atë burrë të mençur, bujar, patriot dhe edukator shembullor ruan edhe personaliteti i shquar dibran Demir Osmani.

Ndërsa për Xhelil Cibakun " ...Profesori ka qenë shembull i mësuesit, intelektualit dibran, njeri i thjeshtë, i ndershëm dhe shumë punëtor e i respektueshëm ...". Dhe siç do të shprehej Idriz Zogu, njerëzit e mëdhenj si profesori ynë, ndërrojnë jetë në kohë dhe evenimente të jashtëzakonshme për t'u mbajtur mend gjatë në memorien e popullit ...

Xhemal Berisha, pishtar i rëndësishëm i arsimit dhe kulturës dibrane dhe shqiptare, vlerësohet s i tillë edhe nga LiriBeqja

Njeri i veçantë, energjik, në sjellje e qëndrime

Ne, si gjithë brezat e rinj që ai mësoi dhe edukoi, ndihemi krenarë për të! Sepse në gjithë jetën tonë (si nxënës, studentë, mësues, e tjerë) nuk kemi njohur një mësimdhënës kaq të talentuar si ai, një intelektual kaq të formuar si ai, një njeri si ai, me një vullnet dhe një sistematikë shembullore në studime dhe lexime librash të ndryshëm dhe, sidomos, artistikë! Ai në gjithë jetën e tij të gjatë, ishte një njeri mjaft serioz, shumë i dashur dhe me një humor, gjithmonë të shëndetshëm. Ishte një njeri i veçantë, energjik, në sjellje e qëndrime, me një mënyrë të foluri karakteristike, që të mbushte mendjen për çdo gjë që mund të fliste. Aq e admiruar gjuha dhe mënyra e tij e gjestikulacioneve, nga miqtë, kolegët, madje dhe nxënësit e tij, sa të gjithë rrekeshin ta imitonin, të merrnin sa më shumë prej tij, për të përmirësuar stilin e tyre të të folurit, të punës dhe sjelljes në jetë. Për me tej, Xhemal Berisha asnjëherë nuk qe egoist, karrierist dhe autokrat, por një njeri tepër bujar, i thjeshtë si buka që ndante përnatë e përditë me miq nga më të ndryshmit në tryezën e vatrës së tij familjare. Qe një ndihmëtar i pakursyer për të përcjellë nëpër shkolla dhe universitete të vendit, dhjetëra e dhjetëra djem dhe vajza të popullit, kudo ku ai punoi dhe drejtoi. Ngado, ai i kish dyert e shtëpive të njerëzve të thjeshtë të hapura, sepse kishte të hapura zemrat e tyre. Ngado që të hedhësh këmbën nëpër viset ku punoi, ti do të shikosh se njerëzit që e njohën, qesin vetëm mjaltë nga goja për Xhemal Berishën! Dhe, më në fund, gjatë gjithë jetës së tij, Xhemal Berisha ishte armiku më i egër i servilizmit dhe hipokrizisë. Askush nuk mund të përballej me të, sepse ai "të rrëzonte" menjëherë me gjuhën e gjakftohtësisë dhe argumentit të pakundërshtueshëm.

Duke ndarë dhimbjen për humbjen e këtij korifeu të vërtetë të arsimit dhe kulturës kombëtare në Dibër dhe më gjerë, me të gjithë ju, miqtë tanë të mirë, jemi të sigurt se jo vetëm Muhurri, por gjithë treva e Dibres, me humbjen e Xhemal Berishës, ka humbur njërin nga njerëzit më të ditur dhe me të zotë dhe se fisi i Berishve të Dibrës, për shumë e shumë kohë, ndoshta, do të ndihet i paplotë!

Ju falemnderit, mësuesi ynë i paharrueshëm, Xhemal Berisha, për gjithçka që bëre për arsimin dhe kulturën, për brezin e ri në Muhurr, në Dibër e më gjerë!

U prehte në paqe shpirti yt bujar!

Këngë e Luftës së Lumës në Qafë të Kolesjanit

(Vijon nga faqja 15)

Këngëtarët popullorë janë vlerë kulturore. Nëpërmes tyre kënga bëhet e njohur, bëhet gjithëkombëtare. Kështu ndodh me këngëtarë të tillë si Dervish Shaqja e Demush Neziri, këngëtarët e Shtiqnit, Karaçet e Topojanit, Dyshja Mina Noka – Azem Nela, Haziz Ndreu, Treshja Rexhep Kovaçi, Hysen Dida dhe Rustem Çela, Dyshja Kujtim Hasa e Ramiz Peposhi, Nexhip Dida, vëllezërit Koldashi e shumë këngëtarë të rinj. Gjithnjë flasim vetëm për këngëtarët e këngës "Luma e serbi po luftojnë". Këngën nuk mund ta shkëpusim nga krijuesi anonim, të cilit i përket autorësia, po as nga këngëtarët që i kanë dhënë shpirt e jetë me harmoninë e elementeve kompozuese e variantizuese të saj.

VEÇORITË KULTURORE

Fillimi i shekullit të 20-të ishte edhe fillim i një kohe të re kulture. Së paku, veç Luftës së Nishit, që sipas studiuesve, ndikoi kultura orientale për të ndalur revanshin e hordhive serbe, në lëvizjet e mëvonshme sikur zbehet kjo kulturë, ose më saktë mendimi se kultura e Lindjes do të sjellë ndonjë përparim. Kjo nuk u arrit menjëherë, edhe pse një mendim për kulturë as lindore, as perendimore, por shqiptare, kishte lindur që në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, në programin e saj. Pikërisht shpirti i lëvizjeve kombëtare, u bë kjo kulturë, në radhë të parë idea nacionale e shqiptarizmës. Të gjitha lëvizjet, kryengritjet, luftërat u zhvilluan nën ndikimin e kulturës, tashmë kombëtare. Kështu, prijësit e Lëvizjes kombëtare, të kryengritësve, drejtuesit e tyre, para se të jenë luftëtarë, ishin të ndërgjegjshëm për detyrën që kryenin karshi atdheut të vet. Kultura kombëtare shqiptare u bë për ta sistem dijesh e vlerash për të qenë shqiptarë, ndryshe nga më parë ku diku-diku ndihej fjala "turk", remishencë e të cilës arriti deri në ditët e sotme. Në krye të këtyre vlerave, të kësaj kulture, u vu pavarësia, liria dhe mendimin e veprimin se pa këto vlera nuk kuptohej qëllimi. Ndaj u bë dhe qëndresa në disa beteja para Shpalljes së Pavarësisë, kulmi që për lumjanët arriti me Betejën e Qafës së Kolesjanit. Kultura lumjane në këtë betejë e tregoi veten krejt shqiptare, në traditën dhe botën e lirë të lumjanit. Lëvizja kunër reformave turke, kundër fushatave ndëshkuese të pashallarëve Xhavit, Turgut etj, si dhe më e dukshmja kundër invazioneve serbe, e tregoi më së miri këtë botë, këtë kulturë me gjithë madhështinë e saj.

Lufta zbuloi jetën me karakteristikat më të fuqishme të malësorit, të rezistencës e të talentit, të zakoneve e psikologjisë, të përballimit të vështirësive e vuajtje, të shoqëruara jo vetëm me vazhdimësinë e jetës, por edhe me artin e vet, këngën dhe muzikën. Në hapërsirat shqiptare zbuten dasitë Jug e Veri, toskë e gegë, malësor e fusharakë etj. Në rrafshin lokal, në Betejën e vitit 1912 në Qafë të Kolësjanit, u zbutën disa dasi të tilla fshatareske si topollti, malësor, dhetar, rrafshak, Grykë e Zezë e deri në shprehje përbuzëse si pomak etj. Aty u pa se për çeshtje madhore kombëtare të gjithë janë njëlloj, të gjithë luftëtarë, të gjithë dinë të ngrejnë në art betejën, të këndojnë këngën sipas traditës.

Këto do të ishin disa konstatime dhe interpertime të këngës së Luftës së Lumës më 1912.


F.Gjabri

homazh

Mirënjohje për punën tënde, mësues Xhaviti

Nga **RRUZHDI BITRI**

Para pak muajsh u nda nga jeta mësuesi ynë, mësuesi i mësuesve Xhavit Spata. Të shkruash për mësuesin Xhavit Spata, për jetën dhe veprimtarinë e tij profesionale afro pesëdhjet vjeçare, nuk është e lehtë pasi jeta dhe veprimtaria e tij përfshin tri periudha të historisë së popullit shqiptar. Shkollimi dhe bazat e para të formimit i mori në kohën e Zogut. Punën dhe veprimtarinë pedagogjike e zhvilloi nga viti 1948 deri në vitin 1984, dhe më pas veprimtari shoqërore deri në vitin 1994. Xhavit Spata lindi në fshatin Blliçe të Dibrës, në një familje me emër të mirë në zonën e Çidhnës. Hapja e shkollës së Kastriotit në vitin 1924 ishte një fat për kohën dhe nga ky fat përfituan për t'u arsimuar qindra djem të Dibrës, përfitoi dhe mësuesi ynë Xhavit Spata. Dëshira e madhe e tij për t'u arsimuar dhe vullneti i tij e bënë Xhavitin të rrjeshtohej me yjet e shkollës siç i quanin në atë shkollë nga viti 1936 deri në vitin 1941 kur ai me mbaroi shkollën e Kastriotit. Ndoshta unë që po shkruaj këto rrjeshta për mësuesin model, për njeriun korrekt, pata fatin e madh të lexoj kujtimet e tij, të shkruara me besnikëri, thjeshtësi dhe ajo që të bie në sy është modestia e madhe që i përshkruan këto kujtime. Ato gjëra që mungojnë në arkivin e shtetit për shkollën e Kastriotit i gjejmë në kujtimet e mësues Xhavitit. Me nostalgji ai kujton mësuesit e tij, figura të arsimit kombëtar Qamil Guranjaku, Qamil Skuqi, Hysen Abdihoxha si dhe drejtorët Haki Sharofi, Sali Morina, Ferit Imami, si dhe mësuesin e tij Xhafer Shehu e më në fund Rifat Spahiu nga Luma. Me shumë respekt mësues Xhaviti shkruan për shokët e klasës si Selman Beqir Sina, Nazif Haziz Raska, Mahmut Marku, Sulë Spata, Hysen Laçi nga Gur-Reçi, Esat Mahmut Golemi, djali i prefektit të Dibrës. Megjithëse Xhaviti rrjeshtohej me nxënësit e mirë ai me shumë respekt e modesti flet për të tjerët. Kjo cilësi do të mbetej për gjithë jetën tek mësues Xhaviti. Në vitin 1945 vazhdon shkollën unike në Peshkopi. Ai regjistrohet si nxënës i jashtëm në këtë shkollë dhe si shokë klase do të kishte emra të tjerë të nderuar si Prof. Nuri Abdiu, Ali Koçeku, Shemsi Manjani, Ismet Bellova si dhe mësues Edip Tërshana, Hysni Alimerkaj, Mehmet Çadri, Ahmet Alliu. Vitin e parë të kësaj shkolle e vazhdoi si i jashtëm ndërsa në dy vitet e tjera fiton bursë dhe kthehet konviktor. Pas mbarimit të kësaj shkolle, me ndërhyrjen e drejtë për drejtë të "Mësuesit të popullit" Selim Alliu, caktohet mësues . Në shtator të vitit 1948 Xhavit Spata do të fillonte profesionin e mësuesit, profesion që do ta bënte njeriun e nderuar ndër vite. Mësues Xhaviti jep orën e parë të mësimit si mësues me klasa kolektive në fshatin Sohodoll më 1 shtator 1948 dhe pas Sohodollit do të vazhdonte në të gjitha shkollat e Dibrës si mësimdhënës, por dhe si drejtues. Sohodolli, Mustafaj, Staraveci, Deshati, Vakufi, Arrasi, Fushë-Alie dhe Blliçe do ta kishin mësues të fillores fëmijët e këtyre fshatrave. Nga viti 1948 deri në vitin shkollor 1956-1957 ai do ishte mësuesi dhe njeriu i respektuar nga të gjithë në ato fshatrat që punoi. Janë të shumtë nxënësit e tij apo banorë të këtyre fshatrave që kujtojnë me nostalgji mësues Xhavitin. Dhe vlerësimet e seksionit të arsimit dhe veçanërisht të Selim Alliut do të ishin të mëdha. Marrëdhënjet e Selim Alliut me Xhavitin ishin marëdhënje besimi e respekti të ndërsjelltë. Ndaj sa herë në fshatra të veçantë kishte probleme me shkollat Selim Alliu i bënte thirrje Xhavitit "na rregullo Deshatin apo Staravecin për një vit". Në vitin shkollor 1957-1959 mësues Xhaviti do t'i nënshtrohej një kualifikimi parauniversitar për kohën. Nga kjo shkollë që do ta bënte në Tiranë do të specializohej si mësues i ardhëshëm i matematikës. Këto vite shkollimi do të zinin një vend të veçantë në formimin dhe në jetën e tij, ndaj në kujtimet që ka lënë kujton me nostalgji shumë gjëra, që nga orët e mësimit, mësuesit e shkollës, të cilët ishin edhe ajka e arsimit kombëtar për kohën si Sinan tafaj, Riza hajro, Koço Flloko, Gjergj Zhej, Tahir Kokalari. Takimet në këtë shkollë që bëheshin me personalitete të kohës ishin mbresëlënëse. Takimet me Petro Markon, Nonda Bulkën, Kolë Jakovën e bënë mësues Xhavitin që t'i rritej dëshira për librin artistik. Ai do të bëhej për ne mësuesit e rinj një mësues model dhe njeriu që në zonën e Çidhnës do të kishte bibliotekën personale më të pasur. Jeta dhe verpimtaritë në periudhën 2 vjeçare në Tiranë do të lnin gjurmë të pashlyera në jetën e tij. Shokët e tij të kursit do të ishin mësuesit e nderuar nga të gjithë Shqipëria, që nga Dukagjini e deri në Sarandë. Në kujtimet e tij ai përmend shumë emra si Ndue Zef Toma (Velipojë), Shefqet Hodaj (Mallakastër), Hasije Shehu (Tepelenë), Ferit Bilali (Kukës), Skënder Cala (Dibër) e plot të tjerë. Në vitin 1958 kujton mësues Xhaviti aksionin për hapjen e liqenit artificial në Tiranë. Pasi u kualifikua dhe u formua më shumë për mësues Xhavitin do të fillonte puna e drejtimit të shkollave të ndryshme në Dibrën e Poshtëme. Ai e fillon punën e drejtorit të shkollës në Kastriot, aty ku kishte marrë shkollimin e parë(por për fat të keq jo në ndërtesën e Internatit, pasi ajo ishte shkatërruar që në vitin 1943. Njerëzit dhe arsyet pse u shkatërrua ajo ndërtesë, në kujtesën e dibranëve të asaj kohe janë të njohura, por kjo nuk është pjesë e shkrimit tim. Nga vitet 1955 deri në vitet 1966 ai do të ishte drejtor në Kastriot dhe në Fushë-Çidhën. Nuk mund të lemë pa përmendur kujtimet e mësues Xhavitit për këto vite të drejtimit të arsimit në këto shkolla. Në Fushë-Alie do të inaguronte hapjen e shkollës 7 vjeçare që në vitin 1956 bashkë me mësuesin elbasanas Sh. Dalipi. Në Kastriot ai kujton me respekt kolegët e punës me të cilët punonte si Xhemal Haraçiu, Mexhit Prençi, Subi Abazi e të tjerë. Cilësia bazë e mësues Xhavitit do të ishte korrektësia. Me punë e korrektësi ai siguronte marrëdhënjet me ekipet që punonte. Ai nuk falte mos përgaditjen apo sjelljen e pahijshme të mësuesit. Ai do të edukonte tek të gjithë nxënësit e tij, dhe veçanërisht për kolegët se formimi, puna dhe sjellja e bëjnë mësuesin model dhe profesionin e mësuesit të shenjtë. Këto cilësi do të karakterizonin mësues Xhavitin kudo që të ishte, në klasë apo në zyrën e drejtorit, në rrugë apo me bashkfashatrët, inspektor apo me nxënësit që sillnin probleme për shkollën e shoqërinë. Ndaj dhe puna si drejtor në Kastriot apo në



Xhavit Spata

Fushë-Çidhën, puna si mësues matematike në shkollat 7 dhe 8 vjeçare të Kastriotit, Fushë-Alie, Luznisë, Grykë-Nokës, dhe së fundi në Blliçe do të kishin gjithmonë të njëjtin njeri; emrin e mësues Xhavitit. Ai ishte i ashpër por i drejtë. Nuk i duronte veset e këqija as tek nxënësit, por i luftonte ato dhe tek kolegët, pavarsisht nga pozicioni që kishte. Ndaj në çdo ekip që punonte krijonte balancën e marrëdhënjeve me qëllimin e mirë që të mos cënohej puna në ekip. Ish nxënësit e tij kanë ç'të krenohen me emrin e mësues Xhavitit, por dhe mësues Xhaviti krenohej me emrat e kolegëve të tij ndër vite si Maliq Kacani, Murat Koltraka, Ali Hoxha, Iljaz Çuni, Xhemal Berisha, Gani Zogu e deri tek emra më të rinj me të cilët punoi deri në fund të karierës së tij profesionale. Me respekt kujton edhe një nga mësueset e para me arsim të lartë në shkollën e Fushë-Alies. Kjo ishte mësuesja Afroviti Bitri. Mësuese fizike që la një emër të mirë mes kolegëve e nxënësve për dy vite të punës në shkollat e Fushë-Alies e Blliçe. Pas viteve 1978 mësues Xhaviti, me kërkesën e tij do të kalonte si mësues në ciklin e e ulët në Blliçe. Tashmë vitet e punës, pothuaj në shumë fshatra të Dibrës e kishin lodhur fizikisht, por kishte dhe arsye tjetër të fortë. tashmë djali i tij Zylfi Spata si mësues fizike do të zëvëndësonte të atin në lëndët shkencore. Dhe kjo ishte një arsye më shumë për t'u ndjerë i qetë në vitet e fundit të karierës. Dhe kur ne kolegët e rinj i thoshim me shaka:"Eh more mësues, nga teorema e Pitagorës, përsëri tek ABC-ja" dhe ai me qetësinë më të madhe na përgjigjej: "Edhe teoremën e Pitagorës dhe ABC-në me të njëjtën dashuri nxënësve ua kam dhënë" . Gjithmonë ndjehej mirë mes kolegëve, edhe pse ish nxënësit e tij tashmë po bëheshin mësues, agronomë, mjek. Ndjehej i respektuar kur i drejtoheshin "mësues Xhaviti". Për ne ish nxënësit etij ishte nder dhe krenari të ishim njëkohësisht koleg me te. Edhe me bashkëfshatarët ai do mbetej modeli i sjelljes e i marrëdhënjeve të mira. Dalja në pension në vitin 1984 u bë ceremoniale. Ish koleg, ish nxënës e respektuan sespe ai kiste lënë gjurmë në shumë breza nxënësish, në shumë shkolla të Dibrës, por do t'i mungonin dekoratat e larta për punën e bërë ndër vite. Sot është e pafalshme për drejtuesit e arsimit të Dibrës që për 20 vjet të mos jenë kujtuar për këtë figurë të arsimit dibranë. Janë shumë mësues të nderuar që për 50 vjet kanë kontriubuar për arsimin në Dibër. Por megjithatë mësuesi Xhavit Spata, ka siguruar sot mirënjohjen e brezave të tërë nxënësish. Këtë respekt e fitoi me punën e tij të vyer. Ndoshta është kjo arsyeja që librin e kujtimeve të tij e hap një thënje e çmuar: "Natyra sendet i shet gjithnjë me të njëjtin çmim dhe ky çmim është "Puna" Mirënjohje për punën tënde mësues Xhaviti!

PËRCJELLJA E MËSUESIT

Kujtimit të paharruem të Xhavit Spatës

Në klasat mbushun plot
E pret një heshtje varri
Gërvima e një shkumësi
Tek shket mbi Dërrasë të Zezë.
Dritaret jashtë vështrojnë
Tek të përcjell karvani
Me kokat varun poshtë
E kapat hequn kresë.

Ke marrë sot në ballë
Me heqë rrugën e fundit.
I madh edhe i vogël
Në heshtje ndërrohen rradhë.
Në krahë të të mbajnë,
Për n' Tabén e Katundit
Ku flenë të gjithë të parët
Sot pret për Ty një varr.

Fytyra jote ngrimë
E zbardhun sikur shkumësi,
Dërrasë e arkivolit
Të ngjeshka nga çdo anë!?
Pëshpërima në mes lotëve:
" Na la edhe Mësuesi!
Ka shqimun e asht shue
E má nuk ja dëgjojmë zanë!"

Kërcasin, qajnë dërrasat,
Ndën ato grushta dheu.
Disa anash një lutje
Ndën zá e thonë për Ty.
E nxanësit që mësove
Përlotun çaste mbledhin,
Këshilla e qortime
Që s' i harron njeri.

Kujtojnë ta mbajnë me vehte
Imazhin e pa shuar,
Atë fjalën tande brisk
Qoftë lavd apo qortim.
Shpotinë e rreptësinë
Për sjelljen e gabuar,
Drejtësinë e përkushtimin
Që pat' Mësuesi im.


Lajnë prapa me Stërgjyshërit
Një trup gjatë drobitun.
Të gjallin, atë të mirin,
E mbajmë Nè këtu.
Një pjesë e jona jè,
Në fëmini e ngjizun
Që bashkë me Nè ban jetë
Pa mundë me u harrù.

Sot klasat krejt kanë heshtun
E rrugëve të Katundit
Kanë dalë i madh, i vogël,
Me të përcjellun Ty.
E gjatë sa Përjetësia
Kjo Rruga jote e fundit!
Nè fjalët mbledhun komkë
E lotët nëpër sy.

Nè marrin fjalën tande
Përcjellim tek të tjerë.
Na vjen se nuk ke vdekun
Po jetë ban prapë me Nè.
Kërkojmë diçka harruar
E Ti çfaqesh priherë,
Hedh tutje kohë e vite
E grumbullin me dhè.

Na dhe të parat dije
Si qumështin jep një nanë.
Ne digjemi për tjetrën,
Atë fjalën e pa thanë!

Në vend grushtit të dheut të pa hedhun,
ILIR LAZIM SPATA 2012 NY




Xhafer Martini
"GJENERALI ME SHAJAK"
Monografi
Botimet "Dita 2000"
ISBN: 978-99956-92-78-0
Çmimi: 1000 lekë

Naim Berisha
PENGU I NËNDHESHËM
Poezi
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-84-4
Çmimi: 400 lekë




Nazmi Hoxha
ALBANIA E AMERIKËS
Poezi
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-87-5
Çmimi: 500 lekë



Kristo Frashëri
"HISTORIA E DIBRËS"
Histori
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-82-0
Çmimi: 1500 lekë



Agron Tufa
FRAGMENTET E GJESE
Poezi
Shtëpia Botuese OM - Prishtinë
ISBN: 978-9951-632-02-7
Çmimi: 5.5 Euro



Shaban Sinani
NDAJFOLJET PËREMRORE NË GJUHËN SHQIPE
Punim historik krahasues
Botimet Naimi
ISBN: 978-9928-109-44-6
Çmimi: 800 lekë




Elliot Moglica
BURRI I MADH HASAN MOGLICA
Biografi

ISBN: 978-0-9868069-2-6
Çmimi: 12 E, 18 CAD, 20 USD



Naim Berisha
E DREJTA, E PADREJTA DHE KADIU
Fabula
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-85-1
Çmimi: 300 lekë



Arbër Sh.Cami
KALATË SHQIPTARE
Album me foto
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-97-4
Çmimi: 500 lekë



Faik Xhani - Hatixhe Erebara
I PERKUSHTUARI
Monografi
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-89-9
Çmimi: 500 lekë

Këto libra mund t'i gjeni pranë librarisë së Shtëpisë Botuese M&B, në rrjetin e librarive "Adrion", libraria "Eva" pranë Pallatit të Kulturës, Libri Universitar si dhe në pikat e shpërndarjes së librit.

Librin HISTORIA E DIBRËs të Kristo Frashërit mund ta gjeni:

Në PESHKOPI: **Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.** Në DIBËR TË MADHE: **Rexhep Torte. e-mail <diars@t-home.mk>**

Në DURRËS: **Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353**

Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603 / 068 65 08 441 / 067 30 73 265 *E-mail*: <mbbotime@gmail.com>

cyan magenta yellow black